


HEJZA




Václav HAVEL

Teatri gjithmonë është edhe simbol, edhe shkurtesë. Në teatër, pasuria dhe kompleksitet i genies përmblihen në një kod të thjeshtëzuar që përpiqet të nxjerrë atë që është më esenciale nga substanca e universit dhe t'ia paraqesë këtë audiencës së tij. Kjo, në të vërtetë, është ajo që bëjnë çdo ditë krijesat me aftësi për të menduar.

POLITIKAT KULTURORE DHE EDUKIMI ESTETIK PËRMES LETËRSISË

Shqiptarët e Shqipërisë ka kohë që janë viktimë e propagandës dashakeqe që thotë se, në Maqedoninë e Veriut nuk ka shkrimtarë shqiptarë por “shkronjës” dhe, si rrjedhojë e kësaj logjike, autorët nga ky shtet përjashtohen, nuk botohen (me përjashtim të një-dy autorëve)



Avni HALIMI

1. Politikat kulturore të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, ku shqiptarët partiakë trumbetojnë se janë “ortakë të qeverisë” (dhe jo vasalë!), po zhvillohen në guaca të mbyllura, sidomos në krijimtarinë artistike! Shqiptarët e Shqipërisë ka kohë që janë viktimë e propagandës dashakeqe që thotë se, në Maqedoninë e Veriut nuk ka shkrimtarë shqiptarë por “shkronjës” dhe, si rrjedhojë e kësaj logjike, autorët nga ky shtet përjashtohen, nuk botohen (me përjashtim të një-dy autorëve); autorët nga Kosova nuk përkraken, sepse, sipas një logjike të mbrapshtë të disa “botuesve shqiptarë”, ata nuk po ditkan të shkruajnë, ose shkruajnë me një “gjuhë neveritëse”, gjysmë geqe e gjysmë të çalë nga ndikimet e të menduarit sllavisht! Autorët shqiptarë të Luginës së Preshevës si dhe ata të Malit të Zi, janë “krijues provincialë” ndaj dhe duhet të mos përfillen! Megjithatë, sa për shpëlarje parash, deri para do kohe, ministrinë respektive të kulturës së Shqipërisë dhe Kosovës, nënshkruanin një marrëveshje për “bashkëpunim sezonal” kulturor që do të zgjaste tre muaj të verës. Në start kjo marrëveshje privonte nga e drejta e natyrshme që të përfshihen edhe krijuesit e fushave të ndryshme nga Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi, nga Lugina si dhe nga diaspora!

Ministria e Kulturës e Maqedonisë së Veriut, ndonëse me zëvendësministër dhe me sekretar shtetëror shqiptar, bazuar në Strategjinë nacionale për kulturë, ka përjashtuar nga aktivitetet dhe ngjarjet kulturore të gjithë artistët e kulturës shqiptare që nuk janë rezidentë të këtij shteti! Taksapaguesit shqiptarë të Maqedonisë së Veriut nuk paguajnë për këtë “përjashtim kulturor”. Taksat shqiptare shpenzohen për autorë sllavë, për ata serbë, rusë, por edhe për bullgarë që për drejt, vështirë që dallohen nga ata maqedonas, meqë kanë emra e mbiemra të përafërt.

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut edhe ashtu nuk marrin as një përqind për kulturë nga ajo që paguajnë si taksë shtetërore. Kultura shqiptarë është një letërsia shqiptare është një dhe, çdo politikë përjashtuese apo segmentarizuese është antishqiptare, është politikë e huaj e cila prej shqiptarëve mundohet të bëjë disa “kombe”!

2. Politika kulturore e Shqipërisë, por edhe e Kosovës, ministrinë përkatëse, qeveritë kombëtare, duhet të jenë më të logjikshëm dhe, patjetër e kanë që, jo vetëm të jenë kombëtarisht gjithëpërfshirës, por edhe të parashohin buxhet subvencionues për ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin kulturor të shqiptarëve gjithandë ku jetojnë.

Letërsia e autorëve shqiptarë nga diaspora, në kohën e Rilindjes Kombëtare, letërsia e autorëve disident që bënë jetën e refugjatit, letërsia e krijuar jashtë kufijve të shtetit amë, letërsia e krijuar nga krijues jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe piktura, muzika, teatri, folklori, janë materie bazë që e përforcuan tabanin e identitetit kulturor shqiptar! Këtë taban, sot, dikush po e spërkat “me acid”, me qëllim të drobitjes së saj sa më parë!

Politikat kulturore shqiptare, para se të jenë globaliste, është mirë të jenë më kombëtarisht të kujdesshme!

3. Ministria për Kulturë e Shqipërisë, e gjendur nën presion të dyfishtë: nga krijuesit letrarë për fëmijë që nuk po stimulohen nga institucionet kulturore dhe nga prindërit e fëmijëve që pëshetur ankoheshin se fëmijët nuk po kanë se çfarë të lexojnë në gjuhën shqipe për moshën e tyre, hapi konkurs për Fondin e “Krijimtarisë letrare për fëmijë”. Të gjithë u ndanë të kënaqur, mbi të gjitha, juria e ngritur e cila do të shprehet shumë e lumtur për interesimin e madh në këtë konkurs të krijuesve letrarë për fëmijë. E entuziazmuar nga paraqitje e numrit të madh të krijuesve për fëmijë, kjo Ministri vendosi që ta rikthejë Çmimin Kombëtar të Letërsisë për Fëmijë! Po si është situata në Kosovë? Po në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës, në mesin e shqiptarëve të Malit të Zi, në diasporë? A kemi sot plejadë të gjeneratës së re krijuese për fëmijë! A shkruan sot dikush për fëmijët apo, të gjithë shkruajnë për dashurinë e humbur, për shtratin e thatë, për fatin e zi, për vrapimin me re e me mjegull, për luftërat me drejtin etj.

Institucionet shtetërore në Kosovë, por edhe participantët qeveritarë në Maqedoninë e Veriut e gjetiu, është mirë që ta ndjejnë atë mungesë të fëmijëve, atë boshllëk shpirtëror i cili mund të ndjehet i përmbushur vetëm duke lexuar libra për moshat përkatëse. Sa më shumë që do ta ndjejnë atë nevojë fëmijërore, aq më shumë do të kontribuojnë në prurje të reja letrare.

Shkrimtarët për fëmijë duhet të kenë një trajtesë korrekte dhe të mirëfilltë nga institucionet gjegjëse shtetërore. Ata duhet të ndjehen si shtresa më e privilegjuar e komunitetit të shkrimtarëve.

4. Kanë kaluar dekada e dekada ndërsa ministrinë tona të arsimit assesi nuk janë bërë të mbara të vendosin për kolonat e lekturave shkollore sipas moshës. Sot nuk kemi lekturë të përbashkëta. Të dhënat flasin se, tash e dy dekada, këtë nevojë për fëmijët tanë po e përmbushë vetëm Shtëpia botuese Logo A, e Shkupit, pa u përkrahur dhe ndihmuar nga asnjë dikaster përkatës i qeverive tona shqiptare. Si rrjedhojë, edhe kjo shtëpi botuese nuk është në gjendje që të ofrojë tirazh të mjaftueshëm për të gjithë fëmijët tanë, si në këto hapësira ballkanike ashtu edhe në diasporë.

Njëmend, çka të lexojnë fëmijët tanë në diasporë? Si ta ushtrojnë dhe ta ruajnë gjuhën shqipe? Si ta arrijmë edukimin estetik të fëmijëve tanë nëse nuk kemi letërsi bashkëkohore për fëmijë si dhe krijues letrarë për fëmijë! Shopenhaueri thoshte: „Vetëm ndjenjat për të bukurën, mund të neutralizojnë veset instiktive, negative të njerëzve”. Kur fëmijët tanë do të lexojnë sërish shkrimtarë si: Adelina Mamaqi, Agim Deva, Astrit Bishqemi, Bedri Dedja, Gaqo Bushaka, Isuf Nelaq, Odhise Grillo, Pandeli Koçi, Petraq Zoto, Rifat Kukaj, Skënder Hasko, Sokol Jakova, Shkëlzen Zalli, Tasim Gjokutaj, Vangjush Saro, Vehbi Kikaj, Xhahid Bushati, Xhevat Beqaraj, Ymer Elshani, Rexhep Hoxha, Mehmedali Hoxha, Liri Loshi e shumë e shumë të tjerë!

Kur fëmijët e sodit do të kenë mundësinë që nëpër aktivitete letrare të organizuara nga shkollat e tyre, do të kenë mundësinë të takojnë shkrimtarë për fëmijë, të bisedojnë me ta, të shtjellojnë tema të prekura nga krijues letrarë!

Fëmijët tanë duhet të kalojnë sa më shumë kohë me librin shqip, me gjuhën shqiptare, me traditën, kulturën shqiptare. Fundja, këtë çdo shqiptar ia ka borxh trashëgimitarit të vet.

KULTURA S'NJEH PARTI!

Si u bë që mjetet e Qeverisë së Kosovës dedikuar për promovimin e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe kulturës në këtë pjesë të hapësirës shqiptare, të përfundojnë në duart e një partie dhe ato t'u shpërndahen kryesisht njerëzve të afërt të kësaj partie

Në fund të muajit tetor të vitit të kaluar, u nënshkrua Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Nacional Shqiptar në Luginën e Preshevës, në krye me kryetarin (e KNSH) z. Ragmi Mustafi, që vjen nga radhët e PVD (Partia për Veprim Demokratik).

Ky Memorandum bashkëpunimi pati për qëllim përkrahjen financiare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shqiptarëve, ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, artit, kulturës e identitetit shqiptar në Luginë të Preshevës.

Mjetet e dedikuara u vendos që t'i kalojnë Këshillit Nacional Shqiptar, kurse kjo e fundit të shpallë konkursin publik. Në komisionin vlerësues ishte vendosur të jenë anëtarë nga Qeveria e Kosovës dhe një nga subjekti politik i PVD-së. Të paktën kështu ishte thënë, mirëpo, siç do të shihet, Qeveria e Kosovës ia kishte lënë vlerësimin PVD-së.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizata jo qeveritare, nisma të ndryshme të grupeve të interesit, artistë, shkrimtarë, dhe njerëz të fushës së kulturës, ia mësynë konkursit publik, t'i mbushin formularët dhe të shkruajnë projektet e tyre, me shpresë që mund të pranohen dhe të gëzojnë të drejtën e tyre për të zhvilluar mendimet, projektet dhe aktivitetet e tyre dhe të përfitojnë financiarisht nga ky donacion dhe të realizojnë qëllimet e tyre në pajtim me kërkesat e Qeverisë së Kosovës.

Deri këtu gjithçka ishte në rregull, edhe pse disa konkurrentë kishin dyshimet e tyre, sepse ishte edhe periudha e zgjedhjeve të Këshillit Nacional, sepse ekzistonte droja e keqpërdorimit të PVD-së. Natyrisht kësaj i druheshin më së shumti konkurrentët që s'kishin librezat partiake dhe simpatinë e partisë, por shpresën e zgjatën deri në ditën e shpalljes së rezultateve. Sapo u shpall lista e përfituesve, u kuptua loja e PVD-së, sepse në listën e përfituesve u vërejtën emra militantësh dhe OJQ që janë të lidhur direkt me subjektin politik PVD, madje kishte përfitues ordiner edhe nga radhët e PDSH, sepse edhe kjo parti është në krye të KNSH.

Partitë tjera politike dhe shumë OJQ, të pakënaqur nga kjo zallamahi dhe nga ky krim financiar i mjeteve publike të taksapaguesve kosovarë kanë reaguar dhe janë ankuar, madje së fundi kanë dalë me një listë të përbashkët që iu janë drejtuar kryeministrit të Kosovës, me kërkesë dhe ankesë të hapur publike që kjo çështje të shqyrtohet edhe një herë.

Ata kanë renditur faktet dhe argumentet, kanë përmendur shoqata që janë regjistruar një ditë para se të dalë konkursi, emra njerëz të afërt (militantë) të këshilltares së kryeministrit Albin Kurti për Luginën e Preshevës - Ardita Sinanit dhe subjektit që ajo përfaqëson, njerëz që asgjë prej gjëje s'kanë bërë në aspektin qytetar publik, sepse në provincë njihen njerëzit dhe dihet se kush çka ka bërë dhe sa vlen.

Reagimi i menjëhershëm ishte edhe i zotit Xhemaledin Salihu, kryetar i Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturorë, e cila nuk përfitoi asnjë cent nga konkursi i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve.

-Sigurisht e kanë pasur parasysh aktivitetin e saj të bollshëm e të shumtë në lëvrimin e trashëgimisë kulturore. Po ashtu sigurisht duan të na mbyllin gojën dhe aktivitetin e kësaj Shoqate, sepse po zhvillon veprimtari dhe aktivitet kombëtar, - do të shprehet Salihu, për të shtuar se "brenda granteve ka edhe kriteret të posaçme që nuk janë përfillur nga Komisioni. Janë anashkaluar kriteret dhe shumicës së përfituesve iu kanë ndarë shuma prej 5.000 deri 25.000 euro që nuk qëndrojnë dhe nuk janë shpallur me konkurs. "Shoqatës për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturorë në Preshevë i propozuan t'i ankohe Komisionit të konkursit të Këshillit Nacional Shqiptar. Si të ankohe ajo kur nuk ka marrë vendim me arsyetim se përse është refuzuar një projekt i shkëlqyeshëm i saj. Unë i di arsyet? Por më duhet dokumenti i vendimit, kuptohet me arsyetim".

Edhe publicisti i mirënjohur, Skender Latifi autor i shumë veprave, si historike po ashtu edhe letrare, është shprehur i indinjuar nga refuzimi i projektit të tij me karakter shumë dobiprurës për historinë, kulturën dhe traditën shqiptare të Luginës së Preshevës. Ai shprehet se "qëllimi i fillimit të botimit të VJETARIT ka qenë i natyrës së ndriçimit të së kaluarës, të tanishmes dhe në përgjithësi të kontekstit të Luginës së Preshevës. Pra, VJETARI është paramenduar të jetë gjithëpërfshirës, por i koncentruar vetëm në trevat shqiptare që aktualisht janë në Serbi. Temat e trajtuara do t'i përfshinin të gjitha periudhat historike nëpër të cilat ka gjurmë në çfarëdo fushë të zhvillimit jetësor, ekonomik, por edhe politik të Luginës së Preshevës. Në veçanti kemi planifikuar që në rubrikën "Retrospektiv" t'i ribotojmë të përkthyer materialet e autorëve shqiptar, me qëllim të rishqyrtimit dhe ndriçimit të anës së vërtetë të këtyre shkrimeve. Por, qëllimi final ka qenë përjetësimi i revistës apo VJETARIT, i cili do të krijonte traditë disavjeçare të botimit, identike me shumë revista në Ballkanin Perëndimor".

Gjithashtu edhe profesori Fitim Nuhuri nga Presheva, ka reaguar duke renditur arsyetimet e tij shumë argumentuese për këto padrejtësi. Ai kishte konkurruar për një shtëpi botuese me një staf fillimisht modest, e para e kësaj natyre, që do të kontribuonte për botimet e autorëve vendas si edhe gjëra të kësaj natyre dhe që më pas të jetë shpërndarës i vlerave dhe karakteristikave të luginasve, gjë që do të ishte shumë dinjitoze dhe që do të përmbushte një zbrazëti në mozaikun e botimeve mbarëshqiptare. Ai fton kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti që të reflektojë, që të heton kanalet e tij aktuale të bashkëpunimit, t'i heq qafe dhe të gjej kanale më serioze dhe më të denja.

Si përfundim, nga e gjithë kjo mund të konstatojmë se kur bëhet fjalë për kulturën, ajo s'duhet të ketë ngjyra partiake, prandaj duhet hartuar platformë dhe strategji mbarëkombëtare për kulturën dhe artin, me qëllim që të mos ndodhë mjetet e kulturës t'iu dedikohen klubeve të fitnesit e karatesë, e të refuzohen projektet vitale që do të mbajnë shtyllën e një kombi të tërë, përkatësisht kulturës së mirëfilltë. (Sh.H.)



POLITIKA DHE TEATRI



Së fundmi kam lexuar një artikull të quajtur "Politika si teatër", një kritikë lidhur me të gjitha ato që jam munduar t'i bëj në politikë. Artikulli argumentonte se në politikë nuk ka vend për diçka aq të panevojshme sa teatri. Sigurisht, në muajt e hershëm të presidencës sime, disa prej ideve të mia demonstroi më shumë veçori teatrale sesa largpamësi politike. Por autori ka gabuar në një çështje rrënjësore: ai e ka keqkuptuar edhe kuptimin e teatrit, edhe dimensionin e rëndësishëm të politikës.

Aristoteli dikur ka shkruar se çdo dramë apo tragjedi kërkon një fillim, një mes dhe një fund, me paraardhësin që pason pasardhësin. Bota me përvojë, si mjedis i strukturuar, përfshin dimensionin e pandarë dramatik të Aristotelit, dhe teatri është një shprehje e dëshirës sonë për një mënyrë koncize të kuptimit të këtij elementi qenësor. Një shfaqje jo më shumë se dy orë e gjatë gjithmonë përfaqëson, apo mëton të përfaqësojë, një pamje të botës dhe një përpjekje për të thënë diçka për të.

Një definicion i politikës thotë se ajo është drejtim, çështje, dhe organizim i punëve publike. Qartësisht, çështja e punëve publike është çështje e njerëzimit dhe e botës, që kërkon një njohje të vetëdijesimit të njerëzimit në botë. Unë nuk shoh se si një politikan mund të arrijë këtë pa njohur dramën si një aspekt të pandarë të botës së qenieve njerëzore, dhe rrjedhimisht si një mjet rrënjësor të komunikimit njerëzor.

Politika pa një fillim, një mes dhe një fund, pa interpretim dhe dëlirësi, pa klasifikim dhe rëndësi, pa transcendencën që zhvillon një dramë të vërtetë, me njerëz të vërtetë, në një formulim për botën, është, për mendimin tim, politikë asnjëse, e njëanshme dhe e paefektshme. Unë nuk jam gjithmonë i suksesshëm në praktikumin e asaj që predikoj, por unë punoj për një politikë që e di se ka rëndësi çka vjen e para dhe çka pas, një politikë që pranon se të gjitha

gjërat kanë një sekuencë dhe rend të mirëfilltë.

Mbi të gjitha, është një politikë e vetëdijshme se qytetarët, pa teorizuar, siç po bëj tani, e dinë fare mirë nëse veprimet politike kanë drejtim, strukturë, logjikë në kohë dhe hapësirë, apo nëse atyre u mungojnë këto cilësi dhe janë thjesht reagime kuturu ndaj rrethanave. Në një periudhë të kufizuar, brenda një kohe të kufizuar, dhe me figura e objekte të kufizuara, teatri thotë diçka për botën, për historinë, për ekzistencën njerëzore. Ajo eksploron botën për të ndikuar në të.

Teatri gjithmonë është edhe simbol, edhe shkurtesë. Në teatër, pasuria dhe kompleksitet i qenies përmbledhen në një kod të thjeshtëzuar që përpiket të nxjerrë atë që është më esenciale nga substanca e universit dhe t'ia paraqesë këtë audiencës së tij. Kjo, në të vërtetë, është ajo që bëjnë çdo ditë krijesat me aftësi për të menduar.

Teatri është thjesht një prej shumë mënyrave të shprehjes së aftësisë njerëzore për të përgjithësuar dhe kuptuar rendin e padukshëm të gjërave. Teatri, gjithashtu, ka një aftësi të veçantë për të sugjeruar dhe për të paraqitur kuptime të shumta. Veprat e shfaqura në skenë gjithmonë përçojnë një porosi më të gjerë, pa u shprehur domosdoshmërisht me fjalë.

Ai është fragment i jetës, i organizuar në një mënyrë të menduar për të thënë diçka për jetën si tërësi. Natyra kolektive e një përvoje teatrore nuk është më e parëndësishme: teatri gjithmonë pandeh prezencën e një komuniteti – aktorëve dhe audiencës – që e përjeton atë bashkërisht.

Të gjitha këto cilësi kanë homologet e tyre në politikë. Një mik imi njëherë ka thënë se politika është "shuma e të gjitha gjërave të përmbledhura". Përfshin drejtësinë, ekonominë, filozofinë dhe psikologjinë.

Pashmangshmërisht, edhe politika është teatër – teatër si sistem i simboleve që na adreson si tërësi, si

individë, dhe si anëtarë të një komuniteti, dhe që na sprovon nëpërmjet ngjarjeve specifike në të cilat është i materializuar ndaj ndodhive të mëdha të jetës dhe botës, duke na rritur imagjinatën dhe ndjeshmërinë. Unë nuk mund të imagjinoj një politikë të suksesshme pa njohuri për këto gjëra. Simbolet që politika përdor janë teatrore për nga natyra. Himnet kombëtare, flamujt, dekorimet, festat nuk kanë shumë rëndësi vetë, por domethëniet që ato përmbajnë janë instrumente të vetëdijesimit të një shoqërie, mjete për krijim të njohurive për identitetin social dhe për vazhdimësi.

Politika gjithashtu përdor simbole në aspekte të tjera, më pak të dukshme. Kur presidenti i Gjermanisë erdhi në Pragë, pak pas "Revolucionit të kadifenjtë" tek ne, më 15 mars 1990 (përvjetori i 51-të i okupimit nazist të tokave çeke), ai nuk pati për të thënë shumë, sepse vetë vizita e tij në një ditë të tillë foli shumë. Ngjashëm ishte edhe kur presidenti francez dhe kryeministri britanik arritën në përvjetorin e Marrëveshjes së Muniut. Aktet simbolike politike i ngjajnë teatrit. Ato, gjithashtu, përfshijnë aluzione, shumësi të kuptimeve, dhe domethënie. Ato, gjithashtu, paraqesin një realitet të shkurtuar, duke bërë një ndërlidhje esenciale pa qenë eksplicite. Dhe ato, gjithashtu, kanë një strukturë përgjithësisht të pranuar që i bën ballë testit të kohës.

As dyshuesit nuk mund të mohojnë një aspekt të teatralitetit në politikë: varësia e politikës nga mediat. Shumë politikanë do të ishin të paafte pa trajnerët që u mësojnë teknikat e paraqitjes para një kamere. Të gjithë politikanët, përfshirë ata që e thumbojnë teatrin si të panevojshëm, si diçka që nuk ka vend në politikë, pa dashur bëhen aktorë, dramaturgë, regjisorë apo zbatimës. Roli i rëndësishëm që luan një ndjeshmëri teatrore në politikë është dytëhesh. Ata që e posedojnë mund ta ngrenë nivelin e shoqërisë dhe të ushqejnë kulturën

demokratike, guximin qytetar dhe një ndjejnë të përgjegjësisë.

Njerëzit e tillë gjithashtu mund të mobilizojnë instinktet dhe pasionet më të këqija, mund t'i bëjnë masat fanatike, dhe mund t'i çojnë shoqëritë në dreq. Kujtoni kongreset gjigante naziste, fjalimet nxitëse të Hitlerit dhe Goebbelsit, dhe kultin e mitologjisë gjermane. Zor se mund të gjendet një abuzim më monstruoze i aspektit teatror të politikës. Dhe sot – edhe në Evropë – udhëheqësit përdorin mjete teatrore për të ngjallur atë lloj të nacionalizmit të verbër që çon në lufta, spastrime etnike, kampe përqendrimi dhe gjenocid.

Pra, ku është kufiri ndërmjet respektit legjitim për identitetin dhe simbolet kombëtare, dhe muzikës djallëzore të daullexhinjve, magjistareve të zinj, dhe hipnotizuesve? Ku mbarojnë fjalimet e pasionuara dhe ku fillon demagogjia? Si mund të njohim pikën përtej të cilës shprehja e nevojës për përvojë kolektive dhe rituale integruese bëhet manipulim djallëzor dhe shkelje e lirisë njerëzore?

Këtu shohim dallimin e madh ndërmjet teatrit si art dhe dimensionet teatror të politikës. Një performancë e çmendur teatrore nga një grup i fanatikëve është pjesë e pluralizmit kulturor, dhe, si e tillë, ndihmon të zgjerojë fushën e lirisë pa paraqitur kërcënim për askënd. Një performancë e çmendur nga një politikan fanatik mund të çojë miliona njerëz drejt fatkeqësive të pafundme. Prandaj, drama e politikës kërkon jo një audiencë, por një botë të lojtarëve. Në teatër preket ndërgjegjja jonë, por përgjegjësia përfundon atëherë kur bie perdja. Teatri i politikës kërkon përherë prej të gjithë neve, si dramaturgë, aktorë dhe si audiencë – kërkon nga ne mendim praktik, gjakftohtësi, përgjegjësi, shije të mirë dhe ndërgjegje.

PSE SHQIPTARËT S'JANË ENDE NË NË EVROPË?



Shqiptarët, ndonëse nuk kanë distancë nga Evropa, megjithatë, edhe ato vlera që i njohin, nuk i trajtojnë seriozisht, si diçka fundamentale për një shoqëri moderne. Jemi të prirë ta pranojmë formën, pa obligime ndaj përmbajtjes. E duam hedonizmin evropian, por jo stoicizmin, përkushtimin ndaj punës, seriozitetin e tyre, respektimin e ligjit. Gjenetika, origjina apo gjeografia nuk janë përcaktues të mjaftueshëm të identitetit evropian, por sistemi i vlerave. Zhvillimi politik, ekonomik dhe qytetëruar i Evropës ka një parahistori të gjatë dhe nuk është aspak rastësi. Dokumenti i parë që ngushton hapësirën e sovranit (mbretit) dhe që paralajmëron konceptin e shtetit ligjor, parakushtit për zhvillim të shoqërisë, Magna Carta Libertatum, u hartua më 15.6.1215. Ky ishte dokumenti i parë që e kufizoi pushtetin absolut të mbretit (John Laclandit, Gjonit Patokë) dhe krijoi kushte për përhapjen e idesë, të standardit kushtetues që garanton mbrojtjen e drejtave dhe lirive të njeriut. Ky dokument ka rëndësi historike, ngaqë e hapi shtegun për humanizim të shoqërisë. Kjo ndodhi shekuj më parë.

Evropa me guxim ec përpara duke rrënuar barrierat ataviste, tabu temat që e bllokojnë trurin, ajo me vendosmëri i zëvendëson idetë e vjetra pengëtare me ide të reja që në fakt është fshehtësia se si krijohet historia e vërtetë. Pra, ne sot e kësaj dite nuk kuptojmë rëndësinë e gjithanshme të idesë së shtetit ligjor, standardit për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, domosdoshmërinë për verifikim shkencor të gjitha ideve që janë në funksion të organizimit shoqëror, nxitjen e hulumtimit të fenomeneve dhe përfundimisht rëndësinë e ndarjes së shtetit prej religjionit. Sot në të gjitha shtetet e Ballkanit, politikanët kërkojnë ndihmën e faktorit religjioz për legjitimimin e tyre politik, moral dhe partiak. Kjo gjithsesi nuk ndodh në shtetet evropiane. Në kuadër të kulturës evropiane, këto vlera, pa të cilat nuk mund të funksionojë një shtet modern, janë të njohura me shekuj dhe ne, nëse dëshirojmë të jemi evropianë, duhet para së gjithash t'i pranojmë, t'i interiorizojmë këto standarde në sistemin tonë të vlerave.

NË KËRKIM TË PEER GYNTIT SHQIPTAR

Njeriu që kërkojmë sot në këtë vend është Peer Gynt-i. Ky është heroizmi ibsenian, që përpiket të gjejë e të zaptojë veten. Me të lindur, Peer Gynt-i e ndjeu veten jashtë qendrës, jashtë botës. E sheh veten si prodhim pa lëng, si një monedhë pa fytyrë. S'kupton dot hapët as se përse janë historia e bota. Po mundohet andej këndeje. Sheh rrotull hi dhe pluhur. I bie erë kalbësi dhe varr. S'e ka gjetur dot akoma veten e tij. Prandaj, vazhdon të kërkojë, të pyesë, të gjurmojë. Peer Gynt-i është kalorësi i shekulli: njeriu që kërkon veten. Është kushëri i Don Kishotit dhe i Faustit. Drama e tij përdridhet përmes kohës në të cilën ai kërkon një gjë brenda në veten e tij. Dhe, duke pasur këtë qëllim, ecën e ecën dhe s'ka të sosur, si Ahasveri, për të zbuluar e zaptuar botën që i mungon dhe për të mbushur zbrazëtirën që ndjen brenda vetes së tij.

Edhe shqiptari e fitoi lirinë dhe independencën e tij. Shpëtoi nga skllavëria e të huajit. U bë shtet më vete. Nga kjo pikëpamje s'ka se ç'të kërkojë më. Vetëm një gjë s'ka bërë akoma gjer sot: të kërkojë, të zbulojë veten e ta zaptojë. Të bëjë atë gjë që psikologjia e quan introspektion. Shpirtin e tij s'e ka kapur drama heroike, që e mundoi për tërë jetën Peer Gynt-in. Sa pa bërë këtë gjë, shqiptari s'mundet të krijojë histori të re. Histori në kuptimin e gjerë e të thellë të fjalës. As ndonjë përpjekje, sado heroike e gjeniale qoftë, s' mund të sjellë pemë, gjersa shqiptari nuk do të gjejë më parë veten e ta sundojë. (Vangjel Koça, 1934)




Thekse: Gabriel Garsia Marquez

TRIUMFI I JETËS MBI VDEKJEN

Përballë shtypjes, plaçkitjes dhe braktisjes, përgjigja jonë është jeta. As përmbytjet, as murtajat, as zitë e bukës, as kataklizmat, madje as luftërat e përjetshme përgjatë shekujve nuk kanë qenë në gjendje të zbehin triumfin këmbëngulës të jetës mbi vdekjen.

TË DËGJOSH ZËRIN E THELLË TË UNIVERSIT

Ngjashmëria e shprehjes së Naimit me klasikët e tesavvufit, siç është Mevlana Xhelaluddin Rumi, është për shkak të ngjashmërisë së ndjenjave dhe emocioneve të larta dhe rrugës shpirtërore që e ndiqte Naimi si edhe Mevlana



Metin IZETI

Poezia Fyelli është pjesë e librit me poezi lirike Lulet e verës e Naimit, e cila ka tematikë të ngjashme me 18 vargjet e para të Mesnevi'së të Mevlana Xhelaluddin Rumiut. Në pjesën më të madhe të komenteve dhe trajtesave që i janë bërë kësaj poezie të Naimit, është diskutuar përmasa lëndore e fjalëve të përdorura në të dhe shumë pak është analizuar platforma shpirtërore e Naimit, e cila ka buçitur, me ndjenjën e dashurisë, ngjashëm si edhe ajo e Mevlana Xhelaluddin Rumiut. Në disa raste mund të haset të thuhet se Naimi e ka kopjuar Mevlanën në vargjet e kësaj poezie. Ky konstatim dhe komentet që janë të përqendruara vetëm në përmasën lëndore të poezisë, janë shumë larg prej kuptimit të realitetit me të cilin është djegur zemra naimiane.

Mes fjalës dhe realitetit

Hapësira poetike e Naimit, në pjesën më të madhe është e ndikuar nga konteksti sufik, i cili gjatë historisë, por edhe në qasjen e Naimit, bie në sferën e gjuhës dhe shndërrohet në "përmbajtje" vetëm si element përbërës i diktomisë përmbajtje-shprehje. Poezia Fyelli, në

realitet flet për të pashprehurën e përmbajtjes. Këtu fjala nuk është për marrëdhëniet e përmbajtjes dhe shprehjes, porse për pamundësinë e sferës së gjuhës me përmbajtjen dhe shprehjen e saj jashtë gjuhës, që i takon tejfizikes. Ngjashmëria e shprehjes së Naimit me klasikët e tesavvufit, siç është Mevlana Xhelaluddin Rumi, është për shkak të ngjashmërisë së ndjenjave dhe emocioneve të larta dhe rrugës shpirtërore që e ndiqte Naimi si edhe Mevlana. Pra, në këtë poezi bëhet fjalë për prezantimin e idesë së lartë nëpërmjet konceptit të njeriut të plotë (insan kamil). Shembuj të këtillë kemi pa numër, mirëpo që të mos zgjerohemi tepër, do të përqendrohemi në prezantimin e këtyre vlerave të Idesë së Lartë në poezinë Fyelli të Naim-Frashëri.

Të gjitha aspektet e jetës dhe veprës së Naimit në këtë ose atë mënyrë janë studiuar dhe analizuar, mirëpo njëra ndër karakteristikat më dalluese në aktivitetin jetësor dhe poetik të Naimit, në etikën dhe mendimin e tij - karakteri sufik Islam- gjithnjë është mbajtur në hije. Nuk ka asfarë arsye që kjo vetëdije e lartë e Naimit, e lartë po aq sa edhe e Xhelaluddin Rumiut, Hafizit, Shejh Sadiut, Goethes, Mjeshtër Eckhartit etj., të zvogëlohet ose zhvlerësohet qëllimisht. Naimi

është njohës mjaft i mirë i tesavvufit islam, e posaçërisht i tarikatit bektashian. Ai shumë bukur e njeh poezinë klasike sufike, hollësitë e saja, e krahas saj edhe të gjitha detajet e retorikës. Në poezinë e tij, në formë tepër tërheqëse, janë të vendosura vargjet e larta shpirtërore, ku në formë simbolike e ku drejtpërdrejt.

Naimi në veprën e tij shpeshherë thekson fjalën dhe relacionin e saj me realitetin i cili qëndron fshehur pas saj. Ai njëkohësisht orvatet që këtë relacion mes fjalës dhe realitetit, ta zgjidhë dhe ta prezantojë sa më mirë. Nuk ka dyshim se Naimi këtë zgjidhje e ka gjetur, poezia e tij është tepër e logjikshme, për shkak se ai është një poet i cili i ka mbetur i sinqertë esencës, dashurisë dhe botëkuptimit të vet dhe të gjitha këto ngjarje i ka kahëzuar dhe formuluar sipas ligjit të tij të brendshëm.

Poezia Fyelli, nga vargu i parë e deri tek i fundit, e parashtron retorikën emocionale të njeriut të plotë (insankamil). Naimi në trajtë shumë të ngritur e ka përfaqësuar në poezinë e tij përmallimin e njeriut për origjinën dhe eternalitetin e tij. Ai e ka shfaqur idenë e njeriut që nuk e ka humbur fizionominë e vete. Ai flet për artin, shkencën dhe filozofinë që nuk e kanë harruar pajtimin e tyre me parimin e natyrshmërisë, respek-

tivisht logosit. Edhe gjërat në poezinë e tij i rrëfejnë atyre që dinë ta përdorin sensoriumin e vet. Figura poetike në poezinë e Naimit na paraqitet si e llojllojshme dhe mimikë ekzistenciale. Figura e njeriut të përsosur në të na afrohet si peizazh, lojë e formave dhe ngjyrave, sikur pandërprerë ndryshojnë, që duken si akcidenca të tjerra mes vetes, por pa platformën e zezë. Një numër i madh i personazheve dhe përmasave reliefë gjeografike në këtë poezi të Naimit e kanë humbur kompetencën individuale të përkapjes ose aftësinë e vrojtimit autentik. Heideggeri këtë pozicion e konsideron si status specifik të artistit ose të pragmatizmit të së vërtetës. Kjo tërësi, thotë Heideggeri, është më se e qartë se është humbur në qytetërimin modern. Një paralele të njëjtë do të tërheq edhe Albert Camyja. Camyja do të thotë: "Nuk ka rrugë tjetër përveç asaj që të priten rrënjët që e lidhin njeriun vetëm me jetën dhe natyrën, gjegjësisht me lëndën. Nuk është e rastit që librat kryesore të ditëve të sodit, në vend që të merren me nuancat e zemrës dhe vërtetësinë e dashurisë, ata amullohen vetëm me gjykatësit, proceset dhe mekanizmat e akuzës dhe padisë. Në vend që të hapen dritaret metafizike para bukurisë botërore, ata me ngarkesë i

mbyllin në brengën e të vetmuarit dhe të huajit. Vargjet e Fyellit flasin për paralelizmin e qenies dhe të vërtetës, ose më mirë thënë e shprehin antropologjinë reale të zbulesës dhe kontaktit hyjnor me dukshmërinë dhe përmasën e kthimit drejtë Tij. Naimi e fillon poezinë e tij me fjalën "Dëgjo":

*Pa dëgjo fyellin ç'thotë
Tregon mërgimet e shkreta,
Qahet nga e zeza botë
Me fjalë të vërteta.*

Sugjerimi "dëgjo" është ekuivalenti i urdhrit "lexo". Do të thotë të dëgjosh atë që lexohet, të dëgjosh zërin e thellë të universit, të dëgjosh veten. Fyelli këndon, të gjithë dëgjojnë. Njeriu shikon gjithçka me një mësim. Dëgjimi është shumë i rëndësishëm. Ata që dëgjojnë, e vënë veshin dhe janë të vëmendshëm kanë sukses; Ata që dëgjojnë dhe binden, do të arrijnë shpëtimin. Ai që nuk dëgjon nuk mund të mësojë, nuk mund të dijë, dhe mendja e zemra e tij nuk mund të pasurohen. Ai që dëgjon është i respektueshëm ndaj universit, ndaj krijesave, ndaj njeriut dhe sigurisht ndaj vetvetes. Dëgjuesi ka krahë, ngrihet, fluturon dhe lundron. Ai që nuk dëgjon është i mjerë, zvarritet si gjarpër në plehra. Sa bukur është të dëgjosh gjithësinë, duke e parë para vetes. Sa e ëmbël është të dëgjosh ujin, në burime, përrenj dhe ujëvara. Sa bukur është të dëgjosh zhurmën e shiut, në ditët e nxehta të verës. Kudo

ka zë, edhe bota kthehet me zë, edhe hëna e shikon botën me zë. Sa mirë që mund t'i dëgjojmë këto zëra, sa mirënjohës jemi, apo jo? Sa bukur është të dëgjosh të vërtetën, sa e ëmbël, sa e këndshme, sa emocionuese, sa djegëse, por edukative, sa harmonike, por kuptimplote, sa e këndshme dhe edukative të dëgjosh urtarët, të dëgjojmë miqtë tanë, të dëgjojmë fëmijët tanë, të dëgjojmë frymëmarrjen e foshnjave ... Shkurt, të dëgjosh, të përqendrohesh në qenien... prandaj Fyelli fillon me fjalën "dëgjo".

Dëgjo fyellin...

Edhe fyelli, gjithashtu, është një simbol; përfaqëson universin dhe mirëpret njeriun. Naim Frashëri shpreh interesimin dhe dashurinë e tij për atë që mendon duke thënë "çka është kjo rrëfenjë?" Pra, dëgjo fyellin se ai është miku yt, i afërmi yt; sepse ka ankesa, ka një histori, ka gjëra për të treguar. Mos dëgjo vetëm zërin e tij përvëlues, dëgjoje edhe vetë atë, por përpiku ta kuptosh edhe atë histori të trishtë; sepse ka ankesa për ndarjet. Fyelli nga njëra anë është lapsi i cili shkruan dhe një mjet i shenjtë. Nga ana tjetër, fyelli është simbol i të ngriturve (evlia) dhe flet me gjuhën e tyre. Evliatë, në të vërtetë janë në afërsi me Zotin. Por, para këtij takimi kanë përjetuar shumë përmallime për shkak të largësisë dhe sa e sa tortura për shkak të ndarjes. Evliatë vajtojnë për dhimbjet e ndarjes me zë

të djegur si edhe fyelli dhe me këtë ua tërheqin kujdesin të neglizhuarve. Të qenët në këtë botë dhe brenda kafazit të trupit, do të thotë të jesh në gjendje penguese për takim me Zotin. Për ata që e dinë sekretin e të qenët një me Zotin dhe që e kanë perceptuar lartësinë eterne të kësaj gjendjeje, një pengesë e këtyllë është shkak për përmallim dhe vajtim të thellë. Prandaj kur fyelli thotë:

*Që kur se më kanë ndarë
Nga shok' e nga miqësija,
Gra e burra kanë qarë
Nga ngashërimet e mija!*

rrëfen për bashkësinë tonë me Zotin në botën hyjnore dhe e përcakton gjendjen e të qenët një perlë në arkën e Krijuesit të lartë, i Cili thotë: "Unë isha një arkë e fshehtë, dëshirova të dihem", gjegjësisht e të qenët substancë e njëjtë me Të. Krijesat janë paraqitur në ekzistencë me kërkesën e tyre për sy që do ta shohë dhe zemër që do ta dashurojë bukurinë e Krijuesit. Para etapës së dukshmërisë në qeniet nuk kishte "ti, unë". Ishte vetëm "Ai". Çdo gjë përbëhej prej Tij. Edhe njeriu që sot vajton si fyelli ishte në Të. Çdo shpirt i paraqitur në atë botë pyetjes "A nuk jam unë Zoti juaj?" i pati dhënë përgjigjen beli-po Ti je. Kjo thënie ishte hapi i parë i prezantimit të shpirtit si zjarr, ajër, ujë, dhe, bimë, kafshë dhe fillimi i aventurës njerëzore të tij. Shpirtrat pas tubimit të "Elestit" u ndanë dhe si

burra e gra rrodhën drejtë kësaj bote. Nga njëra anë u bënë edhe sy e zemra me aftësi për të shikuar dhe dashuruar bukurinë e Zotit. Ndërsa në anën tjetër, filluan t'i përjetojnë dhimbjet e të qenët të ndarë dhe larg prej Tij. Tash:

*Krahërore e kam çpuar
E kam bërë vrima vrima,
Dhe kam qar' e kam rënkuar
Me mijëra psherëtima!*

janë këto fjalë të fyellit, i cili ka zbritur prej botës së zotësisë në këtë botë kalimtare dhe në trupin e njeriut ka përjetuar vetë dhe ua ka përjetuar të tjerëve përmallimet dhe mallëngjimet më të mëdha. Njeriu sa më shumë të jetë larg prej origjinës dhe vatanit të vërtetë të tij, do të ndiej një thirrje për kthim dhe do të ndiej mallin e kohës dhe mundësisë për takim me Të.

*Dhe me botën e gëzuar
Bëhem shok edhe marr pjesë,
Dhe me njerës të helmuar
Bënem mik me besa-besë.
Puna si do që të bjerë
Unë qanj me mallëngjime,
Më çdo vënt e kur-do-herë
Psherëtin zëmëra ime!
Gjithë bota më dëgjojnë
Po së jashtëmi më shohin,
Dëshirën s'm'akupëtojnë
Zjar' e brendëshmës'm'a njohim.*

(Përfundon në numrin e ardhshëm)



POPRISHINI I KOHËS SONË


Monodrama "Vrasja e mushkonjës" është e shkruar në vargje, sepse për autorin Xhevdet Bajraj vargjet janë trualli që i krijon hapësirën e nevojshme për t'i shtrirë pakufi krahët e imagjinatës

Zyrafete SHALA

Monodrama "Vrasja e mushkonjës" e poetit Xhevdet Bajraj, e ribotuar nga Shtëpia Botuese "Armagedoni", edhe pse e shkruar qysh në vitin 2010, vazhdon të jetë aktuale edhe sot, ashtu siç ndodh rëndom me krijimet artistike që trajtojnë dilemat dhe përjetimet njerëzore në planin universal. Nga këndvështrimi i konventave zhanrore, "Vrasja e mushkonjës" vjen si rrëfim subjektiv i protagonistit, monologu i të cilit në fakt paraqet eksternalizimin e tendosjes dhe konflikteve psikologjike të tij, që shfaqen si përgjigje ndaj realitetit. Drama psikologjike e personazhit, që zë fill në pamundësinë e frymimit me aritminë e kaosit që e rrethon, duket që merr përmasat e tensionit të theksuar frustrativ: Nuk e di nëse unë jam duke qëndruar kokëposhtë /apo bota është përmbys. Në këto dy vargje mjeshtrërore/antologjike autori jep esencën e dezintegrimit të personalitetit, te personazhi i tij, tek i cili shohim prototipin e njeriut që nuk gjen hapësirë për realizimin e ego-idealeve në mjedisin ku jeton.

Pamundësia e ndjekjes së shpërftyrimin dhe kundërnaturshmërisë së realitetit, që rrezikon ta kthejë njeriun në një krijesë pa imagjinatë, shtron domosdoshmërinë e kërkimit të shkaqeve në momentet që shënojnë devijimin e njerëzimit nga natyra e tij, apo kërkimin në përsiatjet rreth jetës e të jetuarit, nëpër të cilat rrugëton personazhi, krahas rrugëtimit brenda vetes. Observimet e tij, rreth realitetit aktual dhe të kaluarës, përsërkohen nga ironia e fuqishme që shpeshherë arrin deri në sarkazëm, duke krijuar situata të jashtëzakonshme, që shpërfaqin degradimin e realitetit deri në një absurditet ku është e vështirë të gjejnë qetësi njerëzit që ëndërrojnë një jetë normale. Endja nëpër periudha të ndryshme të së kaluarës, është edhe një përpjekje e personazhit për të gjetur strehim nga trazimet e tij, por vështrimi në retrospektivë vetëm sa e thellon edhe më shumë greminën mes tij dhe asaj që konsiderohet njerëzore. Jo rastësisht rrëfimi nis me poezinë, trajtën sublime të shpalosjes së botës së brendshme, për më tepër me një poezi që shpërfaqë pamjen e trishtë të botës ku njerëzit, si qenie superiore të saj, garojnë për të tejkaluar njëri-tjetrin në egërsi dhe destruktivitet.

Preokupimet e personazhit, megjithëse pikënisjen e kanë gjithnjë brenda kufijve kombëtar, herë pas here i tejkalojnë ata, prandaj edhe shqetësimet e personazhit janë



njëlloj të kapshme për çdo njeri, pavarësisht se në cilin skaj të botës jeton. Rrëfimi i tij ngjan me një kolazh të ndërtuar me fragmente të historisë njerëzore, ku është vështirë të gjenden gjurmë sado të vogla të paqes. Në zërin e tij përmbledhet pakënaqësia e të gjitha qenieve që kanë shijuar kupën me helmin e kësaj bote, qofshin ata njerëz apo krijesa të tjera të pafajshme. Ai është njëlloj i brengosur si për klithjen e lules që po lind, si për vajin e pëllumbeshës nënë për të birin që i ngec fluturimi në fyt, për kafshët që mbijetojnë në kopshte zoologjike, të tjerat që notojnë në valët brenda konservave, apo ato që janë futur me forcë brenda zorrëve të veta. Dhimbja e tij shtrihet më tej te njerëzit që duke i ndjekur ëndrrat e tyre, për një botë më njerëzore, edhe pse të strehuar brenda manastireve të poezisë, u bënë pre e diktatorëve që e ushqenin 'paqen' me gjak njerëzish të shquar. Doemos që përballë një bote të tillë personazhi i monodramës ndihet i pafuqishëm, prandaj si reagim kërkesat e tij ndaj jetës i tërheq në vete dhe gjen siguri brenda mureve të shtëpisë.

Vendi i zgjedhur për strehim del të jetë i pasigurt, sepse aty duhet të përballlet me mushkonjën dhe gruan e tij, njëra, krijesë shumë e vogël por që i shkakton shqetësime të mëdha dhe tjetra, personi që ai i dhuroi dashurinë e tij; relacioni me to e përbën konfliktin themelor të mono-

dramës, ku personazhi vihet në situata sa komike aq edhe tragjike. Pamundësia për t'u mbrojtur nga një insekt aq i vogël si mushkonja dhe përpjekja për ta përballuar mllëfin e gruas që e bëri ta njohë dashurinë, tregojnë se ai është i humbur në luftën e tij kundër maliciozitetit që mbizotëron atje, në botën e madhe, jashtë shtëpisë së tij. Kjo sepse në një shoqëri ku e vërteta u takon gjithmonë atyre që qeverisin pa turp, nën moton In Gold We Trust, njerëzit që besojnë në të mirën e përgjithshme, deshën apo jo duhet të përdorin frenimin e ambicieve dhe ëndrrave, si mekanizëm mbrojtës, frenim ky që shpesh rezulton me shfaqjen e një disekuilibri emocional e psikologjik, që tregon se fati i tyre është i destinuar të jetë tragjik.

Akti përmblyës i monodramës dhe dialogu që e rrëfen personazhi, i zhvilluar me njerëzit që vijnë ta arrestojnë, mbetet të vendoset nga lexuesi nëse është real, apo i takon sferës së halucinacioneve, që vijnë si rrjedhojë e përshkallëzimit të çrregullimit, ashtu siç mbetet të vlerësohet edhe vetë gjendja e personazhit, nëse është i dehur apo ka pësuar ndonjë çrregullim emotiv. Por, një gjë është e sigurt, personazhi është i vetëdijshëm se ashtu si shumica e njerëzve, edhe ai vetë, ka lindur në një tregim të Gogolit. Me këtë aluzion që na shpie në tregimin Shënimit e një të çmenduri të Gogolit, autori Xhevdet

Bajraj, i sugjeron lexuesit një zgjidhje të këtyre dilemave. Personazhi i monodramës mund të shihet si një Poprishin i kohës sonë, një qytetar i botës, që duke u shfaqur si produkt i deformimeve të saj, epokë pas epoke, me zërin dhe klithmën e tij synon të zgjojë ndërëgjegjen e fjetur të njerëzimit.

Monodrama "Vrasja e mushkonjës" është e shkruar në vargje, sepse për autorin Xhevdet Bajraj vargjet janë trualli që i krijon hapësirën e nevojshme për t'i shtrirë pakufi krahët e imagjinatës, ashtu siç janë Kosova dhe Rahoveci toposet e përzgjedhura të poetikës së tij. Stili sublim, veçori tjetër e krijimtarisë së autorit, e përshkon fund e krye monodramën duke e bërë leximin të mjaftueshëm për të shijuar vlerat estetike të saj, pa qenë nevoja të ndiqet domosdoshmërisht e luajtur në skenë. Vlerësimi korrekt i ecjes së shoqërisë shqiptare nëpër shtegun e gjatë të shtet-ndërtimit, kritikën që nuk e kursejnë asnjë subjekt që keqpërdorë pushtetin, madje as popullin që i përcjell me indiferencë lojërat që bëhen në kurrizin e tij, krahas realizimit të lartë artistik, e bëjnë veprën e Xhevdet Bajrajt një barometër të gjendjes në të cilën ndodhemi. Prandaj edhe "Vrasja e mushkonjës", si pjesë e opusit të tij krijues, është një kryevepër e letërsisë shqipe në zhanrin të cilit i takon.

SHTYJENI PORTËN PA FRIKË

(Anisa Markarian, 15 DITË PRILLI)



Alma ZENELLARI

Nisur nga një kureshtje a joshje e emrit, vendosa të lexoj ditëprillet e Anisa Markariani-t, gruan me origjinë armene, mjeken, aktoren dhe skenaristen, e tani shkrimtaren, që merr përsipër të na rrëfejë nëpërmjet prozës së saj, tragjizmin tronditës të atij realiteti tronditës, rrëqethës, që jetuan mijëra shqiptarë brenda një territori të kufizuar e të kontrolluar nga diktatura.

15 DITË PRILLI të himosura, që më bënë të mos heq dorë nga leximi e për t'i shkruar gjer në fund atyre historive, që më kanë tronditur gjer në asht. 15 DITË PRILLI, një roman akuzë ku në çdo faqe ndihet rebelimi dhe pasthërrma e fuqishme e një gruajë "Unë akuzoj"...Një libër akuzë ndaj një sistemi të egër, ndaj një kohe të pakohë, që deformonte vetëdijshëm dhe linte pa ëndrra, pa shpresë një popull të tërë. Një popull, të cilin e çuan drejt humnerës, drejt humbjes së dinjitetit, kasta poshtëruese, e frikshme e njerëzve tru-deformuar. Kjo kastë e përligjur keqpërdori në mënyrën më brutale pushtetin e vet pervers vetëm e vetëm për ta shformuar, për ta shfarosur kujtesën e kombit.

Një libër ku personazhet nuk klithin, por ulërijnë për lirinë e vvarë, për mendimin e cunguar, për jetën që ndërpritej në mes nga shkaqe absurde. 15 DITË PRILLI janë ditë plot tension ku historitë njerëzore na përthithin dhe na bëjnë të ndihemi të befasuar, pse jo edhe të përloptemi. Ndaj jo më kot autorja na fton me delikatesë "shtyjeni portën pa frikë". Sepse të mos kesh frikë, kjo është pikë-fillesa për të kërkuar dhe depërtuar tek e panjohura.

15 DITË PRILLI është një roman brenda së cilit autorja ka ngjizur dhe mpleksur disa jetë, disa fate me dritëhije dhe mjegull, pa ngjyra të plota, në një terren të akullit në qytetin bunker. Histori rrëqethëse, ku jeta rrëshqet në një fije të padukshme peri, poshtë është ferri. Duke lexuar është e vështirë të mos e përthyesh fletën dhe të vazhdosësh leximin.

Dera është hapur tanimë. Historitë e hirta presin të shpërfaqen me tërë peshën e rëndë emocionale. E, pavarësisht kësaj, nuk ndalesh duke shfletuar me etje, duke ndjerë si thyhet shpirti njerëzor, delikat e i brishtë i atyre njerëzve, që natyra u ka falur dhuntinë e të qenit shpresë-ndezës, emancipues, apo thjesht qytetarë me mendime të mençura.

Fatkeqësisht sistemi i keqpërdori, i keqtrajtoi në mënyrën më absurde, duke i hedhur në flakët e një ferri ku demonët prisnin me padurim viktimën e radhës. Në flakët e atij ferri, që mesa duket nuk ngopej duke gëlltitur ndjenjat, mendimet, emocionet, shpirtin dhe rininë e atyre djemve e vajzave, të cilët edhe në skutat më të errëta të unit, nuk kanë paramenduar dhe nuk kanë dashur kurrësi të shkelin mbi Atdheun.

Anisa Markarian na sjell çuditërisht një roman atipik bazuar në vëzhgime dhe përjetime reale dramatike, therrëse. Na servir me dhimbje një roman këmbanë, që ka nisur të bjerë mbi kujtesën njerëzore. Kjo kujtesë, - thotë ajo, - është tabani i fortë ku çdo njeri duhet të hedh hapat për të përparuar.

Ajo kumton qartë e dhimbshëm përmes përshkrimeve danteske, se një popull që humb aftësinë për t'u rebeluar, herët a vonë përfundon i skllavëruar. Duke lexuar këtë libër të vjen ndërmend thënia brilante e shkrimtarit Bertolt Breht: "nëse harrojmë, atëherë historia e dhunës dhe e krimin do të përsëritet më forcërisht, më egërsisht. Ndaj nuk duhet të harrojmë".

Këto 15 ditë prilli, të ngërthejnë, të zaptojnë ndërgjegjen duke të lënë pa frymë. Heronjtë që deri dje kanë heshtur, tani trokasin brenda shpirtit, trokasin dhe duan të dalin në sipërfaqen e asaj errësire të pandriçuar të vetëdijes sonë, gati të hipnotizuar e të rraskapitur për më tepër se 45 vjet.

Ata gjallojnë duke na zgjuar dhe duke dashur që ndërgjegjja jonë të reagojë fort pas çdo traume, pas çdo krimi e dhimbje të fshehur, të paartikulluar me zë të lartë. Por të përjetuar pa as më të voglin dyshim, nga ata që guxuan të denoncojnë spontanisht të vërtetat e një sistemi monstër. Duke përballuar me forcë ato tërmete të vogla, ato tërmete të mëdha që i shkaktonte mbitoka. Romani sado i dhimbshëm në rrëfimën e ngjarjeve, me paraqitjen e njëpasnjëshme të personazheve, të jep mundësinë t'u afrosh, të mësosh prej tyre, të vuash, të tronditesh dhe të meditosh thellë. Disa prej tyre kanë fatin t'i duam, t'i çmojmë për guximin që fshehin, për mënyrën sesi e shohin jetën, duke shkelur në terrene të panjohura deri në ato momente kur vet jeta e tyre, merr një kthesë të çuditshme, rrëzohet e shembet çdo gjë dhe kapërcen të paimagjinueshmen.

Ndërsa të tjerë personazhe na lëndojnë me perversitetin e tyre. Ata nuk njohin as besë, as ligje, as rregulla. Sepse i vendosin dhe i shkelin vet sipas oreksit, duke futur në kurthin e sajësive, intrigave jetën e njerëzve të pafajshëm. Njerëz, që jetojnë midis reales dhe ireales, me histori dhe tradhti miqsh dhe armiqsh. Njerëz që duan të zbulojnë të vërtetat e pathëna, por që fatkeqësisht në këtë qytet bunker (vet Shqipëria ishte e bunkerizuar dhe martirizuar), të vërtetat manipulohen, fshihen, pse jo varrosen qëllimshëm për të skllavëruar dhe poshtëruar kujtesën kolektive të popullit, e cila domosdoshmërisht duhet të ndizet nga kujtesa e individëve që dinë "të guxojnë".

Është tronditëse të zbulosh se poet si Vilsoni, se student si Ida, apo shkrimtarë

si Vlad Krela besojnë në aspirata të larta dhe nuk mund ta pranojnë atë që zbulojnë. E vërteta që zbulojnë, guximi për të rendur drejt tyre, është sa tronditës, sa zhgënjyes. Është prekja e vet realitetit absurd dhe rënia pingulthi në pellgun e djallit. E megjithatë Markariani ka meritën ta paraqesë këtë jetë me të gjitha pore, me të gjitha shqisat duke ngritur skena sa reale aq dhe fantazmagorike. Sepse, me sa duket kjo përballje duhet të na bëjë të kuptojmë se realitetet e zyrnta me humnera të thukta vdekjeprurëse, nuk mund të përballohen pa ëndërrime, pa ato fluturime fluide onirike, të avullta. Pa një tango të fjolltë e të shpenguar. Pa ato, njeriu do ta kishte vështirë mbijetesën.

Por, Markariani ka meritën ta ngjyrosë, ta lehtëtojë gjuhën amtare, duke na e sjellë të pasur, shumë të pasur. Çuditërisht në çdo përshkrim ajo na ndriçon me fjalë të reja ose, siç i quajmë neologjizma që janë një kompozim i bukur gjuhësor, çka do të thotë se gjuha jonë ka një vlerë të jashtëzakonshme, bukuri dhe madhështi që duhen shfrytëzuar. Është një burim i pashtershëm që të ngazëllen. Veç kësaj rrëfimtarja e servir gjithë historinë njerëzore të qytetit bunker me një humor sa fin aq dhe meditativ me sekuenca të zgjuara. Ky stil humorit të bën jo vetëm të buzëqeshësh, por po aq të hidhërohesh dhe të meditosh përgjegjshmërisht. Në faqet e këtij libri nëse lexon me kujdes dhe kupton shpirtin e autores, do të kapësh padyshim edhe merakun, pikëpyetjet dhe shqetësimin e dukshëm të saj, nëse vërtetë ky komb, këta njerëz do të zgjohen duke luftuar të keqen dhe shëmbëlltyrën e saj. A thua vërtetë do të rebelohen dhe do të hyjnë në një epokë të re mendimi apo do të vazhdojnë të mbeten fatkeq të vetsugestionuar pas një kauze shkatërrimtare terroresh dhe përndjekjesh.


Cilët janë realisht Vladi, Ida, Bulëza, Teo, Zizi, Torrez, Vilsoni, Maks, i përndrituri pallëlarë e shtatvigan etj etj emra, po djelmoshat pa jetë, po vet Urthi? Edhe i dimë, e megjithatë na mjafton personifikimi i tyre për një të vërtetë të madhe të pazbëshme. Ata janë aty të ngërthyer fort pas çdo faqe libri, frymojnë, rebelohen, aktojnë, tradhtojnë, trazojnë e shpërfaqen me tërë vitalitetin e tyre. Për të na thënë mijëra herë "mos hesht". Mos hesht kur e vërteta mbytet, përdhohet, gjakoset. Mos hezito ta mbrosh edhe nëse të duhet "të mos jesh". Bëje për veten, për fëmijët, që kurrë ata të mos vijin në këtë jetë të mbarsur nga frika dhe terrori. Por, të vijin në këtë jetë të ngjizur nga dashuri të thjeshta të blatuara me bukuri shpirttrash. Duke i dhënë asaj portretin e tyre, plot dritë, ngjyra, plot fantazi dhe shpresë.

Nëse deri tani e kisha njohur Anisa Markarian si aktore dhe mjekë që rrezaton mirësi dhe fisnikëri qytetare, tani kam kurajën të them se ajo është edhe një shkrimtare e aftë, e mençur për të na servirur histori tronditëse, por të çmuara njerëzore nën fokusin e një drite të kthjellët e të qashtë, me tërë koloritin gjuhësor. Rrëfime ende të paeksploruara, ende të parrëfyera.

E gatshme për të na thënë sërish "shtyjeni portën pa frikë" ...

METAFORË E MADHE E JETËS

Dërvish Malluta është sinonim i të pushtetshmit, personi që ushtron pushtetin me anë të dhunës, fuqisë së ndëshkimit, asaj të nënshtrimit dhe frikës që mbjell përmes veprimeve të tij



Adriatik ZEQIRI

Çdo gjë nuk është zbuluar vetëm njëherë, do të shkruante Teki Dërvishi te romani i Herezisë së tij të madhe, duke iu kundërvënë kështu një ideologjie absolute, ngjashëm siç pohonte Derrida se çdo gjë nuk e ka vetëm një kuptim kur po tentonte ta zbriste nga fronti i hyjnore te vërtetën e arsyes.

Në vitin 1981 Teki Dërvishi do të nxjerrë nga botimi romanin e tij Herzia e Dërvish Mallutës, romani që nga shumë interpretues është trajtuar si kryevepër në zhanrin e prozës së Teki Dërvishit. Metafora e burgut, një tekst i dhimbjes, vuajtjes, vetmisë e në fund siç konstaton Nysret Krasniqi, frikës. Një metaforë e jetës. Jeta që lartësimin e saj e përjeton duke u vënë përballë vdekjes. Trupi i cili e kërkon varrin dhe arsyeja e cila është dominuese në raport me trupin që kalbet e që largohet nga shtëpia për të gjetur rehatinë e tij. Lufta e pashmangshme mes mishit e trupit që është njerëzor e tokësor dhe arsyes e dijës që është procesive e tejkohshme dhe hyjnore. E ëma që e përcjellë birin e saj të vdekur për të gjetur shpëtimin në dhe, në varr më saktësisht. I vdekuri që largohet nga shtëpia për të çliruar veten e tij nga vuajtjet e shtratit. Të të pranojë varri do të thotë të vrasësh vetminë që po të gërryen, të vdesësh do të thotë të jesh njerëzor, njerëzit nuk jetojnë vetëm, pra vetmia është dënim, është mbyllje është largim nga bota njerëzore, e duke qenë gjallë vetmia është burgim.

Në këtë tekst gjithçka është e figuruar, duke filluar që nga parateksti Herezia e Dërvish Mallutës, duke vënë pranë një fenomen negativ ose me thënë më mirë përjashtues, një shkarje

morale në një shoqëri tashmë të etabluar dhe referimin për këtë një personazhi si Dërvish Malluta. Herezia është shkelje e normave morale te dogmës apo sistemit. Pra, Herezia është pika fillestare e ndërtimit të një pylli të tërë kompleks të një diskursi të figuruar në çdo detaj të tij.

Fabula përfundon aty ku fillon, te shtëpia e fëmijërisë, te rruga që kurrë nuk është marrë apo te rragatjet e varrit që i përftonte e ëma. Fillon me të birin dhe përfundon me të atin, i cili arrin të ndjejë praninë e hijes së të birit të vdekur para 38 vjetësh.

Është rrugëtimi i i njeriut të vdekur në kërkim të strehimit të tij përfundimtarë, e që figuron më shumë se kaq. Gjithçka rrëfëhet nga personazhi simbol, një i ri i cili kishte kohë që përballej me sëmund-

jen e vetmisë dhe që nuk arrinte të gjente shërim prej saj. Në fakt, sëmundja e vetmisë nuk ishte aspak tjetër në një dekonstruktiv semantik të fabulës sesa pamundësia e inkuadrimin në konvencat shoqërore të një sistemi të vendosur e strukturuar në të cilat mund të gjendej një intelektual i ri, i cili sheh komplet ndryshe zhvillimet shoqërore dhe pikërisht botëkuptimet e tij do të binin ndesh me parimet e një sistemi demagogjik për nga vlerat, e sundues e shtypës për nga natyra. Ky intelektual është i përjashtuar si natyrë, gjegjësisht është i vdekur për një shoqëri përjashtuese. Atë edhe e ëma e largon nga shtëpia ngase mund të vuajë pasojat e shtypjes e persekutimit. Ai vetminë e përjeton si sëmundje ngase nuk e gjen bashkëmendimtarin ose bashkëvepruesin në udhëtim. Atë do ta vrasin veprat e tij.

Në fakt, ky roman është një tablo e madhe e ndërtuar në formë mozaiku për një shoqëri të cilën Teki Dërvishi e ka jetuar vetë edhe atë si dhimbje personale, një përshkrim i jashtëzakonshëm i një sistem vlerash të degraduara dhe, siç e cekëm më lartë, edhe një metaforë e burgut ose e jetës në Kosovë gjatë një regjimi shtypës e sundues. E gjithë kjo përshkruhet nëpërmjet personazheve të ndryshëm të këtij teksti, të gjithë me një emër simbolik dhe që paraqesin përfaqësueshëm tipizime të strukturave përbërëse të shoqërisë. Pra në nivelin struktural fabula zhvillohet si rrëfime të personazheve në pjesën e parë dhe inskenimi i një teatri e loje te veçantë në pjesën e dytë.

Dërvish Malluta është sinonim i të pushtetshmit, personi që ushtron pushtetin me anë të dhunës, fuqisë së ndëshkimit, asaj të nënshtrimit dhe

frikës që mbjell përmes veprimeve të tij. Ai është zot në teqenë e Sukës së Cërmjanit. Çdokush tjetër duhet të jetë nën urdhrat e tij dhe t' i përgjigjet lojës së tij. Pra, te Dërvish Malluta kemi të ravijëzuar në mënyrë brilante figurën e diktatit, shëmbëlltyra e jashtëzakonshme e një sistemi shtypës dhe diktatorial që vetë Teki Dërvishi po e jetonte. Dërvish Malluta mund të ishte drejtori i burgut, ai që komandon dhe drejton gjithçka, ai që rrahë e dënon. Ai është i vetëm, qëndron në majë të sistemit dhe çdokush e ka referencë atë. Ai i din të gjitha. Pra, ky është karakteri më tipik që mbetet shtylla e romanit në rrafshin semantik. Në ndërtimin sistematik të një bote funksionale si shëmbëlltyrë e një bote të jetuar si përjetim jetësor. Teqeja që ai drejton është burgu i shpirtave të trazuar, aty janë shpirtat që nuk e kanë gjetur rrugën drejt varrit, të padëgjueshmit, të panënshtuarit, imoralët, laviret, edhe gjarpërinjtë e zbutur, si dhe vend i njerëzve që durueshëm që e kalojnë jetën kot nën diktatin dhe dhunën të cilën e dinë e ndejnë dhe nuk kanë forcën a kurajon t'i kundërvihen. Mulla Hamidi i Verdhe dhe Kardhiç Lojtari janë dy personazhe që përfaqësojnë pikërisht njeriun e nënshtruar, i vetëdijshëm, i njohur por i pa forcë për të rezistuar, njeriu që kurrizin e ka vetëm për t' u nënshtruar.

Mulla Hamidi i Verdhe është poet, poet brilant nga më të mirët, ai ka një njohje filozofike të rrethanave. Ka një dije që shkon shumë përtej rrethit që është në teqenë e Sukës, të drejtuar nga Dërvish Malluta, por që nuk gjen fuqinë që t' i kundërvihet asaj që përfaqëson të keqen, shtypjen edhe dhunën njëkohësisht në atë vend. Mulla Hamidi lirish mund të identifikohet si figura e intelektualit që dorëzohet para diktatit si të sistemit dhe të shoqërisë gjithashtu, duke mos pasur guxim që të rezistojë dhe gjen prehje tek konformizmi që i ofrojnë rrethanat e Mulla Hamidi është disfatist dhe të vetmen gjë që dëshiron është mundësia që të tregojë se dija që posedon ka mundur të përdorej edhe për gjëra të tjera në jetë. Dialogu me të është në një diskurs të thellë filozofik, aty shpërfaqet një njohje e jashtëzakonshme. Në fakt, Mulla Hamidi është figura që më së shumti përdoret për të paraqitur bindjet e autorit ndaj shoqërisë në kohën e krijimit të tekstit, në kohë diktature dhe sundimi të huaj. Është interesante qasja ndaj koncepteve pesimist dhe disfatist. Pesimisti ka dyshime dhe nuk është i sigurt, në fakt nuk ka shpresë andaj edhe mungesa e shpresës edhe mund ta ngrit në një moment të caktuar që të lëvizë, ndërsa disfatisti tashmë e ka pranuar humbjen, ai është i shtrirë dhe nuk reziston, ai i ka dorëzuar armët që në fillim.

Ikje për shkak të dashurisë dhe jo për shkak të tëhuajsimin do ta interpretim si ikje prej të ngjashmes, prej të njëjtës, pra ikje nga vetvetja, ky është një tipizim karakterial i paraqitur në një diskurs alegorik të veçantë dhe i ravijëzuar në tërë tekstin me anë të dy

figurave si Mulla Hamidi dhe Kardhiç Lojtari. Megjithatë kur jemi te rendi i lojës simbolike, dhe te gjuha e figuruar e romanit, e kreyt romanin do ta konsideronim si një metaforë e madhe e jetës së robëruar, ose mund të interpretohet edhe si metaforë e burgut, Mulla Hamidi i Verdhe mund të jetë një figurë çelës, për leximin e tekstit si tekst alegorik.

Kardhiç Lojtari është më ndryshe nga Mulla Hamidi, ai ka reaguar, ka ikur për të mos duruar. Ai ka dëshirën, por nuk e ka as dijen dhe as fuqinë, ai është njeriu i varfër në kufijtë e ekzistencës, aty ku gjykimi është shumë i ultë dhe këtë gjë e kanë shfrytëzuar në mënyrë shumë të poshtër të gjitha sistemet për të rekrutuar njerëz për lojërat e tyre. Kardhiç Lojtari e kupton lojën në të cilën është, ai ka shpirtin e madh për të ndjerë vuajtjet e fëmijëve të tij, duke e fajësuar për këtë veten e tij, që nuk ka arritur ta mundë varfërinë, pa pasur asnjëherë në mendjen e tij se varfëria e tij ishte pikërisht rruga e tij e robërimit shpirtëror dhe fizik.

Kështu në një rend simbolik me anë të personazheve ndërtohet mozaiku kompleks i shpërfaqjes së një diktature, një shoqërie ku njerëzit vuanin shtypjen për shkak të bindjeve të tyre, për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike e nacionale, ku njerëzit ishin gjithashtu pushteti shtypës dhe dora e zgjatuar e tij siç ishte hafija Lik Gushëholli, që bënte punë të persekutimit dhe përndjekjes, për interesa të Dërvish Mallutës, duke shfrytëzuar lidhjen e tij të ngushtë familjare me te. Ai ishte i martuar me Kurtije Zanën, kushërirën e Dërvish Mallutës vetëm që të ishte më afër tij dhe të përfitonte privilegjet. Në tipizimin që i bëhet Lik Gushëholli, na del përpara një nga ato personazhet e rrëfimeve të historisë së vonë për nëpunësit e sigurimit të shtetit që merreshin me përndjekjen dhe persekutimin e intelektualëve të rinj, me burgosjen edhe vrasjen e tyre. Një diçka të tilla do ta shohim pas një dekade në një tjetër roman të Teki Dërvishit që i kushtohet Kadri Kusarit, mësuesit të tij të persekutuar nga regjimi Jugosllav. Pra, siç edhe është konstatuar, Herezia është e shumëfishtë në kompleksin e barrës së saj semantike. Është individi i cili nuk pajtohet përballë shoqërisë që tashmë ka kanone të etabluara dhe përtej të cilave nuk e përjeton jetën e saj dhe gjithashtu konvencat që shtypin vullnetet shpërthyes të individëve gjenial.

Këtë roman do ta shkruaj edhe një herë! Kështu thotë Teki Dërvishi, e në fakt kjo është thirrje për lexim. Kjo është një ftesë për të hyrë në shtresimet semantike të romanit, për të bërë zbulesën e tij. Këtë roman Teki Dërvishi do ta shkruajë përsëri pas më shumë se një dekade në rrethana tjera tashmë politike, duke nxjerrë në dritë romanin Palimpsest Dush Kusarit, që do të thoshim që është çelës për lexim të romanit Herezia e Dërvish Mallutës. Në të vërtetë Teki Dërvishi gjatë tërë jetës ka shkruar vetëm një roman, romanin e përjetimit të tij më të madh, jetën e tij.

Romane: "Lulja e kujtimit"

NJË REALITET LIRIKO-DRAMATIK NË KAPËRCCELLKOHËRASH

Kur shkruante romanin e tij Foqion Postolinë vitin 1922, letërsia shqipe nuk kishte ndonjë gjë të madhe të lëvruar në këtë zhanër

Qazim SHEHU

Foqion Postoli përcaktohet ndër prozatorët e parë të letërsisë shqipe dhe përfaqëson një letërsi që u shkrua me tone melodramatike, së bashku me Mihai Gramenon dhe Sterio Spassen. Romani i tij i famshëm, "Lulja e kujtimit", mbetet një ndër vlerat e rralla të kësaj letërsie, ku protagonistin udhëton në një det të trazuar ndjenjash sentimentale. Romani sentimental, i themeluar në Angli me Riçardsonin dhe me Gëten (Gjermani) "Vuajtjet e djaloshtit Verter", lexohet edhe sot me ëndje, sepse në qendër vihet idili i pastër i dashurisë. Këtë ideal e ka marrë dhe Foqion Postoli dhe e ka vaditur lulen e tij me një frymëzim të mrekullueshëm, duke na treguar sesa e pastër është dashuria, sa e fortë mbetet ajo, kur mbartet nga zemra të zjarra. Për nga thellësia e ndjenjës dhe forca e saj, ky roman realizohet si një model pasqyrimi në këtë aspekt dhe ta sjell para syve me një gjuhë filmike dhe dinamike rrëfimi, sikur ti je aty, tok me personazhet dhe po i ndjek hap pas hapi e me një ritëm të papërcaktuar gjithçka vuajnë ata. Por, ky idil nuk vihet në një situatë të qetë, përkundrazi, përmes ngjarjesh plot kthesa e të papritura, duket se ai do të shuhet, ashtu siç ndodh me një lule të vetmuar në një lëndinë që e përllan stuhia e dëborës; ndërsa në të vërtetë, autori ka arritur që lulen e idilit ta mbjellë në dy zemra të pamposhtura që, më në fund, e gjejnë njëri -tjetrin dhe fati e forca e tyre e qëndresës morale, i bashkon. Zgjidhja e romanit vjen me një fund të lumtur, por edhe fundet e lumtura jeta i ka, ashtu siç pasqyrohet edhe në romanet e Dikensit. Tema sentimentale e dashurisë përvëlimentare është tema qendrore, por në këtë roman ndërthuren edhe tema të tjera, -po aq të rëndësishme, tema patriotike me motivin shoqëror, ndërthurur me elementë realistë. Këto elementë (realistë), pasqyrojnë diferencat sociale në qytetin e Korçës në ato vite, kur Dhimitri, djali i një familje të varfër qytetare, i rritur jetim (babai mërguar në Misir dhe vdekur në një fshat të Sudanit) dhe ai ka mbetur vetëm me nënën, detyrohet të ndërpresë shkollën dhe të vihet në shërbim të zotit Kristo, tregtar i pasur. Dhimitri është një çirak (shërbëtor) mjaft i aftë. Por, ai bën përpjekje që të gjejë libra shqip, të cilat i lexon fshehurazi (janë fillim-vitet e shekullit njëzet). Olimbinë, vajzën e zotit Kristo, e njeh që kur ajo ishte dhjetë vjeç. Në bisedë me të i thotë: "Jam i sigurt se do të vijë dita kur Shqipëria të çlirohet nga thonjtë e Turqisë dhe të Patriarkanës. Ajo ditë do të jetë përlindja e kombit tonë dhe e gjuhës".

Të gjitha këto shprehin gjendjen

shpirtërore të flaktë-patriotike, por edhe formimin e tij. Dhimitri është një djallë shembullor, ruan marrëdhënie korrekte dhe të afërta me nënën e tij, braktis shkollën, tek e shikon që ajo mezi e nxjerr jetesën, duke bërë punë dore, vlerëson me një respekt dhe ndjeshmëri prindërore çdo sakrificë të saj, duke e ngritur lart e më lart kultin e adhurimit mëmësor, dhe kjo, aq natyrshëm dhe me bukuri të rrallë poetike, që të prek dhe të magjeps. I ndodhur në një realitet ku dashuria nuk e lë të kuptojë se ai i përket një shtrese të varfër, Dhimitri nuk është naiv, por ndjenja e dashurisë e bën të tillë, kur shumë mirë mund të hiqte dorë, por nuk mundet dhe as s' i shkon ndërmend. Ai vlerësohet dhe e vlerëson zotin Kristo, të atin e Olimbisë, aq sa vjen një cak, por kur zoti Kristo mendon që t' ia japë vajzën e vet Olimbinë, Nikos (sekretarit të tij grek), befas Dhimitri e kupton se aty ishte vetëm një çirak dhe se guximi i tij për të dashuruar një vajzë të një pasuri do t' i sillte andralla. Ky moment i çon ngjarjet drejt situatave të reja, drejt të papriturave të pakëndshme.

Zoti Kristo tregohet i dhimbshëm ndaj Dhimitrit deri në një moment të caktuar dhe deri këtu autori e përshkruan me simpati. Por, zoti Kristo është i pasur dhe një njeri i verbuar, ai ta kujton Orgonin të komedia "Tartufi" e Molierit, i cili kërkonte ta martonte me pahir të bijën me Tartufin, apo Nikollaq Jorganxhiun të Komedia "Karnavalet e Korçës" e Spiro Çomorës, që kërkonte ta fejonte të bijën me një njeri të pasur, për të mos shpenzuar për prikën e saj. Kjo tipologji karakteresh nuk është përputhshmërisht e njëjtë, ndërsa autori ka ditur ta skalisë zotin Kristo jo aq për naivitetin, sesa për babëzinë dhe besnikërinë e ngurtë dhe të ngjizur në psikologjinë e klasës së vet. Simpatia e tij për Nikon, një grek i kamufluar, vjen nga kjo, por edhe nga naiviteti i tij, kur ai nuk e kupton se me anën e martesës me të bijën, Niko kërkon t' i përllajë tërë pasurinë. Është vetëm qëndresa e Olimbisë që i prish këto plane. Me figurën e Nikos, Foqion Postoli ka gdhendur një tip Tartufi që zien nga brenda prej

ligësisë dhe etjes për përfitim, por që është i zoti, që në mënyrë metodike, këtë ligësi, të mos e reflektojë në asnjë tipar të sjelljes së tij dhe për këtë arsye bëhet i besueshëm për zotin Kristo. Vëmë re se ngjarjet nisën e ndërlikohen, intriga thuret me të papritura të mëdha dhe dramatike dhe është Olimbia ajo që do ta lajmërojë Dhimitrin për të keqen që po i përgatit Niko, duke e spiunuar për leximet që u bënë librave shqip. Me figurën e Nikos, Foqion Postoli demaskon qarqet greke e grekomane që vepronin me gjuhën e helmit kundër kombit shqiptar. Ky aspekt patriotik i romanit përbën një vlerë aktuale edhe për sot, ndërsa realitete të ngjashme ta kujtojnë fillim-shekullin njëzet.

Dhimitri ikën nga Korça për t' i shpëtuar përndjekjes nga kurthi që po i përgatitet. Ai e kupton shumë mirë se në ç'grackë ka rënë, por nuk mund ta harrojë Olimbinë, as ajo atë. Kjo pjesë e romanit dhe ajo në vijim, deri në fund, e shtjellon shumë bukur dhe me tone të fuqishme ankthit dhe të papriturës përmes ankthit, forcon më shumë ndjenjën dhe e rrit forcën e dashurisë, ndonëse ndarja jo për faj të protagonistëve, krijon largësi me vite dhe largësia ndikon në shuarjen e pasionit dalëngadalë. Lexuesi do të gjejë në roman skena me të papritura të mëdha, luftën që bën Dhimitri me ujërit në pyjet me borë, shpëtimin e tij nga komiteti bullgarë e të tjera ndodhi dramatik; por njëherit edhe qëndresën e tij morale, guximin, dashurinë për atdheun, dashurinë për Olimbinë. Të gjitha këto sikur i japin romanit një tisi përallë, por, në fund të fundit, në situatë të jashtë-zakonshme, përallë dhe realiteti i përziejnë kufijtë e tyre dhe nganjëherë i ndërkëmbejnë vendet.


Përvijimi i intrigës me të papritura është veçori e shkrimtarëve me fantazi të pasur, e prozatorëve që dinë ta qepin fillin e narrativës në një kostum të hijshëm të të treguarit. Jo më kot, ky roman lexohet me ëndje edhe sot dhe u ka rezistuar kohërave, pikërisht për vlerat që ai mbart dhe sugjestionin që krijon ngjarja, episodi dhe mjeshtëria në strukturimin e tyre, pa iu larguar qëllimit ideoartistik. Si i tillë, ky roman i ngjet një kantate për dashurinë e

pastër, e cila në të vërtetë ekziston dhe i sjell vetiu notat sentimentale, hovet dhe përjetimet lirike të një niveli të veçantë të shprehuri, me një gjuhë të pasur, edhe dialektore-korçare, që ka rëndësi në ngjyrimin dhe shfaqjen e një botëkuptimi, mendësie apo psikologjie të veçantë. Kompozimi i romanit i përshatet fatit njerëzor, i cili ndodhet në udhëkryq, për shkak të shumë faktorëve që i përmendëm dhe ndonjëherë duket se nuk mundësojnë gjë, por gjithsesi ky fat nuk është aq kapricioz, sa për të mos të të shpërblyer. I shtrirë në një hapësirë kohore të gjatë, ky fat dhe ky rrugëtim i Dhimitrit me Olimbinë, mbetet i lidhur me ndjenjën e dashurisë dhe të shpresës që i mban protagonistët në këmbë.

Kur shkruante romanin e tij Foqion Postoli (1889-1927) në vitin 1922, letërsia shqipe nuk kishte ndonjë gjë të madhe të lëvruar në këtë zhanër, por ai ia arrin të ndërtojë dhe të realizojë një roman që t' i rezistojë kohës dhe të futet në fondin e artë të prozës së traditës dhe të lexohet më kërshtëri edhe sot nga brezat e rinj të lexuesve, për disa vlera të qenësishme si: pasqyrimin e ambienteve të kohës, vizatimin e karaktereve dhe dhënien e psikologjisë së tyre, në përshatje me formimin botëkuptimor, intrigën romanore dhe lidhjen e episodeve në mënyrë të natyrshme; pasqyrimin e ndjenjës së dashurisë, të shoqëruar me forcën morale të karakterit, kontrastet e shumta dhe forcimin e idesë se dashuria nuk njeh hendek shtresor, me gjithë pengesat kur ajo është e pastër, e çlirët dhe e ndjerë; ndërtimin e një simboli domethënës, ku Lulja e ardhur nga Misiri (Egjipti), një lule e veçantë, si kujtim i babait të Dhimitrit, mbillet në kopshin e nënës dhe pastaj në bahçen e Olimbisë, për të dhënë idenë se dashuria është një lule që shtegton te zemrat.

Interesante është të vihet re se Foqion Postoli, si një prozator me talent ruan më së miri sensin e masës dhe nuk përdor përshkrime të tepërta dhe kjo e ruan dinamizmin e rrëfimit; aktivizon si diskurs mendimesh dialogun në pjesën më të madhe, duke e shërbyer artistikisht, si mjaft funksional dhe të shkathët. Edhe pse është një prozë deri-diku sentimentale dhe Foqion Postoli me Mihai Gramenon përmenden në "Historinë e letërsisë shqipe" si themelues të sentimentalizmit, personazhet e tij dallojnë nga ata të letërsisë europiane të kësaj rryme, sepse nuk i nënshtrohen një pesimizmi të skajshëm, nuk i mbartin dramën me ulërima dhe ofshe të thekshme, përkundrazi. Duke përshkruar dhe ndërtuar disa rrafshë ideorë, ky roman na paraqet çështje të patriotizmit, ditorisë, dashurisë, kulturës, çështje sociale dhe, në planin filozofik, aspektin e dashurisë në rrafshin social dhe të qëndresës së ndjenjës. Në roman do të gjejmë mjaft fjalë dialektore ose trajta fjalësh që ndryshe shkruheshin atëherë dhe ndryshe tani, të cilat vijnë në përshatje me kohën dhe formimin e personazheve.

Romani "Lulja e Kujtimit" reziston si një vepër e këndshme dhe e lexueshme jo vetëm për temën dhe temat e motivet që trajton, për idetë që përcjell në universalizimin e ndjenjës së dashurisë; një vepër ku gjejnë shprehje ndjenjat më të pastra të njeriut nëpër kohëra. Si e tillë kjo vepër mbetet e qëndrueshme dhe e lexueshme edhe sot.



POETI I UNIVERSIT TË DASHURISË

Kur ai e braktisi profesionin e gazetarisë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar për shkak të gjendjes së krijuar në Kosovë dhe trajtimit politik e policorë të Beogradit ndaj shqiptarëve, ai e gjeti kështjellën e pathyeshme fizike dhe shpirtërore, nga e cila e sfidoi diskriminim dhe dhunën. Ishte kështjella poetike



Fehmi AJVAZI

Arif Bozaxhi, është njëri nga poetët më të mirë të poezisë shqipe në Kosovë që përfshinë periudhën e tri dekadave të fundshekullit XX, e deri në ditët tona. Nuk mund të kemi një "histori" të poezisë shqipe në Kosovë, pa vargun kambanarë të Arifit. Ndonëse shkruan njësoj edhe në gjuhën turke, kjo nuk e vështirëson, përkundrazi e forcon edhe më shumë botën e tij artistike: motivin, figuracionin, mesazhin poetik etj. Pra, ambiguitetin krijues i këtij poeti që po ta lexosh me vëmendje krijimtarinë e tij, fitohet apriori përshtypja sikur ka ardhur në këtë botë që të merret me artin poetik, shtrihet me gjentilesë në universin e gjerë të letërsisë poetike. Në plotë raste, sidomos atëherë kur merremi me çështje kritike, studimore etj., të krijimtarisë së autorit të caktuar, ka të ngjarë që nuk mund t'i ikim subjektivizmit, emocionalitetit dhe formave të tjera shprehëse e ndaj shprehëse gjë që, kjo mund të na shtyjë që të përdorim fjalë dhe pandehma të thella, kumbuese ndërsa që, relacioni dhe faktografia mund të jenë të tjera! Kjo, në rend të parë na nxjerrë të shpërpushur në relacion me autorin – veprën, dhe na nxjerrë jo serioz në rastet kur "vogëlsinë" përpigemi ta hiperbolizojmë deri atje sa, nuk është fare...! Pra, duam të themi e të shkruajmë diçka që, është në fund të fundit joserioze dhe dëmtuese, sidomos për artin dhe shijet publike artistike. Ama, në rastin e z. Bozaxhi, jemi në pozicion kur ndoshta (sigurisht) s'mund as t'i themi dhe as t'i shkruajmë me një tekst s'i ky, ajo që mund të jetë korpus krijues poetik arifian dhe në bërthamë, cilësi, vlerësim dhe stil poetik arifian!

Kur ai e braktisi profesionin e gazetarisë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar për shkak të gjendjes së krijuar në Kosovë dhe trajtimit politik e policorë të Beogradit

ndaj shqiptarëve, ua ktheu shpinën privilegjeve që i ofronte pushteti! Ai pastaj e gjeti kështjellën e pathyeshme fizike dhe shpirtërore, nga e cila e sfidoi diskriminim dhe dhunën. Ishte kështjella poetike...

1. Kosova

"Flutra në grila/Buzëqeshje në bebëza/Në përfaqim me yje
Vrragë plage në ballë/ Letërnjoftim i gjakut/Kartolinë lirije në një fjalë". (Frankfurt, 1995)

2. Zarfi

"Kur në sytë e zogjve/ Korbat shuanin etjen/Një fëmijë nga Prekazi/Deshi t'ia dërgoj një letër diellit...!
Asnjë zarf nuk ia zuri/Letrën e përgjakur"

Megjithatë, ai kurrë s'pushon së qenuri një krijues që "paqen" e ndjenë s'i dashuri, dhe natyrën s'i një "kështjellë" ku s'depërton askush nga bota e së keqes! Epo, ekuivalenca krijuese e një shkrimtari, bie në sy për shkak të "pasqyrës" biografike krijuese. Pse? Mund të pretendoj secili të strukturojë dhe të krijojë shumë, varësisht nga profili krijues, por kjo të mbetet vetëm s'i një tendencë e kujdo qoftë nëse, s'është thënë asgjë, nëse krijimi s'ka formë artistike, me një fjalë, nëse nuk ka bërthamë graviteti krijues që tërheqë dhe rrëmben. Unë, jam thellë i bindur se poetika e Arif Bozaxhiut, është nga të rrallat në letrat shqipe. Pra, mendoj se është substanciale dhe, me një bërthamë tërheqëse të rrallë.

3. Zemra ime

"Në çdo fe/Në çdo gjuhë/Zemra ime
Adresë/ E dashurisë"

Kur e analizon krijimtarinë poetike, njëmend "dashuria dhe paqja" s'kanë peshim dhe as fund në shpirtin e poetit Arifi. Ato, janë dy galeritë kryesore të kështjellës krijuese që, padyshim, personifikojnë pandashëm gjendje, situata, figuracione, imazhe etj. Kritiku i letërsisë shqipe, Agim Vinca, e krahason poezinë e Arifit me atë të Garcia Lorkës, Tagorës, e Nazim Hikmetit! Ai, thotë: "Humanizmi, dashuria, kërkimi i fshehtësisë së gjërave, e përbëjnë trininë e shenjtë të treshes së madhe poetike".

4. Dashuria

"Dashurinë e kam shi të mendimit/ Blerim tëfjalës/ Pranverë të trupit"

Si e këtillë, krijimtaria poetike e Arif Bozaxhiu, vlerësohet lartë. Poeti dhe studiuesi Merxhan Avdyli thotë se personalitetin e tij, në fakt madhështinë njerëzore, e përjetëson në vargun poetik. "Arif Bozaxhiu ka një fjalor poetik origjinal dhe praktik me të cilin i ndërton figurat, u jep ngjyrimet shprehjeve poetike dhe qartëson individualitetin e vet krijues".

Arif Bozaxhi, ka botuar pak libra poetik, por ato janë çmuar vazhdimisht në forma dhe mënyra të ndryshme. Librat e poetit Arifi, janë përkthyer në plotë gjuhë të huaja dhe janë pjesë e antologjive botërore. Varg – pak, mund të cilësohen edhe librat e tij por, gjykoj se vargjet e vjershave të tij janë "fusha e male" që na gjëllojnë, "kambana" që bien pa pushim, dhe "tokë e dete" që na e freskojnë shpirtin. Plotë figuracion, simbollogji e mesazhe, mund të gjesh në pesë – gjashtë vargje të tij. Njësoj edhe plotë dashuri, dritë pa fund, lirika universale por, edhe fëmijëri, ëndërrim, kujtesë, humanitet: për atë që e kemi rreth e rrotull, dhe për atë që na mungon!

Të tjerat, s'i ndjenë dhe s'i kupton askush më mirë se poeti...

BIBLIOTEKË YJESH

për ta dashuruar gruan
nuk mjafton një jetë
pa i lexuar yjet.

LEJLEKU

në lumin Majna
një lejlek, pinte diellin.

VETMIA

shtrati pa grua
në arkën e vetmisë
kufomë mbi mua.

PAFAJËSIA

duke lut zotin
për pafajësinë
s'kam kohë as me vdek.

KOHA

koha në vargun tim
lëkurë e trupit
që pikon kaltërsi.

EPSHI

epshi pa dashni
farë e lulëzuar
në arë të huaj.

THATËSI

toka pa shi
deti një grusht hi
në buzë të zogjve.

XHELOZIA E PESHQVE

peshqit
të vetmen xhelozi
i kanë krahët e zogjve.

MBI INTERPRETIMIN



Ehat MUSA

Të gjitha artet kanë për qëllim të shfaqin një përmbajtje shpirtërore, e cila vihet në raporte të veçanta, sipas llojit të artit, me formën që e shpreh. Dallimi që Hegeli bën midis arteve ndriçon shumëçka në këtë pikëpamje. Arkitektura është e penguar nga materia, e cila mund të jetë vetëm aluzion simbolik në një përmbajtje shpirtërore, mund të krijojë vetëm një mjedis për shpirtin. Në skulpturë shpirti shfaqet nëpërmes formës materiale dhe konkrete. Piktura ka më shumë liri ndaj formës së jashtme, sepse spikat pamjen, të dukurit, ndërkohë që materia është e pranishme (për shembull ngjyrat), dhe nuk ka përmasë të tretë. Kjo liri, e cila u mungon arteve të lartpërmendura, merr kuptim të plotë në muzikë. Muzika, duke zgjedhur tingullin, madje edhe zhurmën, përpunon një materie të pakapshme, e cila, duke u zhdukur aty për aty, i kumton subjektivitetit të dëgjuesit brendësinë subjektive të kompozitorit. Për këtë arsye, muzika është më subjektivja nga artet, madje edhe më shumë sesa poezia, meqë përmbajtja mbetet abstrakte: tingujt dhe gërshetimet mes tingujve nuk kanë kuptim, nuk lidhen me një paraqitje të jashtme siç bëjnë fjalët. Për më tepër, tingulli është jetëshkurtër, efemer, prandaj muzika kërkon përtëritjen e pareshtur të aktit krijues nga ana e interpretuesit. Interpretuesi, sikurse edhe tingulli, komunikon; ai është lidhja e domosdoshme midis veprës dhe dëgjuesit, dhe ka si rrjedhim statusin e dyfishtë të krijuesit (rikrijuesit), dhe të dëgjuesit. Këtij statusi të dyfishtë i përshtatet një kërkesë e dyfishtë në interpretim. Për ta shprehur këtë përmbajtje abstrakte, subjektivitetin ideor, përmes një forme po ashtu abstrakte, kompozitori përdor tingujt, d.m.th. materialin që ka si veçori t u nënshtrohet raporteve të rrepta, matematikore. Ja dualiteti me të cilin ballafaqohet interpretuesi: një tekst që kërkon saktësinë e

të kuptuarit në mënyrë që të kumtohet me sa më shumë objektivitet e që gjithashtu duhet të gjallërohet gjatë procesit të interpretimit në mënyrë që të kumtojë brendësinë e tij shpirtërore. Para së gjithash, pra, është teksti (partitura), e vetmja gjurmë objektive e vizionit të krijuesit. Ai është e vetmja bazë serioze që duhet respektuar. Teksti duhet lexuar dhe jo thënë notë për notë; kuptimi dhe lidhshmëritë duhet të vihen në pah: në të njëjtën mënyrë regjisorin krijon një pjesë teatrore që është e mbaruar pa interpretimin e tij. Muzikanti gjendet përballë një paradoksi vetëm në dukje: partitura duhet respektuar, mirëpo ta respektosh nuk do të thotë të jesh skllav i shenjave që kurrë nuk ndërthejnë tërësisht veprën. Sado i përpiktë të jetë kompozitori, të gjitha gjërat nuk mund të shënohen. Kështu duhet kuptuar thënia e PabloCasalsit: Arti i interpretimit qëndron në luajtjen e asaj që nuk është shkruar. Çdo epokë ka rregullat e veta dhe muzikantët ngecin në problemin e interpretimit besnik nga pikëpamja historike. Por është e pamundur, sado që të duam, të luajmë sot sikur para dy ose tre shekujsh, thjesht sepse nuk mund të njëjtësohemi me njerëz të kohëve të kaluara. Çdo kohë ka mënyrën e vet të vizionit dhe rilexon veprat (por edhe faktet dhe ngjarjet në kuptimin historik) e kohëve të kaluara duke u dhënë një kuptim të ndryshëm dhe interpreton ndonjëherë nën dritën e zbulimeve të mëvonshme. T u japësh veprave një kuptim të vetëm, do të thotë t ua mohosh pasurinë e brendshme. Çdo interpretues u jep një domethënie të veçantë. Nëse struktura themelore respektohet, atëherë, edhe pse atmosfera ndryshon, shpirti i veprës mbetet, dhe e bind dëgjuesin. Koherenca me të cilën luhet vepra, është pasqyrim i domosdoshmërisë së brendshme, siç e quan Kandinsky, domosdoshmëria që ka zotëruar në krijimin e veprës.

HARTA SHPIRTËRORE E MURAT ISAKUT

Shkrimtari Murat Isaku (1928 - 2005) është vlerësuar si *"babai letërsisë shqipe të shqiptarëve të Maqedonisë"* apo si *"plaku i letërsisë shqipe në Maqedoni"*, që *"nëpërmjet imagjinatës dhe koloritit të pasur gjuhësor e mjedisor, arriti që ta shkruante sagën e banorëve të trevës së tij të lindjes - Tetovës me rrethinë"*.



Salajdin SALIHU

Murat Isakuu lind në fshatin Gajre të Tetovës, ku mësimet e para i mori në gjuhën serbe. Vazhdoi shkollimin në Normalen e njohur të Elbasanit, pastaj në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë. Kreu Shkollën e Lartë për Letërsi Botërore në Beograd dhe më pas Fakultetin Filozofik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, po aty, më 1953. Punoi si arsimtar në Gjilan, si mësimdhënës i gjuhës shqipe në Gimnazin e Tetovës, kurse më vonë punoi si gazetar dhe redaktor në Televizionin e Shkupit, derisa u pensionua. Në vitet '60, me një grup intelektualësh, u dënua për shkak të bindjeve politike, kurse burgun e vuajti në Idrizovë pranë Shkupit.

Murat Isaku krijimet e para letrare i botoi në revistën e vetme letrare "Jeta e Re", e cila drejtohej nga poeti Esad Mekuli. Vjershën e parë "Ajo" e botoi në vitin 1951, tregimin e parë "Oxhaku i një shtëpie" e botoi në vitin 1959, kurse përmbledhjen e parë poetike Zani i malit i botoi Rilindja e Prishtinës më 1961.

Murat Isaku ka botuar përmbledhjet poetike: Zani i malit (1961), Buzëqeshjet e mesditës (1963), Kurora e trollit (1963), Drithma (1975), Blana (1982), Ngushëllimi i bukur (1989), Shtara (1994), Egjër (1998), Dikush gropon në ballin tim (maqedonisht, 1999), Dollit për gjërat e humbura (2000), Ngutem të marr një frymë (2001), M'i këpusin kokrrat e frymës (2008) dhe Mëkatet e falura (2008); romanet: Dielli e din rrugën e vet (1965), Gjaku i sharrëxhinjve (1966/67), Flaka e vonuar (1973), Plagët (1975), Rreckaj (1979), Etje (1982), Damkat (1986), Shtjella (1989), Rrengu (1991), Fatprerët (1995) dhe Banesa në katin e tretë (2001), si dhe përmbledhjet me tregime: Unaza e djerrinës (1971), Gërsheta (1978) dhe Sheshitina (1982).

Krijimtaria e tij letrare ka reflektuar

te krijuesit tjerë shqiptarë, veçanërisht nga Maqedonia. Murat Isaku jetonte për letërsinë. Para se ta shkruante një vepër letrare vilit informacione për vendin dhe kohën ku e vendoste ngjarjen; imagjinonte në detaje botën ku do të gjallëronin dhe vepronin personazhet; detajonte itinerarin e lëvizjes së tyre nëpër kohën dhe hapësirën romaneske; studionte gjuhën që do ta flisnin. Në fletoret e punës gjejmë shumë fjalë që i kishte vjelë prej thesarit popullor, të përdorura dendur në romanet e tij. Kjo mënyrë pune na përkujton pohimet e Jan Parandovskit, sipas të cilit "romansieri mbledh materialin, ashtu sikurse shkencëtari, duke ia përshtatur temës që ka zgjedhur". Umberto Eko thotë se ta krijosh një roman do të thotë ta sajosh e ta ndërtosh një botë, një botë më të saktë të mundshme. "Kjo botë, teksa e ndërton, pak nga pak, bëhet e jotja, të cilën ia rrëfen një tjetri ose një lexuesi të së ardhmes", kurse "ky rrëfim bëhet nëpërmjet një stili të veçantë, pra me një stil që e kërkon pikërisht kjo botë e sajuar".

Murat Isaku njihet si kërkimtar i "fjalëve plaka e të harrueme", sikur thoshte Pjetër Bogdani, pra i fjalëve të rralla, që përdoren në trevat e vendlindjes së tij dhe në arealet tjera dialektore. Letërsia gojore i shërbeu si lëndë krijimi. Ai ishte njohës i mirë i gurrës popullore shqiptare dhe ballkanike, veçanërisht i folklorit të Malësisë së Sharrit, por edhe i thesarit gjuhësor të kësaj treve, të pasur me sentenca, njësi frazeologjike, arkaizma etj. Njihte psikologjinë e sharrjanëve, veset dhe virtytet e tyre, kodet e tyre identifikuese, virtytet dhe veset e tyre, prirjen e theksuar për rebelim, por edhe vullnetin për pushtet e nënshtrim. Krijimtaria letrare e Murat Isakut është ngjizje e përvojës jetësore dhe e përvojës së leximit. Përvoja e tij personale, veçanërisht nga jeta në burg, haset në shumë vepra të tij ku i paraqet raportet e individit me pushtetin, egërsinë e një sistemi totalitar me gjithë ingranazhet e tij.

Murat Isaku kishte kulturë të gjerë. Ishte njohës i madh i letërsisë, veçanërisht i asaj botërore, për të cilën kishte studiuar. Ai e kishte talentin e lindur, që kritika letrare e hetoi sapo i botoi krijimet e para letrare, por edhe përkushtimin e durimin për punë krijuese. P.sh. romanin Plagët e kishte rishkruar nëntë herë, derisa e kishte sjellë në fazën përfundimtare. Kur jemi te ky roman, duhet të shtojmë se ai ishte botuar edhe në Tiranë, gjatë periudhës komuniste, por me disa "ndërhyrje" të redaksisë.

Poezia

Murat Isaku e filloi veprimtarinë letrare si poet dhe e përmbylli opusin krijues me libër poetik. Për të poezia mbeti "dashuria e parë e paharruar". E preferoi shkrimin e poezisë me ritëm e rimë, por shumë herë nuk i qëndroi besnik metrikës klasike dhe krijoi

poezi me varg të lirë. Për Murat Isakun letërsia ishte frymëmarrje, religjion, magji gjuhësore, dashuri për njeriun dhe dialog me botën. Ai shkruante "për të mbetur njeri", kurse shkrimi për të ishte "dhembje e ëmbël që provokon të gjitha qelizat e gjalla dhe krijon simfoninë e harmonisë".

"Njeriun e dua mbi të gjithë, për atë shkruaj dhe jam gati të jap çdo gjë. Intensitetin e kësaj ndjenje e shpreh më mirë në poezi, sepse ajo m'i këndell nervat dhe më djeg (...) Fuqia e poezisë është fuqia shpirtërore e njeriut, ideali dhe ëndrra e tij për ta bërë botën më të këndshme, ku njerëzit do të thirren njerëz (...) Prandaj poezia nuk vdes para njeriut, për arsye se është nevojë e përhershme e orvatjeve të tij", thoshte ai.

Te librat e parë me poezi, sikurse Zani i malit, Buzëqeshjet e mesditës dhe Kunora e trollit, dominojnë tonet neoromantike dhe fryma sociale e vjershërimit. Kemi aty thirrje për drejtësi, liri, triumf të së resë kundër paragjyqimeve të së kaluarës apo "dregëzave të ndërgjegjes", sikurse i quan. Te përmbledhjet poetike Drithma dhe Blana, poeti është më intim. Kemi refleksione mbi jetën, vetminë, dashurinë, vdekjen, qëndresën, njeriun. Në përmbledhjet e mëvonshme, sikurse: Shtara, Egjër, Dollit për gjërat e humbura, Ngutem të marr një frymë ose M'i këpusin kokrrat e frymës, mbisundojnë lirikën meditative, më pesimiste, ku nuk ka më ofshama dhe pasthurma djaloshare.

Sipas studiuesit Ali Aliu, krijimtaria poetike e Murat Isakut pati karakteristika të caktuara përgjatë fazave të ndryshme të krijimtarisë së tij. Në fillim dominojnë tone të një euforie të përgjithshme, që ishin veçanti e letërsisë së kohës, ku preokupim kryesor artistik mbetet ekzistenca apo qëndresa kolektive nëpër histori, si dhe refleksionet sociale. Te këto poezi, sipas tij, haset ngjyrimi emocional dhe entuziast, "që ngjizen mbi kujtimin dhe vatrën e fëmijërisë, historikun dramatik të rrethit familjar, të ngushtë dhe të gjerë, real dhe metaforik". Aty kemi edhe "bredhjet dhe fluturimet intime, që kanë ngjyrimin dhe shijen e së kaluarës dramatike, ngarkesën e një dëshpërimi dhe zymtie, shijen e hidhur të fatit, njësoj siç e kanë brumosur dhe të lindur vetvetiu edhe një besim të thellë, një horizont të hapur dhe shpresëdhënës, drejt së nesërme".

Më pas, nga vitet e shtatëdhjeta e këtej, dominojnë poezitë refleksive mbi iluzionet e dikurshme dhe zhgënjimet aktuale, "me besim-mashtrimet, shqetësimet që lidhen me kuptimësinë dhe pakuptimësinë në jetën tonë, me paradokset, misteret dhe brutalitetin e përditshmërisë, shqetësim që lidhet me krizën e vlerave dhe vërshimin e jovlerave, shqetësim nga zhurma e shpifësve dhe denoncuesve, që është gangrena më dramatike e aktualitetit të sotëm shqiptar, të gjitha këto dhe të tjera të ngjashme do të jenë tani shtigjet e pagjumësisë poetike të Murat

Isakut...". Në përmbledhjet e fundit të tij, sipas Aliut, dominojnë lirikën meditative, që kanë një qetësi të brendshme dhe "një ekuilibër ndërmjet ndjenjës dhe urtësisë, një mall për motet e kaluara, për plagët e mbetura hapur, teksa shpresa dhe besimi i dikurshëm ka një shije të hidhur, madje, nuk mungon ironia ndaj një vetëbesimi të dikurshëm".

Tregimet

Murat Isaku është dëshmuar edhe si tregimtar. Ai botoi tri përmbledhje me tregime: Unaza e djerrinës (1971), Gërsheta (1978) dhe Sheshitina (1982). Disa tregime të tij janë shpërblyer me çmime kombëtare dhe janë botuar në gjuhë të huaja. Tregimi "Çalamani" është nderuar me çmimin më të lartë të jurisë, në konkursin e Rilindjes; "Thuthuqi i pavijonit numër katër", u shpërblye si tregimi më i mirë merastin e 30 vjetorit të revistës letrare "Jeta e re".

Murat Isaku, sipas studiuesit Hasan Mekuli, ishte i veçantë edhe si tregimtar. Sipas tij, Isaku, në lëmin e tregimit kishte kontribuar "që gjatë procesit të transformimit dhe emancipimit tonë shoqëror e kulturor të pasurohej praktika e tejkallimit të raporteve dhe trajtave të vjetra të jetës, të viheshin në pah mbeturinat e së kaluarës, por me masë - pa fushatë dhe pa krijuar dogma".

"Isaku vë në pah shumë tablo të së kaluarës, të evitimit të veseve dhe të prapambetjes, të personazheve karakteristike, me të cilët, në veçanti, realizohen qëllimi dhe atmosfera, ngase ata, kryesisht, janë bartës tipik të kohës dhe të zakoneve dhe raporteve të së kaluarës, pra domosdoshëm si dikush e diç që do kapërcyer, e pastaj të vihen lirisht në pah dhe të mund të përqafohen më dendur ideale dhe synimet e përgjithshme humaniste", thotë Mekuli.

Pas një leximi të kujdesshëm të tri përmbledhjeve me tregime do të shohim se krijimtaria e tij tregimtare, në vazhdimësi, shënoi ngritje cilësore për sa i përket mbarëshimit kompozicional, frymës psikologjike që sjell dhe rrëfimit klasik, por me tendencë për një rrëfim modern. Hapësira ku vendosen ngjarjet zakonisht është ambienti rural, pa munguar edhe ai urban. Për sa i takon kohës, shkrimtari herë pas here i zhvendos ngjarjet në të kaluarën më të largët, por nuk është e vështirë të tërhiqen paralele me ndodhitë e kohës aktuale.

Përmbledhja e tretë me tregime është më e realizuar se sa dy të parat. Këtë e ka pasur parasysh edhe autori, i cili përfshiu në kompletin e veprave vetëm përmbledhjen me tregime Sheshitina, megjithëse, në këtë përbërje, mund të ishin edhe shumë tregime nga përmbledhjet e para të tij, veçanërisht tregimi "Usta Rrahmetullahu", ku paraqitet një pamje groteske e një realiteti konkret historik. Aty njeriu dëshiron të çlirohet nga e vjetra, por i mungon sensi kritik ndaj mënyrës së re jetësore.

Interpretime

HANKOJA, KJO PERËNDESHË E VDEKJE-NGJALLJEVE

Nëse Homerit do t'i duheshin 24 këngë dhe rreth 15 mijë vargje për të lartuar dhe gdhendur bukurinë e Helenës, poetit tonë popullor i janë dashur vetëm tri vargje

Romanet

E njëjta gjë ndodh edhe me krijimtarinë prozaikë, pra në romanet dhe tregimet e tij. Te romanet e parë të Isakut del në plan të parë besimi për një botë më të mirë, më të drejtë, më të fisme, kurse në romanet e mëvonshme, kur autori arrin një pjekuri artistike, nëpërmjet zhvendosjes së ngjarjeve në një kohë më të largët historike, krijon një botë artistike e cila qëndron në opozitë me botën artistike të krijuar në fazën e parë. Në këto vepra kemi refleksione filozofike mbi jetën, dashurinë, egërsinë njerëzore dhe shtetërore, pendesën apo vdekjen...

Murat Isaku në fillim të viteve të '60-ta e ndoqi rrugën dhe metodën e shkrimtarëve paraardhës dhe prirej drejt krijimtarisë me frymë sociale dhe porosi humane. Prosedeu i veprave të para prozaikë të MuratIsakut, sikurse janë: Dielli e din rrugën e vet, Flaka e vonuar, Gjaku i sharrëxhinjve, është i ngjashëm me atë të veprave, të themi kushtimisht, të fazës së parë të Pasluftës së Dytë Botërore. Me romanet e mëvonshëm Isaku i përsosi teknikat rrëfimtare, strukturën romaneske, kapi dimensionet e reja ekzistenciale brenda një mjedisi të caktuar. Kryesisht në krijimtarinë e Murat Isakut tragjikja zë vendin kryesor. "Tragjikja është më e fortë se lumturia, sikurse edhe dhembja më e fortë se gëzimi".

Tragjikja, si kategori estetike, dominon përgjatë gjithë krijimtarisë së tij, qoftë poetike apo prozaikë, veçanërisht në romanet me temë nga burgu, që janë kulmet e krijimtarisë së tij letrare. Më shumti është i theksuar në romanet: Plagët, Rreckajt, Banesa në katin e tretë, Rrengu dhe Fatprerët.

Në krijimtarinë e Murat Isakut bien në sy personazhet memecë, sikurse Xhela Preja, që rrugëton mes heshtjes dhe shpresës së thyer, Eng Humballaqi apo i Dyti i qelisë së burgut, që vuante së bashku me studentin shqiptar, por pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja. Ata janë të fisëm, të ditur, që vuajnë dhe dënohen padrejtësisht.

Krijimtaria e Murat Isakut, shikuar si tërësi, është shumëdimensionale, shumëplanëshe, e shkruar me mjeshtri dhe kreativitet, me magji rrëfimi, mjeshtri sajimi të subjekteve romaneske, thurje inventive të kompozicionit. Si e tillë është sfiduese për një analizë shumëplanëshe shkencore. Krijimtaria letrare e tij është pasuruar vazhdimisht me ide të reja dhe është zgjeruar në planin tematik. Në romanet e fundit përqendrohet më shumë te problemet ekzistenciale, te tronditjet e brendshme shpirtërore dhe psikologjike të personazheve.



Majlinda RAMA

Nga buronjat e pashtershme të gurrës popullore, si gurë mademi e hejbe të rënda, rrjedhin vargje e këngë të ndezura prush. Ato s'janë gjë tjetër, veçse trashëgimi elitare e thesareve tona me rrënjët në popull.

Të tilla janë vargjet:

Hanko mos kalo mbi varre
se të vdekurit i ngjalle
të gjallët i vdiq fare.

Nëse Homerit do t'i duheshin 24 këngë dhe rreth 15 mijë vargje për të lartuar dhe gdhendur bukurinë e Helenës, poetit tonë popullor i janë dashur vetëm tri vargje. Dhe, sikur edhe Hankoja të përvijohet në po kaç vargje sa Helena, për të do të hynte në luftë jo Evropa me Azinë, por një botë e tërë! Në një luftë të pasosur në kërkim të pronësisë të Hankos. Po ç'ishte kjo Hanko? Një Hanko Tepelene, Përmeti? Vlore? Cila ish kjo magji që "mbyti" bukuroshët dhe trimat e çartur që s'u ndahej kënga buzës? Për origjinën e Hankos ne nuk dimë asgjë, por, padyshim që çdo zonë jugore do të donte ta kishte të vetën. Ajo, Hankoja, që shkonte e vinte nëpër varre, ajo që vdiste të gjallët që e shihnin në çdo copë dheu e toke.

Po kush ishte kjo grua? Ç'qenka kjo Hanko që zhbilancon botën, përmbys rende, ngjall të vdekur e vdes të gjallë? Eh, ku shkelte këmbë e saj! Këto janë vetëm tri vargje, por mbajnë brenda tyre një oqean plot margaritarë. Vështirë se mund të gjejmë një të dytë me një harmoni të tillë! Në këtë trivargësh, kemi vetëm një Hanko të papërcaktuar. Ç'thuhet për të? Si i kishte buzët, flokët? Po qerpikun, dorën, po syrin? Asnjë grimë fjale për të. Por ama, vargjet na lënë shumë pak vend të për të pritur përcaktimin, klasifikimin e Hankos si kulmin hieror të bukurisë femërore. Ajo, edhe pse në asnjë vend nuk thuhet, vjen gjithë sharm dhe nur, dhimbje-bukur, shpirt i valë dhe ulërimë. Ajo del mbi nimfat, mbi vitat, mbi perritë. Autori popull paralajmëron qysh në hyrje, teksa shfaqet si një klithmë e thekshme, për të zbritur pastaj në intonacionin gati përlutës, pjesëza "Mos!": Mos! Mos u bëj e marrë të çmendësh gjithë botën. Mos lësho pe nga hiret e tua!

Hanko mos kalo mbi varre...

Një tabelë që "ndalonte" vetëm hyrjen e Hankos. Mendo ni një çast: Ndalohet kalimi vetëm për Hankon! Duhej të ndihej e diskriminuar Hankoja, apo...? Po ç'donte kjo bukur "vrasëse" në territore të pushtuara nga shpirta pa trup? Pse ekzistonte kjo frikë? Ajo mund të ecte me hapin aristokrat në qytet, në trotuare dëshirash, ku t'i ngashën-

jente tejprtej të gjithë, pa përjashtim: të rinj e pleq, zeshkanë e biondë, burra e djelmosha. Cili ishte pengu i saj i mbetur kopshtit të përherëshëm njerëzor? Ndonjë i afërm i ikur, ndonjë familjar apo ndonjë i ri që i kish cekur zemrën thellë dhe e kish lënë të shënjuar? Cilado qoftë arsyeja, Hankoja ishte rrezik evident të shkelte në varreza; ajo rrezikonte ta pushtonte armatën e të heshturve, t'i ngrinte që aty e t'i skaliste me dëshira të valëta, për t'i kthyer në ëndërrimtarë të flaktë e për t'i spërklitur me aromë bukurie. E, natyrshëm, pasi jepet paralajmërimi, vjen shpërthimi i frikës si epidemi shoqërore që rrezikonte të mos nginjej me këtë dukuri femërore të pashoqe.

...se të vdekurit i ngjalle!

Ah, sikur! Hankoja duket se ia dinte sekretin këmbës së saj, ia njihte skutat e zjarra hapit të saj. Ajo ishte e vetëdijshme për pushtetin mbi këtë territor si plantacion lulesh, qëndisur me gur varresh për prehje nën kokë. Cilët ishin ata? Kalorësit e rënë në luftë? Ishin ata që vijnë në gjumin e vashave? Po Hankoja përballë tyre? E rrezikuara? Imune? Cili do të ishte fati i mëpastajmë i saj? Në mbyllje, krijuesi do të na sjellë ata. Ata që mund ta preknin këtë bukuri përrallore. Ata të rinj poterexhinj e gazmend që fshiheshin pas perdeve, pas pemëve, pas ndërtesave për të parë pakëz Hanko.

...të gjallët i vdiq fare!

Buçimë shpirti... Po, i vdiq fare?! Ç'është ky varg pleonazmik, me këtë përmbyllje brilante përmes "i vdiq fare"? Mirë që paskan vdekur, po paskan vdekur plotësisht, fare, fara. Hata e ardhur nga një Hanko. Ç'që kjo gjëmë?! Por, me gjithë "kobin", kalimtar i fundit që do të shkonte asaj ane, i gjalli mbi dhë, do të psherëtimte në formën e një amaneti:

Hanko syrin vetëtimë,
më vdis, në dhe të gjallë, shtirmë!

Sepse për Hankon ndërronin stinët, dimri bëhej maj, magjishëm nga pluhuri i këmbës së saj. Pikërrimë! Ishte ajo që vdiste të gjallët e ngjallte të vdekurit...

Hanko me derte!

Poeti popullor nuk mund të jepte më shumë, teksa përgjonte hapat e saj fërfërimë, që e vdisnin për t'u ngjallur sërish kur ajo të kthehej. Asnjë varg më tepër! Të gjithë e dëshironin këtë invers, këtë vdekje-ngjallje. Të gjithë e dëshirojnë edhe sot. Hankoja është nënzëri i çdo vajze, brenda psherëtimës: "Ah, sikur të isha një Hanko!". Jehona e Hankos mbetet si një legjendë në repertorin e artë të folkut tonë. Nuri i kësaj bukurie udhëton në shekuj.

NJË BISEDË SI PARADIGMË E GJYKIMIT TË MALËSOREVE NËPËR KOHË

(Fran Camaj, "Biseda me gjyshin imagjinar", roman, IB "Gjergj Fishta" Lezhë, 2022)

Anton GOJÇAJ

Romani "Biseda me gjyshin imagjinar" është libri i tetë i Fran Camajt dhe lidhet tematikisht, e deridiku edhe stilistikisht, me romanet paraprijëse të autorit: "Rruga e pamëshirshme", "Mëshira e pamëshirshme" dhe "Njeriu me mjekër të thinjur". Në pasthënie, autori shprehet se ky roman "përmbyll ngjarjet dhe jetën e kryepersonazheve kryesore të këtyre tre romaneve. Kerni pra një tetralogji që flet mbi fatet e shqiptarëve në Malin e Zi në shekullin XX dhe jo vetëm të tyre. Po ashtu pasthënie, autori rrëfëhet se ka pasur dilema lidhur me përcaktimin e llojit letrar, përkatësisht në cilin zhanër ta vendosë këtë prozë. Kjo ka rëndësi për arsye se shenja paratekstuale të cilën e vë autori udhëzon dhe përcakton pikënisjen e leximit, perceptimit dhe, rrjedhimisht, vlerësim-it të veprës, në radhë të parë për shkak të formimit të horizontit të pritjes dhe raportit të veprës me të vërtetën historike. Nëse quhet roman, kjo jep komoditet të madh sa i përket (mos)përputhshmërisë së të dhënave brenda veprës letrare, që është krijim imagjinar, me të vërtetën historike (ngjarjet, personazhet etj.).

Sikur autori ta kishte quajtur ditar, aty ishte paraqitur një pyetje tjetër – a është ditar faktiv apo ditar i jetës empirike të hartuesit? Autori e përkufizoi si roman dhe ashtu duhet të lexohet, perceptohet dhe trajtohet. Personazhet dhe ngjarjet e romanit janë fiktive, madje edhe kur thirren në ngjarje e personazhe të njohura nga e kaluara historike, apo edhe nga realiteti i tanishëm shoqëror, sepse ato në roman ekzistojnë në formën e shkronjave/tekstit dhe nuk ekzistojnë jashtë librit. Fjalët, mendimet, qëndrimet që thuhet/paraqiten në roman nuk duhet kuptuar domosdoshmërisht se janë mendimet dhe qëndrimet e autorit të librit, por si fjalë, mendime, qëndrime të personazheve letrare, ose të narratorit, që i shqiptojnë brenda botës së romanit, brenda logjikës poetike. Po si dhe çfarë thuhet në këtë roman të Fran Camajt?

Në roman mbizotërojnë dy forma rrëfimi, në vetën e tretë dhe në trajtë dialogu (si bisedë e Pal Ndrecajt me gjyshin e tij fantazmë). Kjo bisedë halucinantë ndërmjet të gjallit dhe të vdekurit (sikur) zhvillohet në vitin 2020, në periudhën kur në botë shpërthen epidemia e koronës. Pali është në moshën mbi 70-vjeçare dhe është edhe vetë gjysh, ndërsa gjyshi i tij kishte vdekur në burg në moshën 39 vjeçare, në vitin 1919 (njëqind vjet para kohës kur zhvillohet biseda) dhe rreth tridhjetë vite para lindjes së Palit. Biseda bëhet në formën e intervistës, dy bashkëbiseduesit shpesh i ndërrojnë rolet, sipas skemës njëri pyet tjetri përgjigjet. Secili rrëfen ngjarjet e epokës së vet, Pali ato që ngjanë pas Luftës së Dytë Botërore, kurse gjyshi i tij ato deri në vitin 1919. Bashkëbiseduesit gjatë rrëfimit shprehin qëndrime, vlerësime dhe gjykime personale për kohën e vet. Mirëpo edhe nëse janë subjektive, kjo nuk do të thotë se janë krejtësisht të njëanshme. Lexuesve bashkëkohorë, sidomos atyre të rinjve, shumë mendime të shprehura gjatë asaj bisede mund t'u duken anakronike, mendime të një mendësie të vjetruara dhe të kapërcyer. Të dy (Pali dhe gjyshi) mendojnë dhe flasin nga perspektiva e vet, në përputhje me karakterin e vet psikologjik individual, të formuar në



BISEDA ME
GJYSHIN IMAGJINAR

BOTIMET
FISHTA

Fran Camaj

ambientin etnik dhe kohën historike të caktuar. Janë paradigma të mendimit dhe gjykimit të malësorëve të dy kohëve. Pali flet si një malësor i shkolluar në gjysmën e dytë të shekullit XX, kurse gjyshi i tij si një malësor analfabet por mendjemprehtë i fillimit të po të njëjtit shekull.

Lexuesi mund të vërejë ndonjë mospërputhje dhe pastaj të pyesë, për shembull, përse gjyshi i Palit, që shtron pyetje si dikush që vjen nga bota tjetër, herë pas here (psh. në faqen ...) në rrëfim e sipër megjithatë i posedon disa informacione për ngjarjet në kohën e Palit? Në roman mbetet e paqartë si ka mundësi që një personazh që vjen nga bota tjetër për disa ndodhi në këtë botë është në dijeni, e për disa të tjera jo?

(...)
Tiparet e romanit, sidomos përmbajtja e tij, pastaj informacionet mbi ngjarjet e kaluara dhe porositë, këshillat për sjelljen në jetë, kërkojnë një lexues të caktuar – të interesuar për fatet e shqiptarëve në shekullin XX – me fokus të veçantë tek shqiptarët në Malin e Zi. Romani përmban edhe një shtresë të letërsisë me tematikë konspiracionin e agjenturave politike, si p.sh. kur, në mungesë të fakteve konkrete, shprehen hamendësime se disa vrasje ndërmjet malësorëve në SHBA janë planifikuar dhe nxatur nga shërbimet e fshehta të dy shteteve komuniste, Jugosllavisë

përkatësisht Shqipërisë. Ndërprerja e atyre vrasjeve, si me telekomando, menjëherë pasi komunistët e humbën pushtetin në të dyja shtetet, ngjall dyshimin e narratorit se ato vrasje mund të jenë ushqyer dhe realizuar pikërisht nga shërbimet e sipërpërmendura, për motive politike.

Dy gjyshërit gjatë bisedës, krahas informacioneve të ndryshme bëjnë shumë qortime dhe japin shumë porosi, me qëllimin që të ndikojnë në formimin e virtyteve dhe refuzimin e veseve të shqiptarëve, çka në fushën etike është në rregull, por që në shekullin XXI tingëllojnë si moralizime të tepërta. Në anën tjetër këto qortime nuk ia drejtojnë njëri-tjetrit, por lexuesit, çka veprën e nxjerr nga kornizat e funksionit artistik dhe e vendos në kornizat e funksionit pedagogjik.

Paraqiten edhe veçori zhanrore të romanit historik, por duhet rikujtuar se letërsia edhe kur, në rrafshin sipërfaqësor, përshkruan ngjarje nga e kaluara, në fakt flet për kohën e shkrimit, për aktualitetin shoqëror gjegjësisht, tërthorazi, për gjendjen e shoqërisë aktualisht. Përshkruan të djeshmen, duke iu drejtuar të sotmes dhe të ardhmes. Romani nuk është shkak dhe qëllim i vetvetes, sepse ka një tezë, që nuk është fataliste, sepse pa marrë parasysh sprovat për Malësinë ka shans. Mirëpo që gjërat të ecin mirë, Malësia nuk

guxon të braktiset dhe porosia kryesore e librit është drejtuar malësorëve të emigruar në SHBA është që të mos ia kthejnë shpinën vendlindjes, sepse këtë ia kanë borxh bashkëfamiljarëve dhe bashkëkombësve të mbetur, por edhe historisë rraskapitëse dhe të lavdishme të të parëve, që nuk e lanë Malësinë në rrethana e kushte shumë më të këqija sesa ato të sotmet. Po që se zbrazet Malësia, siç ka nisur, gjithë historia vetëmo-huese e fiseve trime të Malësisë do të humbë vlerën dhe kuptimin e vet.

Libri refuzon të klasifikohet brenda një zhanri të vetëm, sepse ai ka elemente të disa zhanreve: të romanit historik, romanit edukativ, familjar, social, psikologjik..., por edhe të konspiracionit – kur flet për vrasjet e malësorëve në SHBA. Parë si pjesë e opusit të plotë të Fran Camajt, ky roman sikur e vërteton tezën se krijuesi, në këtë rast shkrimtari, gjatë gjithë jetës shkruan vetëm një libër. Autori (narratori?) në pasthënie thekson se kjo vepër është vazhdim i dy romaneve të tij të mëparshëm, "Rruga e pamëshirshme" dhe "Mëshira e pamëshirshme", me çka rumbullakohet një trilogji romanore, që përshkruan, në mënyrë mjaft realiste, jetën (të mirat dhe të këqijat) e malësorëve shqiptarë, veçanërisht në periudhën e komunizmit...

Pjesë që mbeten në mendjen e lexuesit, për plasticitetin e rrëfimit dhe ndjeshmërinë që rrezatojnë, janë ato kur Pali përshkruan rininë e vet, gjegjësisht ditët kur ishte nxënës në Prizren. Megjithëse ka qëndrim kritik kur vlerëson të kaluarën e shqiptarëve në Jugosllavi, narratori sqaron se shqiptarët në Jugosllavi, e veçanërisht ata në Kosovë, kishin arritur edhe disa zhvillime dhe të drejta që nuk i kishin pasur asnjëherë më parë (në fushën e arsimit, kulturës, po edhe të ekonomisë). Duke pasur edhe këtë anë të medaljes, ai këshillon e duhet falur por pa harruar të këqijat që u kanë ndodhur.

E filluam nga pasthënia dhe po e mbyllim duke iu kthyer fillimit të romanit Pali, pas shumë vitesh që i kaloi në Amerikë, kthehet në Malësi, ku në hapin e parë takohet me mbetjen e së kaluarës: "në aeroport e prit i njëjti spiun i kohës së komunizmit". (...) "Kishte menduar se koha e spiunëve, mashtuesve, gënjeshtarëve dhe tradhtarëve kishte kaluar, por jo! U bind se ata ende ishin shumë aktivë e të angazhuar, por tani të maskuar dhe me metoda të tjera. (f.10)E gjitha u vërtetua, sipas narratorit, me ngjarjen e nëntë shtatorit 2006, kur u arrestua një grup "terroristësh" në fazën e përgatitjes, gjoja se po gatuanin një sulm terrorist. Zhgënjimi i Palit ishte i madh, kuçedra e së keqes kishte mbijetuar dhe ishte shfaqur e gjallë edhe në periudhën e demokracisë.

Në roman shprehen jo pak tema, preken disa pika nevalgjike, por, si çdo plagë tjetër, ato eliminohen veç me trajtimin e duhur, dashamirës dhe me përgjegjësi, e jo me futjen nën tepih. Sepse sado që të mundohesh për ta fshehur lulen e së keqes, kundërmimi i saj megjithatë do të ndihet..., e kjo nuk është në interesin e askujt. Romani ka elemente të kronikës dhe të analizës politike nëpër kohë... Po ashtu është si njëfarë pedagogjie patriotike dhe etnocentrike, e shpëlarë në virtytet etike. Romanet e Fran Camajt janë të shkruara nga perspektiva e minoritarit, pjesëtarit të pakicës. Ndoshta diçka është rritur (hiperbolizuar), por thelbin e gjësë askush s'duhet ta injorojë.

SHKRIMTARI KOREANOJUGOR QË SHPËRTHEU BUJSHËM!

Veprimtaria e tij letrare shtrihet në disa drejtime. Si edhe shumë krijues botërorë, edhe Ko nis me poezi për të vazhduar me prozën, romanin, pastaj esenë, kritikën letrare, biografinë e autobiografinë, me përkthime etj.

Xhevat HALILI

Ko Un u lind në vitin 1933 dhe është poeti, eseisti dhe shkrimtari më i njohur i Koresë Jugore me më shumë se një qind e tridhjetë vëllime të botuara të poezive, eseve dhe shkrimeve imagjinative e shkrimeve të tjera. Ko u rrit nën sundimin japonez, andaj edhe u shqua për reagimet e bëra ndaj masakrave të luftës së Koresë gjatë viteve 1950-1953. Kështu, ai në vitin 1952 hynë në rendin e murgjve budistë për të parë për së afërmi dhe nga brenda jetën e përkushtimit fetar që zhvillohej aty prej nga do të del pas dhjetë vjetësh. Në këta tempuj budistë që Ko do t'i njohë e rinjohë, do të shtrëngohet e do të jepet pas shëlbimit fetar dhe meditimit e soditjes si forma për të gjetur baraspeshën shpirtërore. Pas kësaj përvoje jetësore, Ko do t'i përkushtohet karrierës së jetës letrare e veçmas poezisë. Si të gjithë poetët me shpirt e mendje të lirë, rebel, i qetë e i urtë për nga natyra, edhe ky do të bëhet militant i zjarrtë kundër diktaturës dhe padrejtësive sociale, andaj edhe shpesh e përgjatë kohë do të dënohet dhe do të dërgjet nëpër birucat e burgjet e vendit të tij. Nga vitet 1970 Ko Un-i angazhohet në shumë fronte. Ai do të jetë njëherazi kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve të lirë të Koresë dhe anëtar i Komitetit të lëvizjes së qytetarëve për demokraci, kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve të popullit dhe drejtor i Shoqatës së arteve të popullit.

Fillimet e para letrare te Ko-i datojnë aty rreth viteve të pesëdhjeta, me botimin e poemave "Tuberkulozi" dhe "Porositë e një nate pranverore", të cilat si nismë u botuan në revistën prestigjioze "Poezi moderne". Më pastaj, shumë shpejt ai hartoi përmbledhje të shumta poezish, mes të cilave me këtë rast do të përmendim: "Piangamseong" më 1960, "Dielli", "Katundi i një ligjërimi të ri" më 1967, etj. Pas një demokratizimi të brishtë e të hollë të vendit, në vitin 1988 Ko Un-i do të angazhohet për ribashkimin e gadishullit koren dhe bënë një udhëtim e viziton Korenë e Veriut. Për punë e tij krijuese, ai është shpërblyer me çmimin e Shkrimtarëve koreanë në vitin 1974, Joong-Ang në vitin 1991, Daesan në vitin 1994 dhe çmimin Man-hane në vitin 1998.

Veprimtaria e tij letrare shtrihet në disa drejtime. Si edhe shumë krijues botërorë, edhe Ko nis me poezi për të vazhduar me prozën, romanin, pastaj esenë, kritikën letrare, biografinë e autobiografinë, me përkthime etj. Kur u vunë konturat e fillim-fjalës, u dha të kuptohet se këtu nuk e kemi ndër mend të merremi me analizë të përimtuar të krijimtarisë së tij, por le të na lejohet të shquajmë me këtë rast, megjithatë, ndonjë nga segmentet më të rëndësishëm të saj.

Vepra e këtij krijuesi zë fill dhe



koncentrohet përreth nocioneve dhe kuptimeve që lidhen me pikëllimin dhe shpresën e thyer, ato të fërkimeve dhe kundërthëniesve ekzistenciale parë nga këndvështrimi i një nihilizmi që me kohë do të tretet. Teksti poetik i Ko Un-it sikur do t'i ngre një përmendore zyrtësisë, absurditetit e shpresave të tretura e të humbura, për të mos thënë vetë vdekjes si akt. Përmes vargjeve të poemave, ai i këndon kotësisë së jetës, një pesimizmi të kapërthyer e të kapluar nga hijet e vdekjes që njëherazi, tekembërmbja, sublimojnë jetën si përzgjedhje përfundimtare. Edhe përkundër të gjithave, poeti edhe në këtë stad vdekjen nuk do ta vijëzohet me linja frike porse me fije të lidhshmërisë së urtësisë filozofike budiste.

Diskursi i tij letrar në përgjithësi ka elemente që veprën e tij e vë në maja të poezisë mbarëbotërore. Kur flasim për poezinë e Ko-it, për aq sa ia kemi dalë ta njohim atë, nga rrugë dytësore, mund të themi se kjo poezi shquhet si fjalë poetike që bart ndjenja, emocione e mendime që shkrihen në sinteza shprehëse me harmoni të plotë për të përcjellë porosi vlerash universale, pikërisht nga largësitë e Lindjes së largët.

Njohësit e veprës së tij, këta nga Evropa, përmes të cilëve lidhemi ne, thonë se aty nga vitet e shtatëdhjeta krijimtaria e Ko Un-it bën një kthesë në stilin e tij prej shkrimtari dhe kjo ndodhë veçmas me botimin e veprave "Rrugës së katundit Munui" në vitin 1974, "Duke u ngjitur bjeshkës përpjetë" në vitin 1977 dhe "Rruga e agut mëngjesor" më 1978. Shkrimtari tani përshkruan me intuitë të hollë zbrazëtirën dhe përbuzjen gjatë krajetave të kaluara, me qëllim që t'i kundërshtojë fillit të historisë e realitetit të vrazhdët të epokës së tij. Kështu, shkrimtari ndërton një pikëpamje kritike për evolucionin e shoqërisë koreane, pa u larguar aspak nga njohuritë e thella historike. Ky ngazëllehë me këndimin e thjeshtë që bën kur i këndon "shpresës" pa mburrje e krekosje,

përkundrazi këtë e paraqet me përlujtë të dinjitetshme si njeri i bindjeve të forta për rrugën që duhet të ndiqet për në majat e Tibetit e të Himalajeve.

Parë nga ky aspekt, tekembërmbja, vargu i tij në të shumtën e herëve, mundohet të përligj luftën për ribashkim kombëtar, në mos tjetër, atëherë të vlerave shpirtërore të një kombi të ndarë më dysh! As Ko Un-i nuk do të mund t'i shmanget rolit mesianist prej poeti, andaj shprehjen dehëse poetike apo formën e mistifikimit e bart vetëdijshëm dhe e sjell edhe në Evropën e qytetërimeve të lashta, në Francë, në Mesdhe, në djepin e moçëm të muzave romake, ilire e greke. Me rastin e ardhjes së tij në qytetin Provansë, Ko do të shprehet: "Me të arritur këtu sërish e ndjeva erën e detit. Këtej pari, në Mesjetë, atëherë kur poezia këndohej, janë endur poetët trubadurë. Me të vënë këmbën këtu edhe unë u bëra trubadur". Ky është një ilustrim i një shembulli jetësor të poetit, i cili, siç shkruan shtypi francez, te varri i poetit të madh Pol Valeri në qytetin bregdetar Setë, është shprehur: "Desha të bëhesha poet. U bëra poet. Dje isha te varri i Pol Valeri-së dhe përpara tij e hoqa nga koka kapelën time. Në Setë pashë dhe dëgjova valët. Valët që përkundin jetën, duke u përthyer me miliona herë gjatë ditës, siç thuhet. Këtu, në bregdet zogjtë këndojnë. Ndërsa në Kore zogjtë qajnë, si grilotë... si derrat. Edhe unë po qaj. Ndërsa poemat i përcjellin këto të qara."

Lajtmotivi i poezisë së tij, shpesh është lektisja, malli a zemra e këputur të yshtura nga jeta e poetit apo edhe nga gjendja sociale e mjedisit, por edhe nga vetë situata absurde e vendit dhe e popullit prej nga del e vjen poeti. Në vitet e tetëdhjeta, gjatë periudhës së viteve të rrëmujës së madhe sociale në Korenë e Jugut, Ko Un-i boton dy poema epike "Gjenealogjia e jonë" dhe "Bjeshka Baek-dusan", në të cilat poeti pasqyron dramën e përditshmërisë dhe krajetat me të cilat përballesh bashkatdhetarët tij.



HUTINA

Hutina në pikë të ditës
Me sytë dollap
Gjë nuk sheh
Pret!
Nata jote patjetër do të vijë.

SHPRESA IME

Kur vendi të ribashkohet
Detyrimisht një gjë duhet ta bëjë
Ajo që do të duhet ta bëjë
Do të jetë, më e para, të mos bëhem atdhetar
Se gjer atëherë do të jem atdhetar mjeran
Madje duke u bërë një plak pusht
Mbase duke u bërë plak-matuf e'kloshar'
E për shok shpirti do e marr ta kern
Gogolin e fusharëve të zbrazëta e bosh.

PËR ASGJË

Rruga kur merret vetë
Thuhet se u mor
Mbase na u tha ta merrim
Rrjedha e ujit që vete për kurrjë lëndinës
Thuhet se rrjedh
Do i jetë thënë të rrjedhë
E shkreta urtësi e kësaj bote

TË FSHEHËSH GJURMËT

Tek impresionistët, ekzistencialistët, ekspresionistët gjurmët vërehen qartësisht, thuajse tredimensionalisht


(Hamdi) Erjon MUÇA

Hermetizmi, mund të quhet edhe arti i fshehjes, ose është, arti i fshehjes së gjurmëve; vetë Ungaretti shkruante: poezia është aty ku fsheh diçka. Gjurmëve të leximeve, influencimeve, për të mbërritur në një formë arti që të jep ndjesinë e të gjithësishtes, por pa kaluar në veçanti, as artistike, as psikologjike, as filozofike, as metafizike, e as legjendare. I ndjen të gjitha këto që sapo përmenda, por qartësisht asgjë nuk perceptohet.


Tek impresionistët, ekzistencialistët, ekspresionistët gjurmët vërehen qartësisht, thuajse tredimensionalisht. Për shembull, në poezitë e Jorge Lusi Borges-it, vërehen qartësisht jo vetëm gjurmët e poetëve mbi të cilët ka reflektuar, por edhe besëtytnitë e të gjitha etnive të cilave ai u përkiste, nga atë anglosaksone, tek ato latine dhe të banorëve autoktonë të Amerikës Latine, me të cilat etnitë e shumta europiane përzenë gjakun dhe gjenetikën e tyre, madje te Borges-i vërehen qartë edhe gjurmët e filozofive me të cilat ai u mor gjatë. Kjo tek ai nuk përbën një çudi, arti poetik i Borges-it mund të cilësohet shumë mirë si ekspresionizëm, përpos se realizëm magjik. Përbën çudi tek Quasimodo, që është i vetmi hermetik që nuk i fsheh aspak gjurmët, nuk ka kundërshtim me Ungaretti-n apo me të paarrtshmin Montale. Mirëpo, edhe kjo e ka një shpjegim thuajse logjik. Borges-i, për shembull, nuk i përkiste një etnie të pastër, autoktone, aq sa për të humbur edhe gjurmët e prejardhjes së vet; ai ishte një përzierje etnish të përcaktuara në kohë dhe rrethana dhe kjo ndikoi në gjithë formën artistike të tijën; madje edhe jetesa e tij në një vend me një konglomerat marramendës etnish ka ndikuar thellësisht në artin e tij. Montale, i cili është fshehësi më i madh, ishte nga Liguria, dhe rrënjët i tij, humbnin në errësirën e kohës, po në rajonin e Liguriës, ndaj ai ndihej i pacenuar nga mëdyshjet, apo hamendësimet e përkatësisë. Quasimodo ishte i ngucur nga hamendësimi se mos ishte pasardhës i atyre që krijuan manjagrecën dhe duke përzier gjakun e tyre me latinët i dhanë jetë një etnie të ndryshme si nga të parët ashtu dhe nga të dytët. Ose një etnie që të mund t'i përmbante të dyja filozofitë. Ndaj edhe tek Quasimodo vërehen gjurmët, ndihen mëdyshjet dhe përzihen filozofitë. Ndërsa tek Ungaretti, një rol të madh luajti

vendlindja e tij; ai prindërit i kishte nga Toskana, me rrënjë që humbasin në të, por lindja e tij në një ambient multidimensionalisht të kundërt me atë italian, përbalja e tij me kulturën frënge në mes të ambientit arab, bënë që hera herës ai të lejonte perceptimin e ndonjë gjurme.

Tani le të shohim me vëmendje se si, gjurmët, është thuajse e pamundur t'i vëresh. Poezinë "Jam një krijesë" Ungaretti e krijoi gjatë Luftës së Parë Botërore, ndërsa ndodhej në llogore. Dhe e nis me "Si ky gur - i S Mikeles". Pra jam një krijesë si ky gur. A nuk thuhet në bibël që në fillim Perëndia krijoi qiellin edhe tokën. Pra mbi këtë planet, të krijuar, asnjë nga krijesat nuk është më pak ose më tepër e vlefshme se të tjerat. Nëse pretendojmë që ne kemi një shpirt, si krijesë e perëndisë duhet që edhe ky gur të ketë një shpirt. Më pas ai nis dhe na përshkruan vetitë e këtij guri: "kaq i ftohtë - kaq i fortë - kaq i tharë - kaq refraktar". E bukura është se kur i lexon të duken të gjitha veti njerëzore. Mos ndoshta ne, duke u bazuar te vetitë njerëzore kemi përcaktuar vetitë e sendeve dhe aspak e kundërta? Mirëpo, e vetmja veti që më ngacmonte, deri në çastin që e zbulova, ishte fjala refraktar. Refraktare është cilësi krejtësisht lëndore, do të thotë përthithës i nxehtësisë, durues i temperaturave të larta që nuk pëson ndryshime të dukshme. Mirëpo në artin poetik kjo nuk aspak kuptim. Duke hapur fjalorin u përbalja me madhështinë e kësaj fjale. Në italisht kjo fjalë ka më tepër se dhjetë sinonime. Disa nga këto janë: i distancuar, i qëndrueshëm, indiferent, i pandjeshëm, i shurdhër, i palëkundshëm dhe deri tek më modernia e shprehjeve, aliene...



E megjithëse gjeta të gjitha këto sinonime të fuqishme, sërish nuk isha i bindur, sepse Ungaretti e mbyll strofën me frazën "kaq përgjithësisht-i ç'shpirtëruar". Domethënë që as guri dhe as njeriu nuk kanë shpirt, meqë edhe njeriu ashtu si guri është një krijesë. Gjurmën e gjeta tek një poezi e Giosue Carducci-t me titull Sprinacë Poetëve dhe është një poezi satirike, e cila ve në lojë poetucët patriotik, e cila pati mjaft kritika për frymën e sajë franceziste. Në të është pikërisht fjala refraktare që inkriminohet më tepër. "Dhe refraktarët- do të jenë të detyruar të krijojnë hënorë." Pas gjetjes e gjithë panorama mori kuptim. Dhimbja e poetit në llogoret e luftës është e shpëputur nga retorikat patriotike. Ajo që ka para syve është një gur, refraktar ndaj ndodhive të marra njerëzore, i njëjtë me njeriun, refraktar ndaj ndodhive misterioze universale. Vajtimi i tij, që nuk shikohet, është indiferent ndaj të gjitha bindjeve; poeti reflekton mbi të vërtetat e padukshme për vështrimet, dëgjimet dhe ndijimet e njerëzorëve. Realiteti ka të bëjë me jetën dhe me vdekjen. Ose: ka të bëjë me vdekjen, e cila nuk vjen njëherësh, por dalë e ngadalë përgjatë jetës. Të gjitha krijesat, edhe të ngurtësuarat, madje edhe fosilet që ruajnë akoma formën e tyre fillestare, në thelb nuk kanë vdekur, por po jetojnë një lloj vdekje të përditshme. Ose një jetë të vdekur. Ja se si del tabloja e përgjithshme pa kaluar në asnjë gjurmë të veçantë, ose thuajse. Një lloj Epikureizi që kundërshton e Epikurin. Jam edhe unë, edhe vdekja. Jemi të dy ngërthyer në një vallëzim marramendës. Të ç'shpirtëruar të shpirtëshëm.



SONO UNA CREATURA

Come questa pietra
del S. Michele
così fredda
così dura
così prosciugata
così refrattaria
così totalmente
disanimata

Come questa pietra
è il mio pianto
che non si vede

la morte
si sconta
vivendo

JAM NJË KRIJESË

Si ky gur
i S. Mikeles
kaq i ftohtë
kaq i fortë
kaq i tharë
kaq refraktar
kaq përgjithësisht
i ç'shpirtëruar

Si ky gur
është vaji im
që nuk shihet

Vdekja
shpaguhet
duke jetuar

LETËRSIA RRRIT POPULLSINË E BOTËS



1. Shkrimtari duhet të jetë i kujdesshëm që të mos e detyrojë personazhin të bëjë diçka, e cila do të shkonte kundër logjikës së personalitetit të personazhit, por edhe personazhi nuk duhet të jetë i pavarur. Personazhi është në grackën e dorës së shkrimtarit, në dorën time, por veçse në një mënyrë të tillë, që nuk e kupton se është në grackë. Karakteret janë të lidhura me shumë fije, por vetë fijet janë të lira; personazhet gëzojnë iluzionin e lirisë, të pavarësisë e ndërkaq, prapëseprapë, ata s'mund të shkojnë diku, ku s'dua unë të shkojnë. Kur kjo ndodh, shkrimtari duhet të tërheqë fijet dhe t'u thotë: "Dale, këtu hyj unë në fuqi."

2. Një ngjarje s'mund të ekzistojë e shpëputur nga personazhet, që shfaqen aty. Përkundrazi, personazhet janë atje për t'i shërbyer strukturës, që shkrimtari do të krijojë. Kur fus në ngjarje një personazh, e di se ai më nevojitet dhe e di ç'kërkoj prej tij, por prapë personazhi është i papërfunduar, ai është në zhvillim e sipër. Unë jam ai që e zhvilloj atë, por në sensin që personazhi vetëndërtohet, unë vetëm sa e shoqëroj. Kjo do të thotë që unë s'mund ta formoj personazhin kundër vullnetit të tij. Ose do ta respektoj personazhin, ose ai do të bëjë gjëra për të cilat s'ia thotë fare. Për shembull, unë s'mund ta detyroj të kryejë një krim, kur kjo s'është në logjikën e karakterit të tij; pa atë motivimin, që e përligj këtë akt përpara lexuesit, kjo s'do të kishte kuptim. Do t'ju

jap një shembull. "Baltazari dhe Blimunda" është një histori dashurie. Në fakt, nëse më lejohet ta them, është një histori e bukur dashurie. Mirëpo vetëm në fund të librit e kuptova se, në të vërtetë, kisha shkruar një libër dashurie pa fjalë të kësaj natyre. Sepse as Baltazari, as Blimunda nuk i shqiptojnë njëri-tjetrit asnjë nga ato fjalë, që të mund të quheshin fjalë dashurie. Lexuesi mund të thotë se kjo ka qenë me paramendim nga ana ime, por jo. Unë u befasova i pari. I thashë vetes: "E si ka mundësi? Kam shkruar një histori dashurie, por pa një fjalë dashurie në dialog." Sikur të përfytyrojmë që dikur, në një ribotim të ardhshëm, për faktin se ashtu do të më shkreppte, unë do ta ndryshoja dialogun midis dy dashnorëve dhe aty-këtu do të shtoja ndonjë fjalë, kjo do t'i shtrembëronte kokë e këmbë ato personazhe. Mendoj se lexuesi, edhe pa e njohur librin ashtu siç ka qenë, do të vërente se aty ka diçka që nuk shkon. Si mundet që këto personazhe, të cilët shoqërohen bashkë qysh në faqen e parë, papritmas thonë të dua në faqen dyqind e pesëdhjetë?!

3. Kjo pra është ajo që unë nënkuptoj me respektin ndaj integritetit të personazhit, jo ta detyroj atë të ndërmarrë veprime që dalin jashtë karakterit të tij, psikologjisë së tij, thelbit që ai është, mbasi personazhi i një romani është një njeri më tepër. Natasha te "Lufta e paqja" është një njeri më tepër; Zhylieni te "E kuqja dhe e zeza" është një njeri më tepër; Raskolnikovi te "Krim e ndëshkim" është një njeri më tepër. Prandaj letërsia e rrit popullsinë e botës. Ne nuk mendojmë për këto tre personazhe si qenie që nuk ekzistojnë, thjesht si seri fjalësh në vandak letrash që i quajmë libra. Ne i mendojmë ata si njerëz të vërtetë. Besoj se kjo është ëndrra e gjithë romancierëve: një nga personazhet e tyre të bëhet "dikush". Ndoshta jam duke kryer mëkatën e krenarisë, por të them të vërtetën, e ndiej se të gjitha personazhet e mia, që nga piktori H. te "Manuali i pikturës dhe kaligrafisë", e deri te senior Hose te "Të gjithë emrat", janë vërtet "dikush". Mendoj se kjo i detyrohet faktit që asnjë nga personazhet e mia nuk është thjesht një kopje ose imitim i një personazhi të vërtetë. Secili prej tyre i bashkëngjitet vetë kësaj bote, për të jetuar aty. Si qenie, ndonëse të fantazisë, vetëm trupi u mungon. Kështu i shoh unë, megjithëse dihet nga të gjithë se shkrimtarët akuzohen si të njëanshëm.

4. Ashtu siç ka ndodhur me të gjitha romanet e mia, edhe "Verbëria" lindi nga një ide që u shfaq papritur në mendjen time. (Nuk jam i sigurt se kjo është formula më e saktë, por s'mund të gjej diçka më të mirë). Isha në një restorant duke pritur të më shërbenin drekën, kur pa ndonjë paralajmërim, befas mendova: Po sikur të ishim të gjithë të verbër? Dhe si përgjigje, prapë mendova: Po ne vërtet jemi të verbër. Ky ishte embrioni i romanit. Më pas m'u desh vetëm të përfytyroja rrethanat e nisjes dhe të lejoja që të lindnin idetë pasuese. Si ide janë të frikshme, por kanë një logjikë të çeliktë. Në romanin "Verbëria" nuk ka shumë fantazi, ka thjesht një zbatim marrëdhëniesh shkak-pasojë. Për mua, e rëndësishme është që të bëj punën time, dhe ta bëj në përputhje me kërkesat e mia për punë të mirë, që libri të jetë shkruar ashtu siç do të doja unë të shkruhej. Pasi e përfundoj, është si çdo gjë tjetër në jetë. Nëna i jep jetë fëmijës, i dëshiron të gjitha të mirat atij, por veçse ajo jetë i takon fëmijës, jo nënës. Fëmija do të bëjë një jetë, ose të tjerët do ta bëjnë jetën e tij, diçka që ka shumë mundësi të mos përputhet me jetën që nëna e tij kishte ëndërruar. S'ka kuptim të ëndërron një priti të shkëlqyer për librat e mi nga shumica e lexuesve, sepse lexuesit do t'i presin ata sipas qejfit të tyre. Nuk do të pohoj se librat e mi nxitojnë të kënaqin të gjithë lexuesit, se kjo do të thoshte se vlera e një libri varet nga numri i lexuesve. Kurse kjo, siç e dimë, nuk është e vërtetë.

Fernando Pessoa

"NUK ËSHTË SALL URREJTJA E HUAJ OSE ZILIA"

Nuk është sall urrejtja e huaj ose zilia
Ajo që na pengon dhe shtyp; kush na do
Njashtu na pengon me dashuri.
Le t'më lejojnë zotat që, i zhveshur nga
Ndjenjat, të arrij lirinë e ftohtë
Të majave më të larta.
Kush kërkon pak, të gjitha i ka; kush s'do gjë
Është i lirë; kush s'ka gjë, dhe nuk kërkon gjë,
Është njeri i barabartë me zotat.

XXVII. "SALL NATYRA ËSHTË HYJNORE, DHE AJO VETË NUK ËSHTË HYJNORE"

Sall natyra është hyjnore, dhe ajo vetë nuk është hyjnore..

Nëse flas për të si për ndonjë qenie
Është për shkak se për të folur mbi të më duhet të përdor gjuhën e njerëzve
Që pajis gjërat me personalitet,
Dhe detyrueshëm gjërave u ngjet emra.
Por gjërat s'kanë as emra e as personalitet -
Ato ekzistojnë, edhe qielli është i pafund dhe toka është e gjerë,
E zemra jonë ka madhësinë e grushtit të shtërnguar..

Qofsha i bekuar për të gjitha ato që nuk i di.
Kënaqem me të gjitha si dikush që e di se gjithmonë ka diell.

XXX. "NËSE MË MARRIN PËR MISTIK, S'PRISH PUNË. JAM MISTIK"

Nëse më marrin për mistik, s'prish punë. Jam mistik.
Jam mistik, ama sall me trup.
Shpirtin e kam të thjeshtë dhe s'e çan kokën fare.


Misticizmi im nuk dëshiron të dijë gjë.
Ta jetojë jetën pa e vlarë mendjen rreth saj.

Nuk e di se ç'është Natyra: unë i këndoj asaj.
Jetoj në majë të një kodre
Në një kasollë të gëlqerosur dhe të vetnuar.
Ja pra ky është definicioni im.

Përktheu: Fadil Bajraj

KRIZAT, PRAGU KU MUND TË RIHAPET E ARDHMJA

Ekonomistët nuk mjaftojnë për arritjen e një qëllimi të tillë, e akoma dhe më pak politikanët. Shpesh gjërat i shohin më nga afër letrarët, filozofët, historianët, teologët, mjekët



Gersa RRUDHA

Fjala krizë është nga fjalët më tentakulare që ekziston nëpër fjalorë: më shumë se një fjalë, ajo është një pemë me degë që nuk rreshtin kurrë së u zgjatur. Në greqishten antike ajo nënkupton shumë gjëra, mes të cilave: ndarje, zgjedhje, gjykim. Folja krino do të thotë edhe vendos. Në mjekësi, në termat e saj, flitet për ditë kritike ose ditë të tëra kritike; për Hipokratit (dhe për Galienin, në shekullin II p.K.) ajo është momenti kur sëmundja vendos: ose precipiton në vdekje ose përballlet me rimëkëmbjen. Është pika e kalimit, e kthesës. Termi që prej antikitetit u shfaq në trazirat e mëdha të viteve 700, në revolucionin borgjez, në atë industrial. Kriza e vërtetë, sipas Burchhardit, nuk ndryshon vetëm regjimet, trondit edhe themelet e shoqërisë. Ajo që e karakterizon më së miri është përshpejtimi i jashtëzakonshëm i kohës: "Procesi botëror bie papritmas pre e një shpejtësie të tmerrshme zhvillimesh; zhvillime që zakonisht duan shekuj të ndodhin, kalojnë me vite e muaj si fantazma në arrati" (Jacob Burchhardt, "Konsiderata mbi historinë universale").

"Magjia e këputur"

Ndoshta jemi vërtet në këtë gjendje, ndoshta jo. Edhe pas konfliktit të Luftës së Parë Botërore koncepti i krizës u evokua me një ankth gjithnjë e më në rritje. Historiani i njohur Rajnhard Koselek, e quan "katarakt i

ngjarjeve" dhe nënvizon karakterin e saj të dyfishtë: është një dënim, por dhe një rast për t'u transformuar. Në versionin grek, të vihesh përballë gjykimin, do të thotë fjalë për fjalë të "hysh në krisis", në proces. Në po të njëjtën kohë, krizë do të thotë vënia e intelektit në veprim, diçka që i ridimensionon gjërat: Njeriu që nuk ka kurrfarë "krisis" të këtij kuptimi nuk është i zoti të gjykojë asgjë, shkruan Johan Hejnrih Zedler, në "Fjalorin e vet Universal" të vitit 1737.

Edhe kriza botërore që po kalojmë sot është një krizë e vërtetë: momenti i një vendimi, kulmi i një të keqeje, po nëse kemi ndërgjegjen e kuptimeve të mësipërme, edhe rast shëndoshje. Po kështu, është e mundur edhe rrugëdalja, mjaft që të mos mungojë diagnoza: sipas Galienit, ditët kritike arrijnë të vlerësohen vetëm nëse fillesa e të keqes arrin të përcaktohet me përpikëri. Ekonomistët nuk mjaftojnë për arritjen e një qëllimi të tillë, e akoma dhe më pak politikanët. Shpesh gjërat i shohin më nga afër letrarët, filozofët, historianët, teologët, mjekët. Nëse shoqëria është një trup - një pohim ky i cili që në zanafillë ka shërbyer si një tezë e filozofëve - këto janë ditët e saj kritike: mund të mbarojë ose të shërohet, duke këmbyer formë dhe mënyrë të ekzistuarit.

Mirëpo, kudo në përballje me krizën, politikanët dhe ekonomistët, picërojnë sytë përpara "magjisë së këputur". Do të donin ndoshta që penjtë me të cilën është endur kjo magji - iluzionet- të mos këputeshin

pikërisht tani. Aq më tepër që fushatat elektorale, dihet tashmë, janë të qepura me penj të tillë, rrojnë me kimerën e premtimeve për progres social e sukses ekonomik, me çdo kusht. E rëndësishme në një gjendje hipnoze është të rrokësh sa më shumë, edhe pse mjetet mungojnë e hipnoza, duke e shtrënguar ndërgjegjen, është e kundërta e krizës. Ndjaj më mirë një krizë e shpallur se sa promovim i një hipnoze, me premtime boshë. Nuk na lipsen iluzione që pastaj mund të na çojnë në zhgënjime përvëluese; pra, nuk duam të na shiten premtime që nuk mund të mbahen e të kthehen në "fluska". Vetëm se e keqja është që "fluskat" ekzistojnë kudo, në financë, në politikë, në kokat e njerëzve. Janë ditët kritike të mendjes sonë: ja, kjo le të jetë më mirë ndërgjegjja e premtimeve të çdo prag-fushate elektorale; u takon pikërisht politikanëve ta thithin të parët këtë mendim. Nëse nuk e bëjnë, kanë për të dëgjuar rreth vetes veçse zhaurimën klithëse të "zogjve" të Hitçkokut, pa gjetur dot as mjetet e as fjalët e një veprimi a fushate që ngjall autoritet.

E për t'u ç'dehur nga gjithë ajo ethshmëri fluskash plot iluzione e premtime, nevojiten ilaçe të fortë. Nevojitet një refleksion i thellë mbi limitet që ka monolitizmi mendor, nevojitet rizbulimi i vlerave që ka mendimi ndryshe, për të "varrosur" në fund edhe kryeneçësinë e antagonizmit autarkik midis forcave tona politike. Janë të shumtë mendimtarët që arrijnë të na ndihmojnë në këtë

drejtim, e midis tyre, më i madhi, sapo është larguar nga jeta, pasi kishte mbushur plot 100 vjeç: Klod Levi Shtraus. Shkrimet e tij të famshme ("Raca dhe Historia" 1952, "Raca dhe Kultura" 1971) janë të çmueshme për këdo që kërkon të kuptojë tranzicionin aktual e të fitojë artin e të menduarit në perspektivë.

Metafora e Anjshtajnit

Së pari, ato hedhin poshtë cinizmin e atyre që thonë që "nuk ka alternativë", se gjithçka në klasën tonë politike është e kalbur, e si në një anë ashtu dhe në anën tjetër, mbi-zotëron fajësia. E për më tepër kjo s'duhet të trajtohet kurrësi në nivelin e kulturës apo të vetë shoqërisë sonë të pasqyruar te politika. "Progresi, -thotë Levi-Shtraus, nuk është diçka e vazhdueshme, e domosdoshme. Përparon me hope, mutacione, shmangie, siç lëviz guri i kalit në lojën e shahut. Por mbi të gjitha, nuk është strehë e të privilegjuarve: nuk ekzistojnë kultura foshnjake, primitive, të cilave u kundërvihen qytetërimet e sofistikuar. Të gjithë popujt janë madhorë, edhe ata që nuk e kanë mbajtur diturin e fëmijërisë apo të adoleshencës së tyre". ("Raca dhe historia").

E pas nënvizimit të kësaj premise të domosdoshme, nuk mund të mohojmë veset e kulturës sonë politike me patologjinë e saj kronike. Ekzistenca e një klime të ashtuquajtur antagoniste në dukje që bashkë-jeton me një prirje ponderuese ndaj

konformizmit, shkëmbime të banalizuara favoresh përbri një korrupsioni "të pandërgjegjshëm" të së majtës dhe së djathtës, përflakje termash "luftarake" ndanë një "bashkëpunimi" të errët e gati të nëndheshëm, gjithnjë të mohuar, por gjithnjë të pranishëm. Cila vallë është origjina e gjithë kësaj?

Ekziston një metaforë me të cilën Anjshtajni shpjegoi teorinë e vet të relativitetit, e që Levi-Shtraus përshtat shpesh, por duke e përkëmbur në mënyrë të mrekullueshme. Është metafora e trenit në ecje. Për të demonstruar që lëvizja e trupave në kohë dhe hapësirë nuk është një e vërtetë absolute, por varet nga optika e vëzhguesit, Anjshtajni tregon sesi një udhëtar i sheh gjërat si të papëruptshme me njëra-tjetrën, sipas rastit, nëse treni paralel i kundruar nga dritarja shkon në të njëjtin drejtim me të apo në drejtim të kundërt. Nëse lëviz në të njëjtin drejtim, ai na duket si i palëvizshëm, shumë më i gjatë se treni që shkon në drejtim të kundërt: pasi vetëm ky i fundit duket të lëvizë. Krejt ndryshe ndodh në vëzhgimin e shoqërisë dhe në ndarjen midis kulturave që lëvizin dhe kulturave inerte. Vetëm ato kultura që lëvizin në po atë drejtim që lëviz edhe kultura jonë (duke na qenë më të dukshme, duke bashkëndarë zakone dhe vlera) na duket se lëvizin. Kulturat që prirën në kah të kundërt, mezi sa i shohim e i kuptojmë. "Treni kalon me aq shumë shpejtësi sa ne arrijmë të ruajmë vetëm një mbresë të përshtjelluar të tij, së cilës i mungojnë madje dhe cilësorët e shpejtësisë. Na duket njëllor sikur treni është i palëvizur, shpjegon Levi-Shtraus. Nuk është më tren, nuk është asgjë". ("Raca dhe kultura").

Udhëtarit nga dritarja sheh vetëm një segment të botës: "ne i dukemi njëri-tjetrit si të mangët nga interesi, për motivin e thjeshtë se nuk ngajmë me njëri-tjetrin". Në këtë pikë Levi-Shtraus evokon dy figura të kësaj kategorie - të moshuarin dhe kundërshtarit politik - barazisht të paaftë për të parë tjetrin. Që të dy shpesh s'janë aspak kuriozë, më pak të pasur në kohë, në hapësirë, në ide. Është pikërisht kjo gjendja karakterizuese e kulturës së dy forcave kryesore politike në Shqipëri: një stancion i gjallë mbizotëron në hapësirë, në kohë, në ide; kultura e së majtës dhe e së djathtë shqiptare gjatë gjithë këtyre viteve, në thelb është inerte, nuk lëviz. Sot ato duken si rrugë-humbura në identitetet e tyre reale, pasi të paravijëzueshme janë edhe dallimet midis atyre dy pozicioneve që shënjuan zgjidhjet e mëdha politike të botës moderne: barazi apo hierarki, autonomi apo heteronomi, racionalitet apo irracionalitet, vlerësimi i njeriut horizontal apo atij vertikal. Janë të gjitha kategori të paceshura as edhe një grimë, pasi forcat radikale brenda secilit pozicion, as arrijnë t'i mendojnë këto alternativa, kurse partitë institucionale duket të mos e rrokin rastin e ndryshimit të kulturës së tyre, rastin e zbatimit të një kulture në lëvizje, jo inerte. Humbasin kështu edhe kategoritë tipike përkatëse të çdo force politike, për kohën dhe hapësirën.

Hapësira e parlamentit (një fitore e botës perëndimore që në vitet '800)

tashmë duket si e "boshatisur", pasi eksperiencia aty është kthyer në një instrument të paracaktuar veç për një qëllim: *primum vivere*, çdo deputeti i duhet vetëm të ngrejë kartonin në mënyrë mekanike. Po kështu është dekompozuar edhe hapësira brenda partive: ata janë tërhequr nga shoqëria, e kjo ka sjellë edhe tërheqjen dhe distancimin e shoqërisë ndaj tyre, çka shprehet në fenomenet e antipolitikës dhe abstensionizmit. Po kështu, koha lineare dhe progresive e koncepteve të tyre udhëheqëse ka rezultuar të jetë shumë e shpejtë, e ndrydhur, e investuar në cakun e një periudhe, një viti a një legjislature, duke u bërë kështu e padisponueshme për një politikë afatgjatë. Pra, për diçka të tillë, nuk ka kohë! Kësisoj, mungojnë subjektet, zgjidhjet: mbizotëron aspekti i veçantë përpara projektit, dekorit përpara përmbajtjes, imazhi përpara vlerës. i gjallë mbizotëron në hapësirë, në kohë, në ide; kultura e së majtës dhe e së djathtë shqiptare gjatë gjithë këtyre viteve, në thelb është inerte, nuk lëviz. Sot ato duken si rrugë-humbura në identitetet e tyre reale, pasi të paravijëzueshme janë edhe dallimet midis atyre dy pozicioneve që shënjuan zgjidhjet e mëdha politike të botës moderne: barazi apo hierarki, autonomi apo heteronomi, racionalitet apo irracionalitet, vlerësimi i njeriut horizontal apo atij vertikal. Janë të gjitha kategori të paceshura as edhe një grimë, pasi forcat radikale brenda secilit pozicion, as arrijnë t'i mendojnë këto alternativa, kurse partitë institucionale duket të mos e rrokin rastin e ndryshimit të kulturës së tyre, rastin e zbatimit të një kulture në lëvizje, jo inerte. Humbasin kështu edhe kategoritë tipike përkatëse të çdo force politike, për kohën dhe hapësirën. Hapësira e parlamentit (një fitore e botës perëndimore që në vitet '800) tashmë duket si e "boshatisur", pasi eksperiencia aty është kthyer në një instrument të paracaktuar veç për një qëllim: *primum vivere*, çdo deputeti i duhet vetëm të ngrejë kartonin në mënyrë mekanike. Po kështu është dekompozuar edhe hapësira brenda partive: ata janë tërhequr nga shoqëria, e kjo ka sjellë edhe tërheqjen dhe distancimin e shoqërisë ndaj tyre, çka shprehet në fenomenet e antipolitikës dhe abstensionizmit. Po kështu, koha lineare dhe progresive e koncepteve të tyre udhëheqëse ka rezultuar të jetë shumë e shpejtë, e ndrydhur, e investuar në cakun e një periudhe, një viti a një legjislature, duke u bërë kështu e padisponueshme për një politikë afatgjatë. Pra, për diçka të tillë, nuk ka kohë! Kësisoj, mungojnë subjektet, zgjidhjet: mbizotëron aspekti i veçantë përpara projektit, dekorit përpara përmbajtjes, imazhi përpara vlerës.

Kulturë në lëvizje

Në një moment kur është pikërisht ideja se që të kesh të "korra të bollshme" nevojiten "mbjellje" në perspektivë e projekte ambicioze me investime jo të menjëhershme në kohë, një ide kjo aspak e një ëndërrimtarit, por për vite të tërë shtytësja vendimtare e progresit perëndimor. Ja, pse na duhet ta hapim të ardhmen

e ta sfidojmë atë me shpirtin e pionierëve. Është pikërisht ky shpirt ai që i përgjigjet një kulture në lëvizje, për t'u ngritur kundra konformizmit në thelb, të jetës sonë politike, që e mban kulturën e saj inerte. Studimi, formimi, dëgjimi dhe shkëmbimi i informacioneve në të gjitha nivelet është njëri nga mekanizmat shëndoshës të kësaj gjendjeje, pasi është i kundërti i konformizmit që veçse ngërthen mendimin e kulturës në lëvizje. "Ky konformizëm, as edhe nën emrin e një klime të paqte dhe jo antagoniste politike, nuk është ai progresi që kërkojmë, pasi një transformim i tillë është humaniteti i ngurtësuar, është antropi, energji që humbet", siç e përcakton Levi-Shtraus. Përkundrazi, sipas tij, "çdo progres është një koalicion midis forcave të ndryshme që kërkojnë një sintezë, pa braktisur diversitetin e tyre".

Vërtetë, çdo koalicion me diversitetin ka edhe përfundimet e tij paradoksale. E sfida e madhe qëndron në gjetjen e një ekuilibri midis integritetit dhe diferencës, dhe në evitimin e asaj simptome të mbizotëruar deri më sot të një "pushimi komod, përtacor të zhvillimeve thelbësisht reformuese" që siguron "imazhin e një ngjashmërie të përmirësuar" qeverisje pas qeverisje (qoftë kjo e majtë apo e djathtë); mirëpo historia nuk është bërë prej ngjashmërive që përmirësohen, por prej kthesave të forta, ndryshimeve, hopeve. Ja, pse lipsen aq shumë "madhështi të papërbalueshme të rifillimeve", që përmend autori në veprën "Tropikët e trishtë", për të rihapur të ardhmen tonë. Nëse pandryshueshmëria është vërtet një mur, edhe ai ka të çarat e veta, kësisoj gjërat nuk janë asnjëherë të pandryshueshme; ka gjithmonë një kohë dhe një fjalë për ta karakterizuar këtë kohë, ashtu si dhe një veprim për ta ndikuar atë. E kjo është lindja e një komunikimi të ri politik, që të mos kanalizohet në lojën e njeriut kundra tjetrit, por të mendojë për interesat e përbashkëta, superiore, perspektive. Aq më tepër që edhe nga pikëpamja filozofiko-sociologjike ky është momenti i rigjetur. Siç thoshte Vitgenshtajni "është filozofia ajo që mund të na çlirojë nga idhujt". E politika shqiptare në këtë aspekt ka shumë nevojë për filozofinë.

Kjo për faktin se filozofia ndihmon në ç'dogmatizimin e sigurive tona politike. Le të marrim një shembull nga filozofët e viteve '900. Derrida ishte njëri nga ata që nuk do të ish bethuar kurrë mbi sigurinë absolute të institucioneve tona. Asnjëri nga mendimtarët e mëdhenj të modernitetit ishte i sigurt për bindjet tona politike. Ndërkohë që në raport me politikën perëndimore, sot filozofia luan një rol të madh për të na mësuar edhe një herë të fitojmë mbi idhujt. Mesazhi më i mirë është ai që na jep hermeneutika, d.m.th. dialogu, konsensusi informativ, universaliteti si fakt që ndërtohet mbi mirëkuptimin më shumë sesa mbi iluminizmin. E duhet theksuar se kemi të bëjmë me një kthesë të madhe edhe në fushën e filozofisë, çka shpjegon edhe aktualitetin e dialogut si instrument jete. Pas një faze të një unilateralizmi të përgjithësuar në të gjitha nivelet, u kuptua se asgjë nuk mund

të bëhet vetëm. Le të nisë pra dialogu, në fillim qoftë dhe për arsye utilitare.

Të jetosh në boshllëk

Mjaft që të mos ngelemi në stancionin e kulturës inerte. Pastaj iluminizmi, filozofia, përgjegjshmëria do të arrijnë të mburjnë dalëngadalë edhe maturinë e këtij dialogu. Tani për tani, është e rëndësishme që palët të mos i fryjnë antagonizmit me çdo kusht, sepse kështu e kërkon një fushatë e mirë elektorale. Përkundrazi, lipset një dialog i vërtetë për të bashkëpunuar në gjetjen e zgjidhjeve që diktojnë emergjencat, në mënyrë që edhe në fushatë elektorale çdo forcë politike të sforcohet të jetë më e mirë, të matet me një nivel më të lartë të përballjes politike. Nuk ka rëndësi fare të jesh i majtë apo i djathtë, ka qëndësi ajo që i shërben vendit, e kjo duhet të jetë një shtysë për të ngritur sidomos në raste fushatash nivelin e ndërgjegjes kolektive. Më tej, ndihet vërtetë nevoja e një dialogu, por kjo nuk nënkupton që dialogu të jetë i mangët nga momentet e kritikizmit. Raporti i dy palëve që kanë pikëpamje të ndryshme mund të jetë i kreshpëruar prej vështirësive, por gjithsesi, dihet se në një mjedis dialogues nuk ekziston një arsye e vërtetë, e dhënë dhe e parafabrikuar. Përkundrazi, brenda tij e vërteta ndërtohet së bashku, duke kaluar edhe nëpërmjet përplasjeve. Mirëpo, pikërisht këtu shfaqen problemet e rënda të qasjeve dhe sjelljeve të palëve në të gjitha nivelet: brenda dhe midis partive, qoftë të një krahu qoftë të kraheve të ndryshëm: zënka personale, individualizmi e ambicionet, narcizizmi, hedonizmi e së fundi, edhe kultura e unitetit si bllok heratik. Këtij të fundit mund t'i shtohen strategjitë e diktura që bien në kontradiktë, kur ndjekin qëllime të drejta me mjete të padrejta, ose koherenca që arrihen me diktime dhe shtrëngesa strukturore brenda-partiake. Duket pra që kemi të bëjmë me një krizë të politikës, jo vetëm të dallimit e majtë-e djathtë. E në realitetin shoqëror, është boshllëku rreth saj ai që e kërcënon. Veçse ky boshllëk, në momente të tilla vendimtare të një krize gjithë-përfshirëse botërore, mund të çelë papritmas mjaft porta, mjaft rifillime të "papërbalueshme" për t'u frenuar. Të jetosh në boshllëk është shumë më mirë sesa të ndihesh në kurthin e ideologjive të parafabrikuar. Të jetosh në boshllëk - ose e thënë ndryshe nën trysinë e zhgënjimit dhe dëshpërimit të shoqërisë - çel mundësinë e "lindjes së një gjuhe të re", gjuhën e një shoqërie të hapur që parakushtëzohet në çdo individ bashkë-ekzistencën e identiteteve të shumëfishtë: civilë, estetike, etike, e kështu me radhë. Të ndjesh këtë boshllëk, për të nxjerrë prej tij një gjuhë të re, ku sinteza e identiteteve nuk nënkupton braktisjen e secilit prej tyre, është pikërisht ai hopi që dallon një politikan largpamës nga një politikan i mirë; Është fillësia e dialogut, atij të vërtetë, që paracaktuar më sipër, është ai pragu i rifillimeve ku asgjëja nuk ekziston më e ku, sapo ka nisur qenia, fjala që duhet thënë, veprimi që duhet bërë. Është pragu ku mund të rihapet e ardhmja.

ARTISTI, RREZATUES I SË MIRËS, APO...

Duke lundruar në detet euforike dhe, duke dëgjuar vetëm zërat e egos së tyre të sëmurë, të tillë krijues mbesin gjithmonë në sfond dhe nuk rriten kurrë



Agim BAJRAMI

Më tregonte para pak ditësh një miku im, krijues i njohur: Desha t'i kujtoja miqësisht një të ashtuquajturë poete (autore e 12 librave poetike), që ngatërronte në një nga poezitë e saj Lumin Drin me Lumin Drinos se kishim të bënim me dy lumenj të ndryshëm, por vërejtja ime duket se e egërsoi dhe nervozoi keq atë. Isha me fat që nuk e kisha përballë, sepse mund edhe të isha konfrontuar me të.

Nisur nga rasti në fjalë dhe nga disa reagime nervoze të disa homonimeve të tjerë të kësaj pseudo-poeteshe, në rrjetet sociale ndaj figurave aktuale të letrave tona, lind pyetja: Përse gjithë ky fjalor i ashpër dhe kjo mungesë tolerance nga ata që pretendojnë se e dashurojnë fjalën e bukur poetike dhe bartin mbi vete një emër krijuesi? Mund të ketë shumë përgjigje kjo pyetje, por gjëja e parë që më vjen në mendje është se fushës së letrave i janë vetafruar një kontigjent i tërë njerëzish, që nuk kanë asnjë lidhje apo afekcion me fjalën e bukur dhe letrat, por që ju është mbushur top mendja, se shkrimi i librave është një mundësi për t'i bërë ata të famshëm. Është e qartë se këta njerëz nuk kanë nevojë për vërejtje dhe sugjerime letrare, por vetëm për dekorata dhe duartrokitje. Kësisoj, vërejtja ime miqësore kishte rënë në adresën dhe veshin e gabuar. Zakonisht, mes njerëzve të letrave këmbimi i mendimeve dhe përvojave është një praktikë e zakonshme dhe domosdoshmëri e pranuar nga të gjithë. Për më tepër që një krijues me vlerë duhet të jetë edhe modeli, që duhet ndjekur nga të tjerët, pasi teknika e të shkruarit është dhe mbetet një zeje shumë e vështirë dhe delikate. Historia e letërsisë njihë kaq e kaq shembuj të tillë. Por, të pretendosh se ke arritur majat, menjëherë pasi ke botuar librin e parë apo të dytë, se nuk ke nevojë për të studiuar dhe për të pritur vërejtje, është antiletërare. Duke lundruar në detet euforike dhe, duke dëgjuar vetëm zërat e egos së tyre të sëmurë, të tillë krijues mbesin gjithmonë në sfond dhe nuk rriten kurrë. Frederik Reshpja ishte një nga ata që për dekada e dekada ju përkushtua studimit të thellë të mjeshhtërisë poetike. Komunikonte me të gjithë dhe ishte aq njerëzor. Ata që e kanë njohur nga pranë, thonë se karakterizohej nga një thjeshtësi e jashtëzakonshme dhe kurrë s'pranonte të mburrej me zë koke, se ishte një poet i madh. Nga tipare të tillë karakterizohej edhe romancier i njohur shkoderan, Skënder Drini, Zija Çela të bie menjëherë në sy për komunikimin me krijues të rinj. Po kështu, edhe poetët e mrekullueshëm Xhevahir Spahiu, Musa Vyshka, Skënder Buçpapaj, Petrit Ruka etj. Mjaftojnë vetëm këta emra, për të krijuar një ide sado të vogël, se thjeshtësia dhe

madhështia e krijimit ecin gjithmonë paralel me njeri tjetrin/ Ngritja e zërit vend e pa vend, megalomania, narcizmi dhe prirja për të qenë protagonist edhe aty ku nuk ju takon, janë karakteristika të njerëzve të vegjël dhe pa vlerë që inferioritetin e tyre krijues mundohen ta kompensojnë me veprime dhe gjeste ordinere. Sjellje dhe prani të tilla padyshim që i shëmtojnë ambientet dhe atmosferën tonë letrare, duke bërë që kolegët e tyre të ndihen keq dhe të frustruar. Edhe pse absurditeti i kësaj kohe i ka ndihmuar me sa të mund ta hapin tinëzisht derën e rëndë të letërsisë, prania e tyre për një kohë të gjatë brenda saj është e përkohshme. Kur poeti i madh italian, Eugenio Montale, shkroi vargun e famshëm se "Poetët kanë lindur për të ndryshuar botën", sigurisht që nuk e kishte fjalën për ta. Nga përvoja e marrëdhënieve të mia me njerëz të tillë, kam mësuar se shumica e tyre, karakterizohen nga shenja të dukshme deliri dhe mungesë e theksuar kulture, çka ua bën të vështirë komunikimin normal me të tjerët, njihjen dhe respektimin e hierarkive dhe vlerave të mirëfillta letrare. Duke mos njohur vështirësitë e krijimit, censurën artistike, mesazhet me përgjigje refuzuese, nga redaksitë e revistave, gazetave dhe shtëpive botuese të dikurshme, atyreju është mbushur mendja top, se të bërit letërsisot qenka njëqind herë më e lehtë se të shkosh në det për të gjuajtur peshk. Unë jam shumë i sigurt se asnjëri prej tyre nuk i di vuajtjet e Xhek Londonit (autorit të Dhëmbit të bardhë, për të botuar librat e tij të parë apo zhgënjimin e Tolstojit, përballë cinizmit të botuesve të tij të kohës, ekzistencializmin e Balzakut, Hygoit dhe Dikensit. Ata s'dinë asgjë për kalvaret e pafundme të vuajtjeve të shkrimtarit antikomunist, Bilal Xhaferri dhe dhjetëra e dhjetëra krijuesve të tjerë përballë inkuizitorëve të tyre letrar, në periudhën e errët diktatoriale. Ndofta është kjo mosdije që nuk i lejon ata të ulin sado pak kokën, të studiojnë më shumë dhe të nxijnë rreshta më pak. Ndërsa shkruaj këto radhë, më vjen në mend shkrimi i para disa ditëve i një redaktoreje të vjetër dhe me kulturë, të Shtëpisë botuese Naim Frashëri, që kishte kaluar nëpër duart e saj qindra vepra të njohura të letërsisë sonë dhe asaj botërore, dhe mbas kaq e kaq dyzimesh vendosi të dalë para lexuesit me një libër. Edhe pse vepra e saj kishte marrë vlerësime nga njerëz të njohur të letrave, ajo përsëri ishte e shqetësuar, sepse një krijuese e vërtetë duhet të ruhet dhe t'i trembet lëvdave dhe euforisë që vjen menjëherë pas tyre. Postulati i njohur se: krijuesi duhet të jetë pasqyrë e thjeshtësisë dhe rrezatues i së mirës, është kaq kuptimplotë dhe kaq kundërshtues njëherësh.

MALLKIMI

Mimoza EREBARA

Nuk pritën as sa të shkonin brenda, por filluan të puthen me zjarr, duke mos parë më asgjë. Burri e tërhoqi brenda dhomës së madhe e gati të zbrazur. Gruaja ishte përhumbur aq shumë nga ky shkrim i papritur e i pazakontë i atij që tashmë do të ishte ashtu siç e kishte dashur gjithnjë të ishte, burri i jetës së saj. Kishin ikur nga dasma e tyre pa pritur të përcillnin njerëzit siç e donte zakoni. Gruaja po klithte nën zë duke u përpjekur të çlirohej nga palat e shumta të fustanit të bardhë e të vellos, pas së cilës u bënë merak të gjithë gratë e fisit. As kërcitjen e tegelit në copën e brishtë nuk e dëgjuan. Burri vazhonte ta puthte me ngulm dhe po me ngulm kërkonte edhe trupin e saj të fshehur mes palave të bardha.

-Je e imja...je e imja...imja...- mërmëriste mbytyrazi burri mes buzëve e frymës së të dyve. Sytë u ishin mbyllur dhe duart e të dyve lëviznin me shpejtësi duke përkëdhelur ç't'u dilte përpara. Më në fund gruaja arriti të çlirohej nga lumi i kopsave e karcave dhe ashtu, eposhore, e njomë, me një lëkurë për të pasur zili ishte shtrirë në shtratin matrimonial, i vetmi trashëgim, i shenjtë gati, i familjes së burrit. Ishte me të vërtetë një shtrat supergjigand, a thua se ata që e kishin përdorur do të kishin qenë njerëz jo të kësaj bote. Ishte kthyer gati në një traditë të cilën deri më atë ditë nuk e kishte shkelur askush nga pjesëtarët e shumë meshkuj të fisit, që për hir të së vërtetës duhet të themi se ishte tepër i madh e i fuqishëm. Me të vërtetë dukej si shtrat mbretërisht, me gjithë ato simbole të gdhendura në atë dru arde të rrallë. Dikur ua dinin edhe kuptimet e atyre simboleve, por tani pasi kishin kaluar shekuj, askush nuk i mbante mend me hollësi e saktë se çfarë tregonin ato. Por po t'i shikoje me vëmendje, aty-këtu të shfaqeshin portrete njerëzish. Po kjo nuk i ndodhte kujtdo. Për shumicën e çifteve që ishin martuar dhe kishin fjetur natën e parë të martesës në këtë shtrat, që i kishin ngjizur fëmijët e tyre po aty, ato ishin thjesht disa motive lulesh e kafshësh amorge, ku

herë dukej një bri, herë një turi, herë ca çaponj. Kurse për ata që arrinin të shihnin të tilla gjëra thuhej se ndillnin fatkeqësi. Në traditën e familjes së tyre, po të ndodhte që fëmija i ngjizur mbi këtë shtrat të ishte mashkull, çifti që e kishte sjellë në jetë lejohej që të flinte në këtë shtrat derisa një çift tjetër t'i zëvendësonte. Po kështu, nga plaku i fisit, i cili me fanatizëm ruante drejtimin dhe organizimin e gjithë pjesëtarëve të familjes, çiftit fatlum i njiheshin edhe disa shpërblime. Për atë fis që rrënjët i kishte tepër larg këtyre brigjeve ku fati i hodhi dhe i mbrojti prej asgjësimit të plotë, vazhdimësia, ishte çështja më e prekshme prej të gjithë anëtarëve të vjetër dhe po kështu edukoheshin edhe të rejtat që hynin nuse në këtë shtëpi të madhe e me emër, jo vetëm në trojet e tyre, por edhe më larg. Të dy, edhe për burrin, edhe për gruan ishte hera e parë që ndodheshin në këtë dhomë e në këtë shtrat. Dhe ata po rrotulloheshin e po rrotulloheshin kaq shumë në krahët e njëri-tjetrit dhe kaq shumë ishin përhumbur në thellësitë e frikshme të ndjenjës, sa për ta në ato minuta u jetua krejt jeta. Koha e humbi nocionin e saj praktik. Hapësira gjithashtu. Po lundronin në ndjenjën e tyre. Burri, një trupmadh me shpatulla për t'u pasur zili nga çdo mashkull, qëndroi një çast të vetëm i drithëruar nga trupi i lëbyrtë që kishte nën vete. Deri më atëherë, ai nuk kishte nxjerrë zë, duke respektuar ritin e familjes, të cilin ia kishin bërë të qartë burrat e tjerë: asnjë fjalë, asnjë klithmë! Burri duhej të ishte i fortë dhe nuk bënte të dorëzohej para trupit të një gruaje.

-O Zot!- klithi ai- Çfarë bukurie që kam!

Sytë e kaltër të gruas u errësuan si qielli nga reja. Ata kishin kaq shumë jetë, ishin kaq të thellë, kaq të mister-të...

-Ç'bën? - pëshpëriti ajo - harrove që s'duhet të flasësh?

Burri nuk dëgjoi, por filloi të pikturonte me fjalë bukurinë që kishte nën vete, atë bukuri që e kishin lakmuar kaq shumë të tjerët, por që tani, sot, ajo do të ishte e tija, krejt e tija dhe e askujt tjetër. Burri ishte i

ngazëllyer, njëloj si gruaja që e dhe ajo po e përjetonte këtë çast po ashtu. Edhe për të ishte gati-gati një mrekulli që e kishte, sepse në kohën në të cilën jetonin, të marthohesh me njeriun që dashuroje ishte një ëndërr, thjesht një ëndërr, njëloj sikur ajo, e mjegullt, e pakapshme. Për të dy ky ishte një fat i pazakontë. Prandaj në ceremoninë e dasmës së tyre u shkul i madh e i vogël për të marrë pjesë. Nuk ngeli vajzë pa ardhur dhe në sytë e ëndërrt të të gjithave lexohej e njëjta dëshirë për të pasur të njëjtin fat sikur edhe shoqja e tyre. Edhe gratë e fisit të burrit e lakmuar një martesë të tillë të rrallë. Apo s'ishin që të dy njëri më i bukur se tjetri! Por të heshtura, ashtu siç e deshte zakoni, askush nuk e mori vesh në u gëzuan me të vërtetë, apo plasën nga zilia, sepse asnjëherë çifti problemet mes vete nuk i përfliste me askënd. Nuk dihej në ishin të lumtura apo jo, por gratë e tjera të fshatit thanë se një shkëlqim sysh nga një lumturi e paparë, në sytë e gruas nuk e kishin parë në asnjë prej nuseve të tjera të fisit.

Por ata të dy në ato çaste me të vërtetë nuk ishin aty.

Burri dhe gruaja heshtën vetëm një çast dhe pastaj nuk përmbaheshin më. Filluan t'i shtojnë klithmat e epshit e pasionit sepse për herë të parë ata të dy po bashkonin trupat e tyre, t'i shtojnë aq shumë sa ato filluan të dëgjohej nëpër të gjithë shtëpinë, duke i mundur madje edhe zhurmata e ahengun e dasmës.

Haka, lënësia e familjes, që deri atëherë kishte qëndruar e ulur në gjuhë dhe po i përgjonte nga vrima e çelësit, kërcu e trembur dhe mezi u mbajt pas mureve të gurta, ashtu dyllë e verdhë, kur pa plakun e shtëpisë në korridor dhe pas tij një shpurë e tërë me burra të fisit e tek-tuk ndonjë grua a ndonjë kokë fëmije. Heshtja e tyre e çmeriti. Priti ndëshkimin. Ishte kapur duke përgjuar. Gratë e fisit e kishin përfolur prej kohësh nën zë një gjë të tillë, sepse shpesh herë u bëhej si hije që shkon e vjen vjedhurazi nëpër shtëpi, dhe shumë herë vetë ato nuk ndjeheshin rehat. Mirëpo burrat e kishin kaluar me indiferentizëm këtë gjë, dhe i kishin akuzuar gratë e tyre se ishin bërë me hije. Vërtet Haka ishte shëndetligë dhe thartuqe, por nuk ishte e keqe, prandaj ato do bënin mirë të ulnin kokën e të merreshin me punët e tyre dhe të mos merreshin me llafe të kota. E kështu Haka kishte shpëtuar paq. Nderi i familjes nuk ishte cenuar. Prandaj tani kur i

pa të gjithë bashkë mendoi se i erdhi fundi. Por plaku s'e pati mendjen tek ajo. Me hapa të ngadaltë u çapit drejt derës, e hapi dhe shtangu.

Burri ishte shtrirë mbi atë që mund të quhej qilim, mbulesat e shtratit ishin hedhur në tokë, jastëkët me qëndisjet qindravjeçare kishin fluturuar në një cep, dhe mbi të kishte hipur gruaja e cila hepohej herë andej e herë këndeje e gjitha në ekstazë, me sy të mbyllur, dhe që po i thoshte burrit të saj:

-Shpirt, bëme ç'të duash...puthmë... gjithandej puthmë...shpirt ...-dhe në të njëjtën kohë zgjatej të puthte e të kafshonte burrin dhe kur s'e arrinte dot kafshonte gjinjët e vet. I ngriti duart e burrit rreth qafës së saj dhe ofshau fort duke mos e lënë atë të lëvizte më. Burri nga ana e tij kullonte në djersë dhe vetëm bërtiste. Flokët e verdhë e të ndritur si ari shkonin sa andej -këtej duke vezëllitur, lëshoheshin mbi fytyrën e tij dhe pastaj papritur gjendeshin në atë kurriz të brishtë, ku dukshëm dukej rrethi i hollë i belit. Ata as që e vunë re derën që ishte hapur dhe njerëzit që kishin mbetur të pagojë nga ajo që po shihnin dhe që i kalonte të gjitha caqet e fantazisë së tyre.


Haka ishte bërë e bardhë, gati e tejdukshme. Kishte përpara syve atë që e kishte dëshiruar gjithë jetën dhe që kurrë nuk e kishte pasur. Kishte përpara një dhomë në të cilën kishte kaq shumë dashuri. Zemërimi filloi ta kaplonte rrafshëm dhe ajo u betua se do të merrte hak për fatin e saj të mbrapshtë, do të merrte hak për dashurinë e munguar. Ajo foli:

-Unë do t'ju mbys në dashurinë tuaj! Mallkuar qofshi!

Në heshtjen e varrit që kishte rënë në atë çast, mërmërima e saj kumboi si të ishte zëri i priftit në meshën e së dielës.

Kaq u desh. Plaku flaku bastunin e tij drejt nipit të zhburrëruar. Se për të, ky ishte zhburrërimi më i madh që mund të pësonte një mashkull i fisit të tij. Nipi i shtangur edhe ai nga kjo e papritur që e pllakosi kaq lëmerishëm, nuk i kundërshtoi burrat e tjerë të cilët në heshtje e tërhoqën ashtu, ende ujë në djersë dhe ende me gulçimat e pasionit nën vete, cullak, drejt asaj që ai e dinte- fundit. Pati kohë të kthente kokën edhe njëherë për të parë gruan e tij, por veç ca kaçurrelave të arta të ndera në dysheme nuk arriti të shohë gjë tjetër.

Dasma u kthye në mort. E, sa për Hakën, për të nuk u kujtua më njeri, por të gjithë i ruheshin si kafshimit të gjarprit.





MACET E HALEPIT

Macet e Halepit u shurdhuan një nga një
Dhe shurdhohen për çdo ditë rishtaz
Nga shpërthimet që i gjenin strofullave
Tek ëndërronin lëmshat shumëgjyreshe
Të derdhur mbi qilimin me xhufka

Sa herë që shurdhohen
U ikin shpijarët me një bohçe tesha mbi shpinë
U mbetet vetëm shqisa e nuhatjes
Dhe sytë që s'duan të shohin strofullat
Dhe rrugët për tek konservat e hedhura bosh
Të ushtarëve që flasin gjuhë që s'i kuptojnë
Siç nuk i kuptojnë gjuhët në konserva
Arabisht, rusisht, anglisht, sërish arabisht...
Halepi, kjo gërmadhë konservash e predhash
Gërmadhë gjuhësh të gjalla e njerëzve të vdekur

Macet e Halepit jo që s'dinë të flasin
Të kërkojnë bukë, të kërkojnë të jenë mace Kosove
Po ato janë shurdhuar
Nuk e dëgjojnë klithjen e tyre
Lere më t'i dëgjojnë
Të huajt
Që hyjnë e dalin me bujë aty

U mbetet të enden mbi gërmadha si hije
Të ecin hijeve të Halepit të UNESCO-s
Shatërvanëve që s'janë shatërvanë
Shesheve që s'janë më sheshe
As rrugët që s'janë më rrugë
As xhamitë s'janë më xhami
Myezinët ikën të shurdhuar
S'e dëgjonin më zërin e tyre
Apo i shurdhoi zhurma
Ajo zhurmë që ua prishi strofullat

Dëgjojen vetëm pëshpërimat, bisedat, këngët e sharjet
Të krejt gjuhëve të botës
Si në Kullën e Babilonisë
Gjuhë që i shurdhuan macet e Halepit

U mbeti vetëm instinkti për të mbijetuar
Dhe për të gjetur ndonjë strofull për një sy gjumë
Kur nata shtrihet e i mbulon si qiell me yje
Qielet që ia prishin rendin ca që duken si yje
E janë satelitë, aeroplanë ushtarak apo xixëllonja të harruara

Macet e Halepit që mund të duken edhe si fëmijë
Qëllon të gdhihen edhe mbi një shtyllë
Që dikur ishte një muze arkeologjik
Nga ku u shfaqet muzgu i Halepit
Kjo se pi e pluhuri e shprese të vdekur
Kjo klithmë që bota s'e dëgjon

Gdhihen të lumtura se dëgjojnë sërish
Të bindura se mjaullimën do t'ua dëgjojnë ushtarët
Hoxhallarët, humanitarët, doktorët e magnatët...

Kjo u zgjat sa një ëndërr e fluturës
Sa një flurudhë granate për tek strofulli i tyre

Macet e Halepit shurdhohen një nga një
Disa nga shpërthimet
Të tjerat nga heshtja...

ËSHTË VJESHTË... (Lindita Ahmetit, poete)

Pikojnë gjethet e manjolës në këtë vjeshtë
Siç bien engjëjt e plakur me fjet
Prajshëm palosen mbi barin jeshil
Mbulojnë njëra tjetrën shpina mos u mërdhij
Pastaj fryn një erë nga gjumi i zgjon
Se vijjnë engjëjt tjerë të zverdhur verem
Si t'pikur nga qielli luhaten me nge
Shtrihen përmbi tokë dergjës i bëjnë vend
Është vjeshtë ...

SHIU E SOLLI VJESHTËN DHE U HESHT

Shiu e solli vjeshtën dhe u hesht
Si një kamerier bakshishin kur e pret

Toka u trand gjatë nga një bubullimë
Rrufeja nuk u pa, ende është Ditë

Veç qeni si një shpirt kur del
Nga frika zgurdulloi sytë

Shiu e solli vjeshtën dhe u hesht
Kujtimet u prehën gjetheve me pak klorofil

Piklat e shajnisë nga dielli u avulluan sakaq
Si fytyra të dashura kur shkrihen në turmë.

Sorrat m'i hedhin arrat e veseve nën strehë
Ollugjet i bëjnë udhë verës së ngecur në gjethe
Macja me gjuhë prajshëm lan veten mbi mur
Si kjo vjeshtë që zverdh me durim çdo dru

Shiu e solli vjeshtën dhe u hesht
Mbylle derën...bërtet plaka e legjendave
Tek rendit drutë me gunga si gishtat e saj
Në ahurin e frikës nga dimri i gjatë

Vjeshta nuk është stinë, po kumt
Me një frymë të ftohtë na pëshpërit në vesh
Kthemni nga dollapët ku më fshehët në verë
Tash e tutje le t'ju zgjas zhveshja, ka më shumë vlerë

GOSTIVARI QYTET PA KUMBARË

Gjithçka filloi të mbahet mend
Kur ta sajuan emrin
Pa ditur i pari kush ta tha
Secili nga një legjendë ta la

Me buzëqeshje krejtve u jep të drejtë
Pa qenë për njërin nënë e tjetrin njerë.

U shtrive aq sa malet të lanë
Njëri i Lartë, tjetri i Thatë
Njëri i blertë, tjetri i sertë
Por kur vjen dimri, të dy bëhen një
Me kësula të bardha në kokë.

Mbi këtë fushë të blertë pikëllimi
E mbetur djerr, jo për ujë po për krah
Vardari për mjedisi të rrjedh vërdallë
I vizatuar si me një dorë fëmiju n'janar
Ujë që më parë mbush vrima urithi
Se rrënjë groshe, drithi apo misri
Që mbi ty rriten pa i prek dielli.

E njohe botën para se me të njohë
Sot kot kërkon hartave emrin që e ke një
Ata që të deshën, që lanë emër e nam
Nuk i gjen në emra rrugësh, askush nuk i pa
Do të ishin harruar po t'mos ishte era
Sa herë që fryn si polen ua sjell
Për të mbi mbi kopshtin e ndërgjegjes.

Ti emrin e ke mikpritje
Pret e përcjell në heshtje
Miq, ushtri, barbarë, shkrimtarë
Luftëtarë, kronikanë, vallëzuese apo tuxhar
Të gjithëve u bën vend në han
Që thonë se e ngriti një gocë nga Tivari
Aq mirë i gostit, sa më këmbët s'ua lan
Ua qet atë që s'e ke, atë që e hanë
Dhe largohesh qetë, strukesh në një skaj
...krenar e i shkathët si emrin që e mba!

MUZGU, SIMBOLI QË U "NGURTËSUA" HERMETIKISHT

Kur flasim për vlera kuptojmë jo thjeshtë godinën, formën e jashtme. Diçka më shumë. Formën, arkitekturën gjuhësore ku pjesa që mban peshën e të gjithë kësaj ndërtese poetike i atribuohet metaforës



Ilir PAJA

Kur flasim për letërsinë, poezinë si krijim e cila është e rrokshme, sepse nuk shtrihet si re e madhe siç kemi prozën, por si thyerja ose krisja e natës kur mbërrin dielli i mëngjesit, raporti ynë sinkronik dhe ai diakronik ka një kontrast sa kohor, por më së shumti historik në vlera artistike. Dhe kur flasim për vlera kuptojmë jo thjeshtë godinën, formën e jashtme. Diçka më shumë. Formën, arkitekturën gjuhësore ku pjesa që mban peshën e të gjithë kësaj ndërtese poetike i atribuohet metaforës.

Nuk po ndalem në perceptimin ose përkufizimin e saj teorik, sepse jemi të qartë se është jo vetëm mbretëreshë e figurave. Por pa të s'mund të kemi mbretërim të poetit. Gjithsesi nga materiali arkivor të cilin do ta citojmë, jemi në "pritë" për të parë se ç'është sjellë muzgimi i Moikom Zeqos, për të cilin duhet të themi se nuk është veç mbi det. Por as nën qiell...Por as nën re...Duket se nga një analizë strukturale kemi hasur se fenomeni ose natyra, pasditja, mbërritja e mbrëmjes kanë kudo si para dhe pas vetes muzgun, kuptojmë se të shkruarit në fund të viteve 60-70 do jetë një betejë mes mjegullës, grimtë të gjithçkaje dhe një muzgu.

Për të kuptuar thellësisht kohën ose vitet 60, siç i cilësoi I.Kadare në poemën e tij me të njëjtin titull, kemi vendosur të ndjekim rendin kronologjik të asaj fatkeqësie e cila ndjehet dhe sot. Kolektivizimi i shoqërisë solli dhe "tufëzimin" e unit. Kjo bëri që pothuaj të gjithë poetët, edhe pse me dallime në stil dhe strukturë vargu, rime raporte inversioni etj, u rrethuan nga një ideologji. E njëjta tematikë. I njëjti lirizëm shoqëror, ku dhe ndjenjat ndaj natyrës, femrës, pyetjeve dhe jo dilemave ekzistenciale u ngritën në një "epizëm" më shumë politik se trimëror ose burrëror.

Të jemi më konkretë. Kemi poezinë e Moikom Zeqos botuar në revistën "Nëndori".Nr.7-1971.

*Ne mbillnim ullinj,
Fiksonim stinën në muzgun e kripës.
Ndanë arkitekturave prej korali,
të shpellave të detit.
Plot akustikë të kaltër legjendash
Dhe rreze si flokë të dridhshme
Nimfash.
Kur në horizont mbi gjeografinë
E kuqe të muzgut befash
Hëna u çfaq,
Sahara e saj e rrumbullakët e bardhë.*

Ne atëherë menduam: Sikur të mbillnim dhe hënën.

Të shkunden nga hëna çdo mëngjes

Katarakte petalesh si nga një ishull fluturues i pranverës.

Dhe kostelacione ullinjsh të kaltër, të kaltër.

Të shohim si e interpreton kritika e kohës, në veçanti mendimi i Dritëro Agollit, shkrimin në gazetën "Drita". "Po jap të plotë (shkruan Dritëroi) një vjershë të M.Zeqos, i cili është një poet i talentuar, me një poezi ekspressive, të figurshme. Por ndonjëherë ai e shpërdoron figuracionin. Këtu kemi metafora dhe dopio metafora, krahasime dhe dopio krahasime, metonimi dhe dopio metonimi. Është e qartë se shpenzimi i energjive për të gjetur metaforë nuk të lë të kërkosh mendimin. Vjersha bëhet rebus, fjalëkryq. Fjalëkryqi përdoret për të ushtruar kujtesën. Poezia nuk shkruhet për të ushtruar kujtesën, por për qëllime të tjera të rëndësishme, për shoqërinë, për vendin.

Po të shohim me kujdes kritikën e Agollit, duke u përqendruar, lokalizuar vetëm në metaforën, madje duke e ripërsëritur, rimarrë, krijohet përshtypja sikur kritika është një "fjalëkryq" të cilin poeti duhet ta

plotësojë me trajtimin e temës së madhe siç ishte ndërtimi i shoqërisë së re...etj. Nëse e marrim këtë poezi sot duke e harruar kohën, kuptojmë se përqendrimi poetit te figura e ka shpjegimin e vet.

Autori kundron brenda vetes fenomenin e epistemologjisë. Kur poeti mes një bindjeje që kërkohet dhe asaj që është shprehje e opinionit. Pyesim me të drejtë. Nëse kjo poezi do gjendej po e tillë diku në një vend të lirë, a do kishte jetëgjatësi nga prizmi nivelit artistik? Përgjigja gjendet sërish tek referati i Dr.K.Jorgos. Kështu kemi: "[...] Ndërsa ka dekada që mendimi historiko-letrar ndërkombëtar është thelluar në fenomenin e avangardës në të gjitha letërsitë kombëtare të Evropës Lindore dhe Juglindore, shembulli shqiptar shkëlqen me mungesën e tij. Jo më larg se viti 1992 Armin Hetzer-i pohon: "Në përgjithësi letërsia shqiptare mbetet në suazat e romantizmit, derisa më në fund bashkohet përmes realizmit socialist me letërsinë e vendeve socialiste" Nëse do arrinim në kulmin e perceptimit studimor ku kritika është realitet i të gjitha bashkëkohësive, kemi si vijon: "Vonesa e letërsisë shqipe është një vonesë e sintezës". Shohim sa më sipër poezinë e autorit. Ne s'mund të themi se dy fjali të Dritëroit janë kritikë. Madje ato as nuk janë perceptim interpretativ.

Pra, poezia e mësipërme ka motiv përshtetës. Elementet dikotomike që e ndajnë poezinë ashtu siç do t'i ndodhë të gjithë krijimtarisë së atyre viteve ka këtë nisje dhe fund të dhimbshëm. Poeti ngrihet nga efekti "hipnozë" i muzës. Humbet brenda vetes i lumtur. Në atë arrati ku s'mund të mbërrijë asnjë parullë, e shtënë, vetë rrethimi tokë-qiell. Kur e ndjen se po mbërrin te sinteza ku figura është një bukë, fruti pjekur nga brumë që u gatua falë perceptimeve nga filozofike, shoqërore, instiktive etj...qëllohet jo për vdekje. Realizmi socialist i donte artistët më shumë të gjallë...

Krahasimet me bazë metaforën, figurën që koha e një doktrine socrealiste nuk mund ta pranonte me asnjë kusht ose haraç, me kompromise ose heshtje e ka shpjegimin. Metafora është e vetmja "gjallesë" në poezi që përjeton ndryshime sa të shpejta dhe që s'mund ta ndalësh. Ajo s'është çudi të ndryshojë fat jetik brenda poetit nga engjell në djall. Agolli e pranon bukurinë e metaforës së Moikom Zeqos, madje ai sugjeron që e gjithë poezia është në 3 vargje. Ajo që e shqetëson është mbjellja e hënës. Pse një ngulmim i tillë?...parë nga pikëpamja se ç'po ndodhte me poezinë tonë në fund të viteve 60 dhe nisjen e atyre të 70-ës kuptojmë se kjo metaforë ka surrelizëm. Kjo

mbjellje e hënës sigurisht do kërkojë tokën e pranuar ose premtuar. Këtë realitetin ynë s'mund ta lejojë. Sepse kur i këndohet mbjelljes së tokës me grurë, prodhime që sigurojmë pavarësinë politike-ekonomike një hënë e mbjellë është një dëm ekonomik më shumë.


Të citojmë Agollin që për të qenë të sinqertë, në raportin e shkrimeve për botimet e talentëve të reja në nisjen e një terri ku uniformiteti kishte deri Hënën një "re" e dukshme se një trup qiellor ai e ka ruajtur ndëshkimin ndaj të tjerëve. Janë artikuj kritikë pa kritikë shkencore që duke riprodhuar citime e slogane mbledhesh i mbushën faqet e shtypit me shkrime fletërrufe. Viojmë shkrimin: "[...] Shfaqje të huaja, ndikime dhe influenca, veçanërisht të karakterit hermetik e të fryrjes së vargut me një figuracion ndonjëherë alogjik, ka dhe një varg poetësh të talentuar, të cilët kanë një poezi të shëndoshë e militante. Por ndodh që ka vargje në poetë si Xh. Spahiu. M. Zeqo. R. Marku. F. Haliti. Th. Dino e ndonjë tjetër që ka dhënë prova serioze. Por tek -tuk kemi vargje të errëta, të cilat ose e vënë në mundim lexuesin ose e largojnë. Për këtë mendim të fundit ku lexuesi vonohet ose largohet do citojmë në vijim fjalën e Prof. Shuteriqit ku do takojmë etiketimin si popull injorant, i prapambetur etj. E drejtë nga mungesa e arsimit. E padrejtë nga një manipulim ideologjik duke e tejkaluar natyralen e jetës.

Ajo që është shqetësim i vonesës së poezisë sonë ka lidhje me një perceptim të saj mbi fenomenin e hermetizmit. Që të japësh një përkufizim të tillë na duhet të hulumtojmë mbi materiale hermetike. Pra, estetikën hermetike. Nga letërsia italiane dhe nga shfletime studimore e kemi përkufizimin e kësaj rryme, lëvizjeje. Ku duhet thënë se përmendja e shpejtë në raporte, fjalime duket si një atmosferë ngjallje "frike" për krijuesit.

E kuptojmë shqetësimin e atyre viteve. Kohë e një zyrtarizmi përtej të gjitha të drejtave njerëzore. Madje kemi të drejtë të besojmë se hakmarrja ideologjike është refuzimi që ndaloi deri me jetë poetë dhe krijues. Ndërsa refuzimi hermetik do jetë "mbytës" brenda vetes. Këtu do kërkuar vonesa. Kjo kohë pa hapësirë. E ngujuar duke futur metaforën në hasmëri me ideologjinë. Ndërsa poeti e paguante "gjakun" e figurës duke u ngujuar ose në harresë, burgjeve, internimeve, heshtjes...Siç thotë dhe eseisti Benedetto Croce: "Poezia e ideve degradohet si poezi". Ndaj shprehemi se i gjithi ky konflikt me rrymat në dukje me hermetizmin e ka burimin tek një padobi e sistemit. Sepse kompleksi ideologjik s'mund të lejojë terr më terr se vetja...

ETËRIT FISHTA, GJEÇOVI DHE PRENUSHI, SIÇ NUK I KEMI NJOHUR KURRË

Një ditë patër Gjeçovi u thirr të shkonte nga Prizreni në Zimb te një njeri që po vdiste. Kur doli nga famullia, disa njerëz e paralajmëruan urgjentisht. Serbët, kështu i pëshpëriti një i besuar, kishin marrë vendim që ai të vdiste. Ai, megjithatë, u nis në mënyrë po aq burrërore dhe të guximshme sikundër edhe ka ecur burrërisht dhe me guxim gjatë tërë jetës së tij shumë të shkurtër. Në rrugë, plumbi vrastar, nga shpina, shpoi tejprtej zemrën e përschpirtshme baritore, në 14 gusht të vitit 1929, rreth orës 3 pasdite.



Marie Amelie FREIIN VON GODIN

Të gjithë françeskanët e Shqipërisë, etërit, klerikët dhe murgjit, por edhe stigmatinet e nderuara formojnë një familje të vetme dhe prekëse në përbashkësinë e saj. Është me rrufë patër Gjergj Fishta, u kthye i rraskapitur nga një udhëtim inspektimi në male patër Vinçenc Prenushi, patër Pal Dodaj nuk e fsheh shqetësimin e tij për shëndetin dhe jetën e tyre. Kur vdes një rishtar, plot shpresa, shokët e tij mbushin sytë me lot. Kurrë nuk kam parë më shumë dashuri, dashuri qiellore me një spikamë tronditëse të përzemërsisë së ngrohtë njerëzore. Është ajo që e bën veprimtarinë e këtyre françeskanëve kaq lumturuese.

Nga shumë anëtarë të kësaj bashkësie të shkëlqyeshme françeskanësh gjatë paraqitjes sime, duke përshkruar veprën e tyre, kam përmendur tashmë disa emra të bekuar. Por tre prej tyre dëshiroj t'ia paraqes lexuesve të mi në mënyrë krey të veçantë. Po të më mbetej më shumë hapësirë, do të kisha pasur

shumë dëshirë të tregoja gjithashtu hollësisht edhe patër Ambrozin, mirditorin, predikuesin e zjarrtë dhe të mrekullueshëm.

Ai vetë nuk e ka kapërdirë kurrë dhimbjen që me Ahmet Maten në fronin e Shqipërisë hipi një mysliman. Shpesh edhe e ka shprehur pakënaqësinë e tij për këtë gjë. Mirëpo meqenëse mbreti nuk është aspak shpirtvogël dhe madje thellë në shpirt atij i pëlqen ky burrë i drejtë, të cilit nuk i shijon dhe nuk mund ta hajë i qetë bukën e vet, për sa kohë që e di se një shqiptar tjetër vuan për bukë, i cili nuk i druhet edhe rrugës më të gjatë kur është puna për të ngushëlluar një njeri të munduar, por që ama e ka shpirtin dhe mendjen plot, dhe humori e shakaja nuk i ndahet nga goja, ndaj edhe për një kohë të gjatë ai nuk e ka ngacmuar patër Ambrosiosin. Veçse më në fund, kur ky e teproi, e syrgjynosi për një vit në Elbasanin e bukur, në të vërtetë ishte një dënim fare i butë, sepse ai e dinte mirë që ujërat e nxehtë termalë të atjeshëm, të famshme që në periudhën romake, do të ishin të dobishme

për atin që vuante nga cerma.

Patër Ambrozi iku duke sharë e duke buzëqeshur në Elbasan dhe atje, ku deri atëkohë vështirë se kishte një katolik, çdo të dielë predikoi në mënyrë kaq mjeshëtrore dhe tërheqëse, sa që ortodoksët dhe myslimanët mblidheshin përreth dhe kështu në Elbasan lindi një bashkësi e vogël, e zellshme katolikësh. Do të flisja me dëshirë dhe për monsinjor Shllakun, ipeshkvin malësor, për famullitarin e guximshëm dhe energjik të Troshanit, patër Engjëllin, i cili nxit tërë Zadrimën për të mbjellë hardhi të reja, dhe për patër Bonan, kreshnikun e dashur dhe të butë të malësisë dhe për shumë françeskanë të tjerë shqiptarë. Por më së fundi më duhet të vendos: etërit Shtjefën Gjeçovi, Gjergj Fishta dhe Vinçens Prenushi duhet patjetër që lexuesit e mi t'i njohin më mirë.

Patër Shtjefën Gjeçovi


Përtej kufirit politik të Shqipërisë në Serbi - në Kosovën Perëndimore ka sidomos bashkësi katolikësh të zellshëm, të cilat një vendim mizor i Fuqive të Mëdha i ndau dhunshëm nga atdheu.

Kur ndodhi kjo fatkeqësi, nisi menjëherë lufta shfarosëse e sllavëve kundër shqiptarëve të atjeshëm. Shumë famullitarë shekullarë janë arratisur në Shqipëri për shkak të këtyre përndjekjeve, disa prej tyre janë përpjekur, por më kot, të zgjojnë interesin e Lidhjes së Kombeve për vuajtjet e kosovarëve shqiptarë.

Famullitarët françeskanë qëndruan me grigjën e tyre baritore. Më i njohuri ndër ta ishte patër Shtjefën Gjeçovi. Ky burrë i guximshëm, besnik dhe kreshnik ishte bërë i famshëm që në atë kohë, sepse ishte i pari që kishte mbledhur dhe publikuar nocionet e së drejtës zakonore të fiseve të Shqipërisë Veriore, të përcjella gojë

më gojë nëpër shekuj, të njohura më vonë nën emrin përmbledhës "Kanuni i Lekë Dukagjinit", sipas studimeve më të fundit, një e drejtë zakonore gjermane e lashtë, gotike, që rregullonte jetën e të gjithë fiseve shqiptare veriore. Tani, që kishte nisur fushata shtypëse e serbëve kundër shqiptarëve të Kosovës, ai nuk mund t'i pengonte bandat serbe që të sulmonin dhe të masakronin shqiptarët në Kosovë, që të rrethonin natën fshatrat e këtyre shqiptarëve të paarmatosur, t'i mbështillnin me kashtë dhe t'i digjnin shtëpitë, kështu që burri, gruaja dhe fëmija të vdisnin mes flakëve. Po ai u kishte siguruar bashkatdhetarëve të vet kurorën qiellore për këtë martirizim, e kishte pajisur grigjën me kungimin e shenjtë për ditën e fundit të vështirë. Ai ishte për të gjithë njëherësh dhe pa iu trembur syri ndihmës, vëlla dhe baba, derisa serbët e piketuan dhe e urryen si armikun për vdekje të qëllimeve të tyre kombëtare dhe kishtarë në Kosovë. Sepse synimi i tyre kryesor ishte t'i ndanin shqiptarët nga gjuha e tyre amtare dhe para së gjithash nga kisha katolike.

Një ditë patër Stefan Gjeçovi u thirr të shkonte nga Prizreni në Zimb te një njeri që po vdiste. Kur doli nga famullia disa njerëz e paralajmëruan urgjentisht. Serbët, kështu i pëshpëri-





ti një i besuar, kishin marrë vendim që ai të vdiste. Ai e vuri dorën e tij priftërore te Shën Mëria që mbante në zemër dhe tha se kjo nuk ishte arsye që njeriu, i cili po vdiste duhej të shkonte në udhëtimin e fundit pa bukën e jetës.

Ai ishte zhytur në lutje – tregonte më vonë sakristani – por megjithatë u nis në mënyrë po aq burrërore dhe të guximshme sikundër edhe ka ecur burrërisht dhe me guxim gjatë tërë jetës së tij shumë të shkurtër. Në rrugë, plumbi vrashtar, nga shpina, shpoi tejprtej zemrën e përshpirtshme baritore në 14 gusht të vitit 1929, rreth orës 3 pasdite.

Patër Gjergj Fishta

Patër Gjergj Fishta, poeti i madh kombëtar i Shqipërisë, të cilin pa dyshim, shumë shpejt do ta njohë edhe Evropa si një nga më të mëdhenjtë poetë të gjallë, ka lindur në afërsi të Troshanit si djalë i një fshatari malësor. Me një natyrë të zjarrtë dhe magjepsëse, tepër i talentuar për të gjitha artet, ai hyri te françeskanët që kur ishte fëmijë. Tanimë si klerik i ri ai i dha publikut krijime poetike me një varg me forcë të pakrahueshme, jetësore dhe entuziaste, të cilat i këndonin nderit dhe luftës së

atdheut, thelbit dhe historisë së popullit të vet.

Atë që ai ka bërë për lirinë e Shqipërisë, unë e kam përshkruar tashmë. Për poezitë e tij dhe sidomos për kurorën epike "Lahuta e Malësisë" është thënë që ato janë gjak prej gjakut të Shqipërisë, që ato përshkruajnë bëmat heroike të kreshnikëve shqiptarë nëpërmjet tërë historisë shqiptare, kreshnikë, të hollë dhe shtathedhur, trima dhe besnikë të fjalës dhe të dlires, shqiptarë nga koka deri te këmbët. Po kështu kurora e tij epike është bërë në masën më të madhe pasuria e tërë popullit. Çdo burrë, çdo grua, çdo fëmijë në Shqipëri e njeh Oso Kukën dhe njerëzit e tij, di të të flasë për të gjithë heronjtë e tjerë të këngës. Në oborrin më të vetmuar malor mund të të jehojnë papritmas vargjet e para të "Lahutës së Malësisë":

"Zot, ç'ka thanë njaj Avdi Pasha:
paska mbetë Shqipëria n'vasha,
qyshë se s'lëka mbrendë një djalë,
n'atë Vraninë mue sot me m'dalë,
n'atë Vraninë, n'atë t'zezë
tërthore..."

Kudo ku do të takohen shqiptarët, në këto vargje ata do të ndiejnë gëzim në zemër.

Sipas planeve të bukura të patër Gjergj Fishtës në Shqipëri janë ndër-

tuar kuvendet më të reja, po edhe shumë kisha, kuvendi i Lezhës, kisha e dytë e françeskanëve në Shkodër dhe faltorja e Zotit në Theth, me konviktin e saj për seminaristët; ndërkaq krahas jetës së tij shembullore atdhetare dhe trimërore, me siguri që krijimtaria e tij poetike mbetet përherë fama e tij më e madhe.

Populli e do atë me përzemësi dhe me krenari, i tërë populli shqiptar, jo vetëm katolikët. E kam kuptuar këtë në mënyrë shumë të qartë në vitin 1930, kur u përrua fabrika e çimentos. Edhe patër Gjergj Fishta kishte ardhur së bashku me patër Vinçenc Prenushin në këtë ceremoni të rëndësishme. Por kur kaloi, në krye të vizitorëve, në sallën e makinerisë, zhguni i tij u kap nga një rrotë e pambuluar. Të gjithë të pranishmit mbajtën frymën, të tmerruar. Shqipëria pa patër Gjergj Fishtë! Ne që po qëndronim në anën tjetër të makinerisë, ishim të paafte për të dhënë ndihmë, por një oficer që iu ndodh në krah, e ngriti lart patër Gjergj Fishtën

tashmë të rrëzuar dhe kështu e shpëtoi nga vdekja. Aty për aty një mysliman grisi me dhëmbë fashën nga krahu i vet i thyer, në mënyrë që me atë fashë të mund të pushonte gjaku i patër Fishtës. 36 orë me radhë populli i Shkodrës, myslimanë e katolikë, kaloi pranë shtratit të patër Gjergj Fishtës, duke qarë nga gëzimi dhe duke lëvdur Zotin që patër Gjergj Fishta, babai dhe poeti i tyre kishte shpëtuar.

Kur patër Vinçenc Prenushi sipas rregullores së Urdhrit nuk mund të zgjidhej edhe një herë kryetar, në vend të tij u vu patër Gjergj Fishta.

Patër Vinçenc Prenushi, Ipeshkvi i Sapës

Një fjalë për patër Vinçenc Prenushin, i cili gjashtë vjet ka qenë provincial i Provincës françeskanë shqiptare dhe në 27 janar të vitit 1936 u emërua ipeshkvi i dioqezës shqiptare të Sapës. Butësia dhe mirësia e tij, zelli i tij i paarritshëm për veprën e Zotit në tokë, për shpëtimin, por edhe për lumturinë tokësore të të gjithë njerëzve, janë kaq të dukshme në rrugën e tij, sa që populli shqiptar – që me gjithë ngrohtësinë e zemrës, është i pakorruptueshëm dhe i kursyer në lëvdaturë – e quan atë, edhe pse i ka kaluar të pesëdhjetë vjetët, një

ndër më të mirët e vet.

Sa të habit lulëzimi që njohu në kohën e tij provinca shqiptare e françeskanëve, sa shumë faltore të Perëndisë dhe kisha, sa shumë kuvende ndërtoi ai, sikundër të habit aq shumë edhe rrethana që me gjithë barrën e madhe të punës, gjeti kohë të lirë për poezitë e tij të bukura lirike, për përkthimet e rëndësishme dhe shkrimet shkencore, në ç'mënyrë sa tërheqëse dhe entuziaste thërret ai nga predikatorja për përkushtimin ndaj Zotit dhe kishës së Tij, sesi me gjithë këto, sa shumë kujdeset ai që të bisedojë edhe me miqtë e tij, t'u japë zemër njerëzve të trishtuar, të vizitorëve të burgosurit, se si ai, duke qenë provincial i Urdhrit, në çdo dy vjet, gjente kohë të shkonte në faltoren më të largët të Zotit, qoftë edhe në malësinë më të pakalueshme, se me sa vëmendje i ndiqte dhe ndikonte ai mbi ngjarjet publike në atdheun e tij! E gjithë kjo është një mrekulli e mëshirës dhe dhunti e madhe njerëzore.

Edhe patër Vinçenc Prenushi është një malësor shqiptar i vërtetë, me sy të kaltër, me zemër të fortë, gëzimi i njerëzve të vet. Ai përkujdeset me dashuri vëllazërore edhe për murgun më të thjeshtë të kuvendit më të humbur françeskan. Kur sëmuret një nga grigja e tij, ai mundohet si një nënë për shërimin e tij, i sjell mjekët më të mirë, e dërgon edhe për kujdes dhe çlodhje në Gjermani. Por ai përkujdeset edhe për anëtarët diletantë të bashkësisë së françeskanëve të Shqipërisë. E kush mund t'i numërojë më tej myslimanët që ka ndihmuar ai në hall e në nevojë! Për të fanatizmi është i huaj sa edhe ftohtësia.

A duhet të them edhe sesi mjaft të jetë në prani të tij dhe çdo zemër e turbulluar, e nxitur dhe e zemëruar rreh më e qetë dhe lehtësohet, sesi, kur del para tij cilido synon të përmirësohet, qoftë edhe atëherë kur duhet të japë llogari? Le të përulemi përpara Zotit tonë të dashur dhe t'i lutemi të na plotësojë dëshirën që patër Vinçenc Prenushi, të cilit, për gëzimin më të madh të të gjithë shqiptarëve katolikë, të bijve të tij françeskanë, të popullit të tij dhe të miqve të tij të huaj, iu dha ofiqi i ipeshkvi, të rrojë edhe shumë, shumë vjet për njerëzit e tij, për atdheun e tij dhe për kishën e shenjtë!

Fjala përmbyllëse

Ndarja nga françeskanët shqiptarë është e vështirë për mua, ashtu si ndarja nga miqtë e shumënderuar dhe të dashur. Dëshiroj të ndahem me pendën time me një fjalë falënderimi të ngrohtë për bekimin, shembullin e shenjtë dhe inkurajimin, që ka qenë për mua kjo bashkësi fisnike e kuvendit.

(Marrë nga: "Shtigjeve apostolike përmes Shqipërisë së bukur")

Përktheu nga gjermanishtja:
Dr. Elda Gjana-BORIÇI

NUMRI I ARDHSHEM ME 1 SHKURT

HEJZA

20 JANAR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000